midis



VAKUMIT

dhe



ISBN 978-99956-678-6-5

Çmimi 500 Lekë

ENERGJISË

Besnik Aliaj , Sotir Dhamo , Dritan Shutina



MIDIS VAKUMIT DHE ENERGJISE

Përvoja të Co-PLAN mbi Planifikimin Urban në Shqipëri.

Besnik Aliaj, Sotir Dhamo, Dritan Shutina

Besnik Aliaj, Sotir Dhamo, Dritan Shutina
Tirane,2009

Midis Vakumit dhe Energjisë

© Co-Plan
Rr."Vaso Pasha", nr. 20
Tirane
Tel. +355 (4) 2 257808 / 2 257808
Fax. +355 (4) 2 257807
e-mail: co-plan@co-plan.org
web: www.co-plan.org

© Universiteti Polis
Rr. "Vaso Pasha", nr. 20
Tirane
Tel. +355 (4) 2 223922 / 2 237236
Fax. +355 (4) 2 220517
e-mail: info@universitetipolis.edu.al
web: www.universitetipolis.edu.al

Autor: Besnik Aliaj, Sotir Dhamo, Dritan Shutina
Korrektor letrar: Olta Çakçiri
Design: Gjergji Dushniku
Botues: Co-plan

Midis Vakumit dhe Energjise
Tiranë, Dhjetor 2009
Tirazhi: 1000 kopje

Shtypur nga: botime afrojdit

Mirënjohje

Ky libër i kushtohet të gjithë atyre profesionistëve që punuan në Co-PLAN që nga themelimi deri më sot. Në emër të tyre dhe komuniteteve ku kemi punuar shprehim mirënjohjen e veçantë për partnerët kryesorë që na mbështetën në rrugën tonë: Cordaid, IHS Rotterdam, Novib Hollandë, Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta, Misioni i Bankës Botërore dhe Zyra Austriake e Bashkëpunimit Teknik në Tiranë.

2009 Instituti per Zhvillimin e Habitatit Co-Plan

Permbajtja

7 **Permbajtja**

8 **Motivimi**

10 **Hyrja**

24 **1.Nga qyteti i nevojave bazë,
tek qyteti i më shumë mundësive**

66 **2.Programi EGUG: Drejt Qeverisjes së Mirë Urbane!**

100 **3.Reflektim Post-EGUG...
Vizione globale dhe kombëtare**



... Ka qenë një përpjekje për të krijuar modele shprese dhe orientimi në një situatë politike-sociale, spektri i së cilës lëvizte midis zbrazëtisë së "vakumit" institucional, dhe "energjisë" së pashtershme të njerëzve dhe shoqërisë ...

... është një mendim pozitiv ... është një lexim i energjive dhe forcave transformuese që ekzistojnë brenda kontekstit Shqiptar ... është një shpresë se shoqëria shqiptare është në rrugën e zhvillimit të saj normal dhe jo viktimë e së kaluarave pengmarrëse ...

... është një mënyrë se si nuk tentojmë të fajësojmë rrethanat që qëndrojnë jashtë nesh për problemet tona ... se si "gabimi" nuk shihet tek të tjerët ... se si ne dhe shkaqet e problemit jemi pjesë e të njëjtit sistem ... se si zgjidhja qëndron në krijimin e raporteve me atë që mendojmë se është "problemi" ...

... është një mënyrë se si mund të "zhvendosim" të menduarit tonë nga të parët e pjesëve të shkëputura në të parët e të gjithë sistemit ... se si mund të rikonsiderojmë njerëzit nga subjekte pasive, në pjesëmarrës aktivë që formësojnë realitetet ku ata jetojnë ...

... është një mënyrë se si mund të tregojmë problematika të zhvillimit urban të Shqipërisë së pas viteve '90 përmes "syve" të një bërthame specialistësh të Co-PLAN ... tregon historinë e një organizate e cila ... eksperiencën e terrenit e transferoi në nivelin e hartimit të politikave kombëtare, edukimit universitar dhe kërkimit akademik shkencor ...

Prej kohësh e kemi ndjerë për detyrë të sistemonim "copëzat" e përpjekjet tona të filluara pas ndryshimeve të mëdha të viteve '90 ... vite këto kur Shqipëria është përpëlitur midis kaosit dhe tentativave për të vendosur rregulla ... Disa prej ideve, reflektimeve dhe projekteve të shkruara në faqet që vijojnë janë bërë realitet ... ndërsa të tjera kanë mbetur thjesht një tentativë ... Tek sa shkruanim këtë libër kemi qenë në dilemën midis të qenit profesionistë analitik dhe "kronistëve", duke qenë të ndërgjegjshëm se puna e shumë të tjerëve qëndron prapa asaj që është e dukshmja. Kjo është arsyeja që mënyra e të shkruarit kombinon kronologjinë e ngjarjeve me pohime teorike të cilat na kanë shërbyer si guidë ... apo edhe me inspirime artistike të cilat kanë qenë të domosdoshme për të parë me më shumë "ngjyra" një realitet që tentante të shfaqej i zymtë. Mbi të gjitha kemi qenë në dilemën që libri të mos ishte vetëm një histori ngjarjesh dhe kronikash profesionale për zhvillimet urbane dhe territoriale në Shqipëri, por mbi të gjitha një mënyrë të menduari për urbanistikën, planifikimin urban dhe jetën në tërësi në rrethanat konkrete të Shqipërisë ... një mënyrë të menduari e cila mund të hapë një debat alternativ të shëndetshëm dhe që gjatë gjithë kësaj kohe kemi dashur ta ndajmë me të tjerët ...

Besnik Aliaj, Sotir Dhamo, Dritan Shutina

HYRJE

... Ka qenë një përpjekje për të krijuar modele shprese dhe orientimi në një situatë politike-sociale spektri i së cilës lëvizte midis zbrazëtisë së "vakumit" institucional dhe "energjisë" së pashtershme të njerëzve dhe shoqërisë...

Ky botim përpiqet të strukturojë dhe dokumentojë tri faza të rëndësishme të zhvillimit të filozofisë së planifikimit dhe qeverisjes urbane në Shqipëri, përmes praktikave të Institutit për Zhvillimin e Habitatit, shkurt i njohur me emrin Co-PLAN, si dhe partnerëve të tij në Shqipëri dhe jashtë saj. Co-PLAN është një organizatë pioniere e shoqërisë civile në Shqipëri që përdor ekspertizën e vet në fushën e planifikimit dhe administrimit të territorit duke promovuar zhvillim të shoqërisë përmes elementëve të qeverisjes së mirë.

Co-PLAN e shikon planifikimin urban jo si një çështje "të mjerë" teknike, por mbi të gjitha si një përpjekje për të përmirësuar skeletin e shoqërisë, për t'u orientuar dhe përshtatur ndaj ndryshimeve të status quo-së ndërsa vetë shoqëria ndryshon dhe evoluon. Për të kuptuar planifikimin dhe zhvillimin e territorit në një vend, është e nevojshme të kuptohet vetë konteksti historik, sidomos historia e neglizhencave të shoqërisë; arsyet dhe format e manifestimit të këtyre neglizhencave dhe reagimi i shoqërisë kundrejt tyre, të cilat shprehen përmes sfidave me të cilat po përballen vendbanimet njerëzore. Ndërkohë, eksperienca e përshkruar në këtë libër mund të shihet edhe si përpjekje për të themeluar një profesion dhe shkencë të munguar në Shqipëri e rajon.

Në këtë kontekst, historia gati 15-vjeçare e Co-PLAN është e lidhur me vetë historinë e zhvillimeve social-ekonomike dhe urbane të Shqipërisë, duke qenë një reflektim i realitetit dhe një përpjekje për t'lu përgjigjur dhe për t'i paraprirë problemeve të tij. Tri faza kryesore të evoluimit të Co-PLAN si institucion dhe si përqasje metodologjike ndaj situatës urbane, të përshkruara në vazhdim, e dëshmojnë më së miri këtë bashkëjetesë.

Së pari, vitet '90 – ka qenë një fazë kur shoqëria shqiptare kishte nevojë të provonte dhe të përballonte me sinqeritet të vërtetën e vetvetes; kur shoqëria kishte nevojë për modele referuese dhe mbi të gjitha kishte nevojë që të kuptonte faktin se ajo çka kish ndodhur në Shqipëri lidhur me lëvizjet e popullsisë nuk kishte vetëm aspekte negative, por mbartte mbi vete edhe potenciale të konsiderueshme të zhvillimit ekonomik. Për Co-PLAN, kjo korrespondon me ndërtimin e modeleve dhe pilotimin e skemave të përmirësimit dhe planifikimit urban komunitar me pjesëmarrjen e qytetarëve, sidomos në zonat periferike dhe informale, me moton "Qyteti i Ndërtuar nga Njerëzit!" (City Made by People).

Së dyti, gjysma e parë e viteve 2000 – ka qenë një fazë kur në realitetin shqiptar thellohet kriza hapësinore si në shkallë territoriale, të manifestuar në shpërhapjet pa kriter, ashtu edhe në shkallë urbane të manifestuar në raporte të reja midis qendrës dhe periferisë apo pjesëve të ndryshme të qytetit. Qytetet, Tirana në veçanti, po merrnin përmasa të tilla të cilat vunë në krizë instrumentet e kontrollit dhe të parashikimeve të përdorura deri në atë kohë. Ajo çka ishim mësuar ta quanim qytet po transformohej krejtësisht brenda një dhjetëvjeçari si rezultat i ndërveprimit të faktorëve të rinj politikë me ata socio-ekonomikë. Këto fenomene krejtësisht të reja dhe të papara ndonjëherë për realitetin shqiptar çuan në moskuptimin e dinamikave të reja qytet-territor dhe i paraprinë rëndimit të mëtejshëm të situatës. E ndërsa këto problematika të reja bëhen maksimalisht të dukshme, ekspertiza planifikuese e Co-PLAN zhvillohet me iniciativa planifikuese të tipit rregullues e strategjik në nivel qyteti/bashkie ndër të cilat spikat eksperienca e Programit EGUG, (Enabling Good Urban Governance) Mundësimi i Qeverisjes së Mirë Urbane, mbështetur nga Qeveria Holandeze dhe fokusuar në qytetet Fier dhe Elbasan. Materiali në vijim do të tregojë se kjo është jo vetëm një eksperiencë thelbësore për Co-PLAN por shënon një fazë të re për planifikimin urban shqiptar i cili synon të dalë nga modelet e përdorura tradicionalisht. Kështu, këto vite u karakterizuan nga evoluimi i instrumenteve të planifikimit si edhe të vetë Co-PLAN sipas parimit "Qytetet Motorë të Zhvillimit!" (Making Cities Work!)

Së treti, gjysma e dytë e viteve 2000 – që përkon me hyrjen e Shqipërisë në një fazë konsolidimi, zhvillimi dhe integrimi euroatlantik, shoqërohet edhe me reduktimin e programeve të mbështetura nga ndërkombëtarët. Në shoqërinë shqiptare filluan të bëhen të dukshme paradokse si edhe kontradikta brenda vetë individëve, pjesë e një shoqërie që nga njëra anë synon të kapë mundësi të reja dhe standarde më të larta jetese, ndërsa nga ana tjetër, jo rrallë, i duhet të përballojë ende kushtet e vështira, pasojë e një infrastrukture inxhinierike dhe sociale të pamjaftueshme. Për Co-PLAN kjo është periudha e reflektimit post-EGUG që mund të konsiderohet edhe si konsolidim i vënies në funksionim të instrumenteve dhe metodologjisë për "Ndikimin e Politikëbërjes!" (Making Policies Work!). Kjo është edhe motoja në veprim e Co-PLAN.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, kjo periudhë reflektimi bëri që Co-PLAN të kuptonte rëndësinë e krijimit të një mase kritike burimesh njerëzore me njohuritë dhe ekspertizën që do të mundësonte dhe institucionalizonte ndryshimin pozitiv në Shqipëri për këtë sektor. Kjo qasje strategjike inspiroi edhe krijimin e "shkollës së ideve" dhe lidershipit profesional për një frymë të re në arkitekturë si dhe krijimin e profesionit të ri të planifikuesit urban në Shqipëri, të materializuar në Universitetin POLIS.

Vështrim i shpejtë historik:
"Themelimet" dhe "Rithemelimet" e Qytetit.

Periudha 1922 – 1944: Monarkia - "Rithemelimi" i Parë

"Transplanti" i ndërhyrjeve simbol...
Qytetet shqiptare paraqesin një strukturë ekstensive dhe spontane;
Fillesat në urbanistikë dhe në planifikimin e organizuar të qyteteve;
Kalimi nga urbanistika spontane në atë të organizuar;
Ravijëzohet "skeleti" i parë i mirëfilltë urban i qyteteve kryesore

Në fakt, para Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria trashëgoi një model pothuaj feudal për sa i takon zhvillimit të territorit. Momentet më kulmore të kësaj periudhe kanë qenë: sundimi i Perandorisë Otomane; periudha pas shpalljes së pavarësisë më 1912 dhe periudha nga monarkia "Zogu I" deri tek pushtimi i vendit nga Italia Fashiste. Deri në fund të kësaj periudhe, vendi u karakterizua nga një shoqëri 80% rurale, ku traditat e zhvillimit të vendbanimeve lokale shpesh miksoheshin me elemente mesdhetaro-orientalë. Bëjnë përjashtim disa tentativa modernizuese në qytetet kryesore të vendit prej administratave të mbretit Zog I dhe të mbretit Viktor Emanuel të Italisë. Organizimi shtetëror i vendit po sillte nevojën për të krijuar në qytete hapësirën e institucioneve të shtetit të ri shqiptar. Rasti më tipik është ai i Tiranës. Instrumentet më të avancuara që u përdorën në fund të kësaj periudhe ishin ato të "dizajnit urban". Sipas këtyre instrumenteve, plani urban konsiderohej gati si një kryevepër sociale dhe imagjinohej pothuaj si një punë në gjendje "state of art" dhe në këtë kontekst, në mënyrë gati naive, besohej se një vijë e hequr "heroikisht" në letër mund të zgjidhte si me magji problemet e shoqërisë në terren. Paradigma dominuese e planifikimit në këtë periudhë ishte koncepti se arkitekti (profesioni që dominonte planifikimin urban) ishte një lloj superman-i (superheroi) që mbronte interesin dhe të mirat publike.


Duhet pranuar se gjatë kësaj periudhe planifikimi urban si profesion dominohej nga inxhinierët, ekspertët e shëndetësisë dhe, në rastin më të mirë, nga arkitektët dhe artistët.


Periudha 1944-1990: Shteti socialist - "Rithemelimi" i Dytë

Operacione të konsiderueshme urbane me pasojë ndryshimin e strukturave të qyteteve dhe dëmtimin e trashëgimisë historike të tyre...
Sistemi i centralizuar shtetëror i projektimit dhe sektorit të ndërtimit;
Dominimi i arkitekturës dhe urbanistikës sovjetiko-lindore;
"Çtiparëzimi" dhe "humbja e vendit"...
Fitan terren urbanistika me ndërtimin e qyteteve të reja (Kukës i Ri, Laç, Cërrik, Ballsh, Çorovodë etj.)
Shembja masive e zonave tradicionale dhe ndërtimi nga e para i shumë lagjeve dhe komplekseve të strehimit;
Pas mesviteve '70, shumica e qyteteve kryesore dhe fshatrave u pajisën me plane rregulluese;
Shtrirje të reja dhe zgjerim i qyteteve;
Standardizimi me banesa të tipit apartament me 4-5 kate;
Varfëri/kufizim në mendim, konceptim, formë të shprehjes, materiale, teknologji;
Parulla "Ta bëjmë fshatin si qytetin"... Politikë antiurbane;
Ndërhyrje publike në shkallë të gjerë me impakte të forta mjedisore në territor (tharje kënetash, shpyllëzim dhe tarracime, hidrocentrale etj.)

Gjatë këtij sistemi, i cili zgjati më tepër se katër dekada, Shqipëria kaloi tre momente të rëndësishme që ndikuan në planifikimin dhe administrimin e territorit: Së pari, periudhën e rindërtimit të vendit nga pasojat e Luftës së Dytë Botërore (1945-1960); Së dyti, periudhën e industrializimit (vitet 60-70-të); Së treti, periudhën e vetizolimit ekstrem dhe kolapsit ekonomik të viteve 80-të. Në fund të kësaj periudhe, vendi trashëgoi një strukturë demografike ruralo-urbane me vetëm 35% të popullsisë që jetonte në qytete dhe një ekonomi ku peshën kryesore (mbi 55%) e luante bujqësia[1].

1 V. Misja, Y.Vejsiu, tek B.Aliaj 1995 ; Strehimi për familjet me të ardhura të ulëta, rasti i Tiranës, IHS Roterdam





Me gjithë angazhimin e autoriteteve të kohës për investime publike dhe strehim, ky i fundit u shndërrua në një makth social. Edhe pse në total gjatë kësaj periudhe u ndërtuan rreth 230,000 njësi banimi, Shqipëria trashëgoi në fillim të viteve 90-të treguesit më të ulët për strehimin në Evropë, me vetëm 17 m2/person që ishte gati sa gjysma e indikatorëve të kohës për Rumaninë e cila atëherë renditej e dyta nga fundi në Evropë. Rajone të caktuara të vendit në këtë kohë, sidomos Verilindja, trashëguan indikatorë socio-ekonomikë dy herë më të ulët se mesatarja e vendit dhe tregues të shërbimeve social-shëndetësore 10 herë më të ulëta se kryeqyteti.

Masat dhe instrumentet shtrënguese antiurbane, mohimi i pronës private, bllokimi i procesit të industrializimit dhe dështimi i ndërmarrjeve ekonomike shtetërore të subvencionuara, krijuan një situatë si pasojë e së cilës, në fund të epokës së ekonomisë së centralizuar, rajonet periferike të vendit do të binin në kushtet e depresionit të plotë ekonomik dhe social. Kështu popullsia lokale mbeti e pashpresë dhe krejtësisht e neglizhuar nga elitat e reja politike në kryeqytet. Ndërkohë, përveç faktit se çdo apartament mbipopullohej nga 2-3 kurora, Shqipëria e pragviteve 90-të trashëgoi të paktën mbi 50 mijë familje të persekutuarish politikë në nevojë urgjente për strehim pas kthimit nga "gulagët" dhe po kaq familje të tjera në nevojë urgjente për strehim për shkak të pretendimeve të pronarëve historikë të cilët, pas ndryshimit të regjimit politik, kërkuan menjëherë të drejtën e njohjes, kthimin fizik dhe/ose kompensimin e pronave. Gjatë periudhës së komunizmit, instrumentet kryesorë të planifikimit dhe administrimit të territorit kanë qenë Planet Rregullues që zbatonin një metodologji strikte, kryesisht të fokusuar në dimensionin fizik dhe qëndrimet antiurbane. Paradigma dominuese e planifikimit në këtë periudhë ka qenë ajo racional-funksionaliste e zotëruar nga koncepti se planifikuesi duhet të jetë thjesht një teknik, një lloj "justifikuesi dhe manipulatori" i zhvillimit të territorit që vepron duke u bazuar në udhëzimet e politikës absolutiste. Jo rastësisht, planifikimi urban konsiderohej si pjesë e formimit ideologjik dhe më shumë si degë e arkitekturës në shkallë qyteti, duke u dominuar kështu nga arkitektët. Në variantin e saj më shkencor, kjo paradigmë tradicionale presupozon zgjidhje në kuadrin e kompleksitetit perfekt të të dhënave, në mbledhje të të cilave viheshin të gjitha institucionet. Madje vetë fjala "racionale" nënkupton këtë kompleksitet si edhe përdorimin sa më eficient të këtyre të dhënave.
Sipas kësaj teorie, supozohet gjithashtu që planifikuesit janë të aftë të grumbullojnë të gjitha të dhënat e domosdoshme për të marrë vendime.

Sipas kësaj teorie, supozohet gjithashtu që planifikuesit janë të aftë të grumbullojnë të gjitha të dhënat e domosdoshme për të marrë vendime. Këto pretendime në rastin më të mirë mund të klasifikohen si utopi pasi njohja nuk mund të jetë kurrë e kompletuar, aq më tepër në kushtet e kufizimeve politike që kalonte vendi në atë kohë.

Fillesat e këtij modeli planifikimi u "importuan" në Shqipërinë e fundviteve '30 dhe fillimit të viteve '40 nga projektet italiane të administratës së mbretit Zog si edhe të fashizmit në të cilat për herë të parë u hartuan planet për qytetet kryesore të vendit. Gjatë periudhës së socializmit, ky model u "pasurua" edhe me elemente të sistemit të planifikimit të centralizuar të huazuara nga vendet ish-komuniste. "Mbeturina" të këtij modeli tradicionalist vazhduan për një kohë të gjatë dhe ende vazhdojnë të mbajnë të ngërthyer institucione dhe qëndrime zyrtare. Mjafton këtu të sjellim në kujtesë diskutimet pa fund të urbanistëve, përfaqësues të institucioneve shtetërore të pas viteve '90 e deri në ditët e sotme, mbi pamundësinë e tyre për të hartuar plane pasi sistemi shtetëror nuk u garantonte dot më të dhëna të sakta mbi të cilat do të mund të merrnin vendime. Kapitujt në vazhdim japin disa tendenca kryesore në lidhje me teoritë e sotme të planifikimit dhe daljen nga dilema e "të dhënave pa fund".

Periudha 1990 – 2000: "Rithemelimi" i tretë

"Bathorizimi" dhe krijimi i "New Metropolitan Brand"

Ndryshimi i kushteve politiko-ekonomiko-sociale - Faza e parë e shtetit pluralist;
Shteti në pozicion minimal koordinimi dhe kontrolli mbi aktivitetin ndërtimor;
Buxhete publike tepër të varfra dhe një kulturë qytetare kundër taksave;
Urbanizimi i shpejtë dhe i pakontrolluar i qyteteve kryesore;
Periferi ilegale me ndërtime banimi 1-2 kate;
Qendër e dendësuar me apartamente banimi 10 -12 kate;
Zëvendësimi i ndërtimeve tradicionale dhe "shqyerja" ose "pushtimi" i hapësirave publike;
Mungesa e burimeve njerëzore për të menaxhuar rritjen në kushtet e reja;
Pozicionimi zyrtar i strukturave të "urbanistikës" jorealist, i vjetruar dhe larg problemeve reale...



STANDARDIMI

MARRDHËNIA JO E "RË
ME HAPËSIRËN

Kza Hapësinore

strumenta dhe mentalitete të vjetra

Nuk mund të zgjidhet me menyr

Shtypja nga densiteti
E panjohura, humbja labirint, mos orientimi

Alienizimi



Gjatë viteve '90, Shqipëria postkomuniste kaloi situata amullie sociale-politike dhe tronditje të mirëfilltë të ekonomisë kombëtare, përfshi këtu trazirat për shkak të aplikimit të terapisë "shock" (1990-1994), të kolapsit të firmave piramidale financiare (1997-1998) dhe të krizës humanitare për shkak të luftës në Kosovë (1999).
Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria karakterizohet nga: urbanizimi i shpejtë dhe kaotik që arriti të paktën në nivelin 55-60%; privatizimi i ekonomisë e decentralizimi i qeverisjes; dhe shpërthimi i informalitetit në biznes, ndërtim e pronësi.

Natyrisht që fenomeni më tipik që ndodhi pas ndryshimeve politike dhe ekonomike të fillimit të viteve '90 ishin ndërtimet pa leje. Ky fenomen ndodhi kryesisht për dy arsye: së pari, nga kërkesa e madhe për strehim, gjendja e të cilit ishte rënduar gjatë sistemit komunist, si edhe për shkak të rritjes së kërkesave për një jetë më të mirë që lindën fill pas rënies së këtij sistemi; së dyti, për shkak të paaftësisë së autoriteteve publike për të vizionuar dhe siguruar alternativa të ligjshme e të përballueshme për qytetarët të dilët fituan të drejtën legjitime të lëvizjes së lirë si dhe të drejtat e njeriut që në përgjithësi nënkuptojnë të drejtën për një jetë sa më normale, përfshi punësimin, strehimin, infrastrukturën, shërbimet publike dhe sociale dhe të ardhmen sa më të mirë e të sigurt të familjeve të tyre. Aktualisht, asnjë institucion shtetëror, qoftë ky lokal apo qendror, nuk siguron praktikisht mundësi të mjaftueshme e konkrete për strehim social apo troje me infrastrukturë dhe shërbime bazë ku qytetarët të mund të investojnë ligjërisht sipas mundësive të tyre për qëllime strehimi dhe punësimi. Për më tepër, rreth 15,000 njësi banimi të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave apo projektet vendore në këto dy dekada, në shumicën e rasteve kanë devijuar drejt grupeve të tjera sociale në vend që të shkonin në funksion të familjeve në nevojë për të cilat ishin dizenjuar. Aktualisht, tregu i ndërtimeve i është lënë spontanitetit "të egër" dhe tërësisht të parregulluar e pambrojtur nga situata monopoli, duke e bërë atë praktikisht të papërballueshëm për shumicën dërrmuese të popullsisë e cila ka kufizime serioze financiare.

Periudha 2000 e në vazhdim: Rithemelimi i "urbanistikës"?!

Tendencat për të ripozicionuar shtetin në rolin e tij koordinues dhe monitorues, por me impakt të ulët në fushën e ndërtimit dhe projektimit;
Pozicionimi zyrtar ndaj ndërtimeve informale si në periferi ashtu edhe në qendër;
Rritja e bazës së taksapaguesve dhe thellimi i decentralizimit;
"Pastrimi" i hapësirave publike qendrore nga ndërtimet informale;
Legalizimi i ndërtimeve informale, sidomos për qëllime strehimi;
Tentativa për të rivendosur planifikimin si funksion të detyrueshëm me ligj në zhvillimin hapësinor;
Iniciativa planifikuese në qytetet e shkallës së dytë (jashtë Tiranës) dhe tendenca pozitive për zbatimin e elementeve kryesorë të planeve;
Organizimi i konkurseve ndërkombëtare për zhvillimet urbane të qendrave të qyteteve kryesore, kryesisht të Tiranës;
"Në pritje të planeve"... ndërhyrje "agopunturë" dhe/ose "makljazh" në qytet;
Pas bumit... rënia e sektorit të ndërtimit... kriza globale...
Ndihet nevoja për profesionin e planifikuesit/menaxherit urban.

Pas viteve 2000, shoqëria shqiptare është përballur me sfidën e madhe të stabilizimit të një shoqërie të hapur dhe demokratike, duke ndërmarrë reforma ekonomike që kanë stimuluar rritje dhe zhvillim të shpejtë të vendit dhe në kuadrin e të cilave supozohet që territori, prona private dhe ekonomia e tregut të konsiderohen si gurë themeli. Por kjo natyrisht nuk ka qenë një rritje e lehtë dhe pa kosto. Sot, edhe pse është kuptuar se territori është shtrati mbi të cilin ndërtohet e tashmja dhe perspektiva e shoqërisë, pak është bërë për ta materializuar realisht këtë tezë, edhe pse duhet pranuar se, në ndryshim nga shoqëritë diktatoriale, në demokraci administrimi i territorit dhe i resurseve bëhet më kompleks dhe më i vështirë. Kjo edhe për faktin se interesi publik duhet të mbrohet duke respektuar maksimalisht të drejtat e individit.

Ndërkaq, instrumentet kryesorë planifikues gradualisht po tentojnë të reformohen, edhe pse ka një hezitim dhe rezistencë tradicionale ndaj aplikimit të tyre. Pikësëpari, nën ndikimin e një fryme të ardhur nga donatorët e huaj dhe më tej nga organizata si Co-PLAN, gjithmonë e më shumë po flitet për nevojën për Plane Strategjike/Veprimi kundrejt Planeve Rregullues, për Programe Zhvillimi kundrejt planeve tradicionalë rregullues/fizikë apo për inkurajim Procesesh më tepër sesa për hartim Projektesh. Paradigma që vitet e fundit tenton të bëhet predominuese në Shqipëri është krijimi dhe konsolidimi i profesionit të Planifikuesit të Territorit si një menaxher publik dhe administrator politik, pjesëtar dhe koordinues i përpjekjeve të ekipeve të ekspertëve dhe vendimmarrësve të interesuar për problematikat e vendbanimeve njerëzore. Instituti Co-PLAN dhe mendimi që ai përfaqëson po jep një kontribut konkret për ngritjen e këtij profesioni, sidomos përmes nismës më të fundit, themelimit të Universitetit Polis si një shkollë alternative për arkitekturën dhe planifikimin urban në Shqipëri dhe rajon.

Rithemelimi i "urbanistikës" ?! Nga urbanistika... tek planifikimi urban.


Duhet nënvizuar se, me gjithë përpjekjet e dekadës së fundit - shpesh sporadike, administrimi dhe zhvillimi i territorit në Shqipëri mbetet ende i keqkuptuar shkencërisht dhe i keqtrajtuar politikisht. Kështu, gjatë njëzet viteve të fundit, janë prodhuar 3-4 iniciativa ligjore mbi planifikimin e territorit por të gjitha kanë qenë të kontestuara dhe praktikisht të dështuara. Në këtë amulli të krijuar, një gjë është ende e sigurt: ajo që në gjuhën popullore njihet me emrin "urbanistikë", mund të thuhet se ka dështuar në kuptimin e vet ligjor dhe historik por, për fat të keq, ende nuk ka pushuar së ekzistuari si një sistem që ende "gëlon" në mentalitetet e trashëguara të profesionistëve dhe vendimmarrësve! Ndërkohë, gjatë këtyre dy dekadave, nuk është dhënë ende mundësia e lindjes së një sistemi të ri modern të planifikimit të territorit. Ajo që është më alarmuese është se sistemi i dështuar i "urbanistikës tradicionale" mbetet ende i pakallur dhe po helmon përditë e më shumë ambientin ku projektohet perspektiva e vendbanimeve shqiptare. Pa mohuar disa merita të kohës së vet, sot urbanistika shqiptare tradicionale në kuptimin e "kodeve dhe distancave" është shndërruar më shumë në një alibi administrative për abuzimet që bëhen me territorin. Ajo është bërë kështu si një lloj mbetjeje toksike e të kaluarës, duke paraqitur praktikisht një kërcënim shqetësues për fatet e zhvillimit normal dhe të qëndrueshëm të vendit. Për ta parë këtë mjafton t'i hedhim një vështrim të shpejtë mjedisit që na rrethon dhe nuk mbetet më shumë vend për komente...

Dhe ndërsa "urbanistika tradicionale" vazhdoi të "ngjyroste projekte të fryra" dhe larg kërkesave të realitetit, në vitet e fundit, pranë qendrave më të mëdha urbane dhe në zonat perëndimore të vendit, nisën të krijoheshin spontanisht lagje dhe qendra të reja të banuara, shumica pa plane ose, në rastin më të mirë, me plane urbanistike mediokër, pa infrastrukturë dhe shërbime, me të vetmin princip "interesin e ngushtë dhe gati kriminal individual". Nga ana tjetër, rajone periferike në veri dhe jug të vendit u braktisën pothuajse krejtësisht. Kështu, në rajonin e kryeqytetit Tiranë, popullsia është trefishuar dhe sipërfaqja e ndërtuar më së paku është dyfishuar, duke krijuar një model urban sa energjik aq edhe problematik. E njëjta situatë ekziston edhe në rajonet kryesore të bregdetit shqiptar dhe në qendrat më të mëdha urbane të vendit. Në këto zona trafiku është bërë i papërballueshëm dhe qytetarët humbasin çdo ditë mesatarisht 2-4 orë në trafik dhe ajër të rënduar. Ndërkohë, edhe ujërat nëntokësore janë të ndotura dhe kjo situatë rrezikon të konvertohet shumë shpejt në kosto të larta sociale.

Në këto kushte, njerëzit e kanë marrë situatën vetë në dorë, duke i dhënë zgjidhje çmimeve të larta të një tregu përjashtues, duke shmangur procedurat burokratike dhe shpesh të korruptuara të administratës publike e duke investuar në mënyrë graduale. Por, të izoluara dhe të injoruara siç janë shumica e këtyre komuniteteve, ato rrezikojnë të krijojnë precedentin e rrezikshëm të ndarjes sociale, duke krijuar de facto brenda vendit dy botë rrënjësisht të ndryshme, hendeku në rritje i të cilave mund të provokojë tensione sociale dhe konflikte politike. E vetmja alternativë racionale në këto kushte duket se është fryma e një planifikimi realist gjithëpërfshirës që inkurajon integrimin e njerëzve dhe një ekonomi tregu ku asetet dhe bizneset informale ngërthehen me ekonominë zyrtare. Presioni në rritje që po artikulohet nga poshtë për shkak të premtimeve politike i ka detyruar autoritetet politikëbërëse dhe vendimmarrëse që t'i futen një procesi kombëtar formalizimi. Por, formalizimi i ekonomisë pa një reformë të plotë të sistemit të planifikimit dhe të qeverisjes urbane mund të cenojë shpresën se një ditë këto probleme do të mund të zgjidhen edhe në Shqipëri. Në këtë situatë, është emergjente të vijohen reformat e thella që lidhen me fushën e planifikimit, zhvillimit dhe administrimit të territorit. Në fakt, kjo mbetet një nga sferat ende më të pareformuara të qeverisjes në Shqipëri. Akoma më i ngutshëm bëhet riorganizimi i institucioneve akademike-shkencore në këtë fushë, ku duhet të prezantohen sa më parë konceptet bashkëkohore. Shqipëria ka nevojë për një investim kolosal për ngritjen e kapaciteteve lokale në fushën e planifikimit dhe administrimit të territorit, nëse kërkohet ndryshimi i mentalitetit; pa folur për nevojën për të luftuar inercinë ekstreme të krijuar, sipas së cilës njerëzit "kanë marrë në dorë situatën" dhe as që e çajnë nëpër mendje të respektojnë ligjet!

Pikërisht për këtë qëllim, ky botim, duke përmbledhur përvojën unike të Institutit Co-PLAN dhe të partnerëve të tij gjatë 15 viteve të fundit, shpreson se mund të japë një kontribut dokumentar sado modest në funksion të analizave për reforma të mundshme për këtë sektor jetik. Vetë përvoja e Co-PLAN ka qenë një përpjekje për të krijuar modele shprese dhe rregulli në një situatë politike dhe sociale spektri i së cilës lëviz midis zbrazëtisë së "vakumit" institucional dhe "energjisë" së pashtershme të njerëzve dhe shoqërisë...

HAPSIRA PUBLIKE




1
Nga qyteti i nevojave bazë, tek qyteti i më shumë mundësive...

Kur mund të përdorim fjalën "qytet" për të përcaktuar vendbanimet njerëzore? Historikisht, me fjalën qytet nënkuptohet një proces i veçantë i formimit të vendbanimeve njerëzore të organizuara nga pikëpamja sociale...



...një "Bathore" e dytë po ngrihet edhe në Durrës – ...po ngh Bathorizimi i Shqipërisë – është Bathorizuar territori – në Shqipëri çdo qytet, i madh apo i vogël një "Bathore"... Ç'thua more? Do t'i shkatërrojmël... Ore, Bathorja është lule, po s'ke parë ç'po bëjnë me le kitektët e ndërtuesit në Golem... masakër... Po në "Bllok", në Tiranë, i ke parë? S'po lënë hapësir ublike pa zaptuar... Bathorja është në rregull për vete... se janë si "qyteti-kop ... Seç ka nisur dhe Banka Botërore një projekt atje... More vesh, u hapën hapësirat... rrugët... u shtrua një kanal 120 cm... egjithatë, Nuja nuk e "hap akoma cepin"... Shtëpia e tij në fshatin nga vjen ishte 1 larg rrugës kryesore... Ai ka në oborr një shtyllë tensioni të lartë... Vajza e tij u kthye në shtëpi natën e pt martesës... hahaha. Edhe Ballshi u bë me Bathoren e vet. U miratua studimi urbanistik i zhvillimit të G të Lalzit... porto-marina më e madhe në Ballkan... Më tha një investitor serioz izraelit... flitet se Tirana do bëhet Nju Jorku i Ballkanit...

...thonë që do të na japin letrat... Gjini pati shans se i ra shtëpia mu në rrugë k e... mjaft të hapte një "dritare" nga brenda oborrit dhe filloi menjëherë shitjet... Një javë më vonë të gjithë komshinjtë bënë jëjtën gjë... Ore po ata çunat e projektit urban flasin të gjithë njësoj, sikur i ka lindur "e njëjta nën Kur do të na i rregulloni rrugët se na u shkatërruan Bencat... Atje mungon "sheshi Skënderbej", vetëm herë do të arrijë zhvillimi... Në fakt, si fillim, mjafton të ndalojë autobusi diku dhe... Duhet të na thoni çmimin e tokës, ndryshe nukjmë... Punimet janë bërë me hile... na rrofshin tubat se nuk ka ujë... Unë sa të mundem do t'i pengoj... komuniteti e banorët po i bashkohen projektit... Ta mbaroj shtëpinë para se ta fotografojnë nga qi o të paktën çatinë... Do t'ju japim letrat e shtëpive... Pastaj edhe po të më "bjerë plani", pa gjë nuk do betem... Para se të më bjerë plani, do ta shes tokën time dhe jam lidhur me dikë që do të ndërtojë tëkatësh... Jam në rrugë kryesore unë... kam edhe sheshin përballë... kush nu merr tokën mua... Të paktën fëmijët e mi....





PREAMBULA

"Copëza" nga kronika të ditarëve tanë, Nr.1 (1993-2005)

Në një kodër pranë Tiranës dhe rrethinave të saj, të cilës më parë askush nuk ia dinte emrin... Bathore, në Ndërmarje Bujqësore Kamëz, filluan të duken pirgje gurësh... apo baraka të ngjashme me ato të "aksionistëve" të vendosura nëpër brezare. Pamja e tyre nga rruga nacionale ishte e qartë, por askujt në atë kohë nuk ia priste mendja që pikërisht këto ishin paralajmërueset e një "tsunami" valët e para të të cilit kishin arritur... Janë të përkohshme... Kjo ishte çka shumica e shqiptarëve mendonin në atë kohë...

...një "Bathore" e dytë po ngrihet edhe në Durrës – ...po ndodh Bathorizimi i Shqipërisë – është Bathorizuar territori – në Shqipëri çdo qytet, i madh apo i vogël, ka një "Bathore"... Ç'thua more? Do t'i shkatërrojmë!... Ore, Bathorja është lule, po s'ke parë ç'po bëjnë me leje arkitektët e ndërtuesit në Golem... masakër... Po në "Bllok", në Tiranë, i ke parë? S'po lënë hapësirë publike pa zaptuar... Bathorja është në rregull për vete... se janë si "qyteti-kopsht"... Seç ka nisur dhe Banka Botërore një projekt atje... More vesh, u hapën hapësirat... rrugët... u shtrua një kanal 120 cm... e megjithatë, Nuja nuk e "hap akoma cepin"... Shtëpia e tij në Fshatin nga vjen ishte 11 orë larg rrugës kryesore... Ai ka në oborr një shtyllë tensioni të lartë... Vajza e tij u kthye në shtëpi natën e parë të martesës... hahaha. Edhe Ballshi u bë me Bathoren e vet. U miratua studimi urbanistik i zhvillimit të Gjirit të Lalzit... porto-marina më e madhe në Ballkan... Më tha një investitor serioz izraelit... flitet se Tirana do të bëhet Nju Jorku i Ballkanit...

...thonë që do të na japin letrat... Gjini pati shans se i ra shtëpia mu në rrugë kryesore... mjaft të hapte një "dritare" nga brenda oborrit dhe filloi menjëherë shitjet... Një javë më vonë të gjithë komshinjtë bënë të njëjtën gjë... Ore po ata çunat e projektit urban flasin të gjithë njësoj, sikur i ka lindur "e njëjta nënë"... Kur do të na i rregulloni rrugët se na u shkatërruan Bencat... Atje mungon "sheshi Skënderbej", vetëm atëherë do të arrijë zhvillimi... Në fakt, si fillim, mjafton të ndalojë autobusi diku dhe... Duhet të na thoni çmimin e tokës, ndryshe nuk paguajmë... Punimet janë bërë me hile... na rrofshin tubat se nuk ka ujë... Unë sa të mundem do t'i pengoj... komuniteti dhe banorët po i bashkohen projektit... Ta mbaroj shtëpinë para se ta fotografojnë nga qielli... po të paktën çatinë... Do t'ju japim letrat e shtëpive... Pastaj edhe po të më "bjerë plani", pa gjë nuk do të mbetem... Para se të më bjerë plani, do ta shes tokën time dhe jam lidhur me dikë që do të ndërtojë një tetëkatësh... Jam në rrugë kryesore unë... kam edhe sheshin përballë... kush nuk ma merr tokën mua... Të paktën fëmijët e mi....

Retrospektivë "0" – 1993

...Mision identifikimi i organizatës zhvilluese Cordaid Holandë (në atë kohë Cebemo dhe më vonë Mensen in Nood) në Shqipërinë postkomuniste.

...krahas problemeve të shumta, ekspertët Jan Last dhe më vonë Joep Van Zijl identifikojnë në terren shenjat e para të një vale informaliteti në arritje, nevojën urgjente për

t'i paraprirë kësaj situate me organizim dhe planifikim komunitar, mungesë të kapaciteteve lokale për të trajtuar me realizëm situatën dhe për të filluar një proces planifikimi me pjesëmarrje komunitare...

...në këto kushte, ndërsa do të punohej për identifikimin dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme lokale, Cebemo konsideroi kooperimin me Qendrën "Don Bosko", një program zhvillimi social në një zonë në periferi të Tiranës (Breglumasi-Laprakë ose zona e ish-fabrikës së materialeve të ndërtimit "J. Pashko"), financuar nga Kisha Katolike Romë dhe zbatuar nga OJF-ja Italiane VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo).

Valë të reja... Shenjat e para të neglizhencave...
Në 4 vitet e para të tranzicionit (1991-1994), popullsia e Tiranës u rrit me një ritëm prej 7-9% në vit ose 30-35 mijë banorë/vit, baras kjo me 3-4 qytete si Tepelena. Kjo shënoi fundin e traditës shqiptare të qyteteve të rrethuara me "mure virtuale", – ose siç quheshin në atë kohë "vijat e verdha" kufizuese të qyteteve - gjë që çoi në shtrirjen e qyteteve përtej "vetes së tyre", drejt periferive të cilat po zhvilloheshin. Duket se mekanizmi i deriatëhershëm i përqendrimit urban po përmbysej, duke i lënë vendin një shpërhapjeje të pashoq deri atëherë në qytetin shqiptar... një shpërhapjeje të pakontrolluar... Kjo krijoi premisa që, në rajonet më të zhvilluara të vendit, doradorës, qyteti tradicional të rrijëzonte rajonet metropolitane të ardhshme... që ishin ende pa identitet dhe përkatësi... ende të palidhura mirë me transport me qendrat kryesore.

Kështu, Shqipëria e fillimit të viteve '90, hyri në një tranzicion radikal politik-ekonomik-social për të kaluar nga ekonomia e centralizuar drejt ekonomisë së tregut. Për 4-5 dekada, pothuaj gjithçka ishte përgjegjësi e autoriteteve, përfshi strehimin dhe punësimin. Prona private dhe besimi fetar u mohuan me kushtetutë. Por, papritur, koncepte si demokracia, pluralizmi, lëvizja e lirë, ekonomia e tregut, prona private, të drejtat e njeriut, edhe pse pa u kuptuar tërësisht, filluan të hyjnë në fjalorin e përditshëm. Në të njëjtat kushte, edhe autoritetet ishin të papërgatitura, si me burime financiare ashtu edhe me njohuri, ndërsa "prioritetet" politike të vendit ishin të panumërta. Kështu, planifikimi dhe administrimi i territorit u konsideruan ndër problemet e shumta periferike. Iniciativa iu la në dorë tërësisht qytetarëve dhe komuniteteve. Si pasojë e kësaj situate, - mungesës së politikave dhe kapaciteteve të administratës publike - u shfaqën shenjat e para të moskuptimit të nevojës për forma të reja dhe alternative planifikimi, të cilat mund të parandalonin kaosin dhe të orientonin investimet private që nesër do të mund të plotësoheshin më mirë nga investimet publike.

Pikërisht për të sensibilizuar e pilotuar koncepte të reja dhe për të ngritur kapacitetet e duhura - për një vend si Shqipëria e fillimit të viteve '90 - rol të rëndësishëm luajtën organizatat dhe projektet e zhvillimit të mbështetura kryesisht nga struktura joqeveritare ose programe qeveritare bashkëpunimi bi/multilaterale. Co-PLAN ka qenë një nga pionierët në këtë fushë.

Nga neglizhenca... në "rezistencën" ndaj ndryshimeve!
Strukturat zhvilluese holandeze si Cordaid Hagë dhe IHS, Instituti për Studimin e Strehimit dhe Zhvillimit Urban, Roterdam, u bënë mbështetësit pionierë kryesorë në këtë drejtim gjatë viteve '90; i pari kryesisht për projekte të zhvillimit urban të zbatuara nga Co-PLAN, ndërsa i dyti kryesisht për zhvillimin e burimeve njerëzore lokale në fushën e planifikimit dhe menaxhimit urban, në bashkëpunim me Co-PLAN.



Njësia Speciale e Menaxhimit të Tokës (LMTF Land Management Task Force) pranë Ministrisë së Punëve Publike, ishte përpjekja e parë e Qeverisë Shqiptare, mbështetur nga USAID (1994-1996) me ekspertë të Njësisë së Planifikimit pranë Graduate School of Design, Harvard SHBA, për të analizuar dhe trajtuar fenomenet e reja që tashmë ishin krijuar në periferitë e Tiranës. Kështu, për herë të parë, u fol për zbatimin e skemave "truall dhe shërbim"[1] në zonën e ish-Kombinatit të Tekstileve Tiranë, ide e cila rezultoi të ishte e vonuar në kohë pasi toka u pushtua para se të përfundonte projekti. Gjithashtu, për herë të parë u fol dhe për mundësinë e planifikimit të rajonit të "Tiranës së Madhe" (Bashkia Tiranë, Bashkia Kamëz dhe komunat përreth) i cili vendoset në fokus të analizave dhe prognozave, të pabëra ndonjëherë më parë në Shqipëri, me synim hartimin më pas të strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të metropolit të ri. Iniciativa shërbeu për hartimin e vëzhgimeve socio-ekonomike realiste dhe nxjerrjen e konkluzioneve në lidhje me disa zona kryesore problematike të rajonit; por, për shkak të moskuptimeve dhe mosmarrëveshjeve midis institucioneve vendore e qendrore si edhe midis Bashkisë së Tiranës dhe komunave përreth, plani i "rajonit të madh" do të merrte rrugën e hartimit jo më parë se në pragun e viteve 2000. Ky plan, i cili përfundoi në vitin 2002, fatkeqësisht nuk arriti të marrë kurrë statusin e miratimit të plotë.Co-plan kordinoi integrimin e planit të Kamzës në planin strategjik te Tiranës së madhe dhe mbështeti fazën e konsultimeve publike të tij.

Edhe Qeveria Austriake asistoi në këtë periudhë Bashkinë Tiranë me ekspertët e saj në hartimin e një studimi për çështjet rregullatore urbane dhe ato të transportit publik. Ndër të tjera, studimi propozonte një skemë eficiente të transformimit të strukturës gati rurale të Tiranës sipas një koncepti modern urban, ku sektori publik dhe iniciativat private mbanin përgjegjësitë e tyre të qarta për hapësirën dhe infrastrukturën publike. Në të vërtetë, studimi u injorua nga autoritetet dhe, në praktikë, kostoja e

1 Truall dhe shërbime (site and services); pajisja e parcelave të tokës me infrastruktura të gatshme për ndërtim.

hapësirave dhe infrastrukturave publike që gjenerohej nga iniciativat private i faturohej pa të drejtë publikut. Në këto kushte, ku autoritetet e konsideronin të pamundur ta financonin këtë faturë, ajo mbeti praktikisht e pazbatuar dhe gati "jetim". Injorimi i kësaj skeme çoi më vonë në ngritjen e një sistemi abuzimesh përmes lejeve urbanistike që jepeshin mbi bazën e parimit të distancave teknike, të përfitimit individual dhe të parcelave urbane dhe jo mbi bazën e konceptit të impaktit mbi interesin publik dhe qelizën urbane. Po kështu ndodhi edhe me studimin mbi rrjetin e kanalizimeve të Tiranës, financuar nga Qeveria Japoneze përmes JICA-s.

Në fakt, proceset planifikuese që po kryheshin për herë të parë hasën në vështirësinë e të kuptuarit nga ana e ekspertëve të paktë dhe veçanërisht nga planifikimi zyrtar tradicionalist i përfaqësuar nga institucionet vendase të cilat po tregoheshin "refraktare" ndaj përdorimit të metodave të reja në planifikim, kryesisht për shkak të frikës ndaj ndryshimit dhe humbjes së status quo-së, duke pretenduar se ajo çka po hynte si e re në "gjuhën e planifikimit" nuk ishte planifikim i mirëfilltë.

Ndërkohë, urbanistika zyrtare jetonte "botën virtuale", gjë që çoi në thellimin e krizës. Sikurse sistemi ekonomik apo sistemi i drejtësisë që duhet të reformoheshin krejtësisht, edhe sistemi i planifikimit duhet t'i nënshtrohej të njëjtës hapje. Mirëpo, planifikimi urban mbetej përkundrazi ende pre e mendësisë totalitare, ku shteti ishte i vetmi aktor detyrues... rasti tipik në të cilin institucionet kthehen në të kundërtën e tyre... në pengues të sistemit dhe shkaktarë të gjendjes depresive... Megjithatë, kjo situatë do të sillte më vonë, si në nivel teorik ashtu edhe praktik, fillimin e riorganizimit të eksperiencave për t'u hapur ndaj një paradigme të re. Në vijim të kësaj situate, aktorë të rëndësishëm do të bëheshin edhe Banka Botërore apo Qeveria Holandeze etj, përmes projekteve të zhvillimit të përfaqësive të tyre në Tiranë.







Breglumasi - sipas origjines se banoreve

Retrospektivë "1" – 1995-1997
Kronikë... nga projekti Breglumasi tek Co-PLAN-i

Zona informale Breglumas: Hartohet e zbatohet "Projekti pilot urban"

Cordaid Holandë dërgon në Shqipëri menaxherin e programit...

Sef Slootweg, veç detyrës për të zbatuar projektin në bashkëpunim me Qendrën 'Don Bosko', identifikoi staf për të ndërtuar kapacitetet lokale dhe për të transferuar përgjegjësinë.

Dritan Shutina, Luan Deda, Besa Tarazhi dhe vullnetarët socialë italianë e shqiptarë të Qendrës Sociale 'Don Bosko' formojnë skuadrën e parë që filloi punën në terren.

Besnik Aliaj, pedagog në Universitetin Politeknik Tiranë, i bashkëngjitet ekipit të projektit të Breglumasit. Ai inkurajohet nga John Driscoll për të kryer studimet pasuniversitare në Holandë. Tema e tij e diplomës trajton opsionet e strehimit dhe planifikimit në kushtet e tranzicionit në Shqipëri, ku ilustrohet edhe përvoja e projektit në Laprakë.

Projekti përfundon me sukses në verën e vitit 1997 në kushtet e trazirave social-politike për shkak të dështimit të skemave të financimit piramidal. Komuniteti mbroji investimet e projektit sepse ndjeu bashkëpronësinë, ndryshe nga shumë projekte qeveritare dhe të financuara nga donatorë të tjerë, të cilat u vodhën apo u dëmtuan seriozisht.

Thyerja e mentalitetit... Provat e para.
...Një përfaqësi komunitare e mbi 500 familjeve të zonës me mbi 3,000 banorë u identifikua dhe konsolidua përmes një procesi zgjedhjesh demokratike. Përfaqësia u regjistrua në gjykatë si OJF dhe u vendosën kontaktet e para me autoritetet lokale.
Zona u planifikua me konsensusin e të paktën 75-80% të banorëve. U ngrit një qendër sociale komunitare, me ambulancë, kopsht dhe terrene sportive, ku komuniteti mbuloi të paktën 20% të kostove.


Tre kilometra rrugë dhe hapësirë publike u rihapën dhe përmirësuan përmes proceseve me pjesëmarrje. Hapja e çdo gardhi, muri konsiderohet si ndryshim mentaliteti... thyerje e barrierave.

U punua me grupet e cenueshme: të rinjtë, gratë dhe fëmijët.

Projekti u vlerësua zyrtarisht nga organizata financuese Cordaid dhe nga eksperti i pavarur Peter Nientied, IHS Roterdam.

Pas një procesi reflektimi, stafi shqiptar e koncepton projektin si një organizëm joqeveritar, jofitimprurës dhe jopolitik duke e regjistruar atë zyrtarisht në Gjykatë në nëntor 1997 me emrin Co-PLAN, Qendra për Zhvillimin e Habitatit.

Fjala kyçe konsiderohet "procesi"... për të investuar dhe për të kuptuar e për t'u rritur së bashku me përfituesit. Kështu, një ekip ekspertësh të rinj shqiptarë, të trajnuar dhe asistuar nga institucione të specializuara ndërkombëtare, arritën të pilotojnë me sukses në Tiranë një projekt planifikimi me pjesëmarrje komunitare në një zonë prej rreth 30 hektarësh dikur e planifikuar për qëllime industriale, ndërkohë që de fakto ishte zhvilluar për qëllime vetëstrehimi.



Plani strategjik i Tiranës së madhe
Hartar nga PADCO dhe projekti Menaxhimi i tokës urbane (ULMP), 2001

Mësime Planifikimi:

"Kokëposhtimi" i sistemit të planifikimit... Premisa për fillimin e "Luftës" për ndryshimin e paradigmës tradicionale të planifikimit

Që me fillimin e procesit të ndryshimeve politike dhe ekonomike në fillim të viteve '90, procesi klasik i sekuencave të planifikimit – Përgatitja e *Planit, Pajisja me infrastrukturë, Ndërtimi i banesave dhe Popullimi* – në realitet u shfaq i deformuar në një sistem gati "kokëposhtë"; ardhja e banorëve paraprin dhe ai që priret të kryhet në fund të procesit është planifikimi, i cili në këtë rast synon të përmirësojë sadopak situatën e zhvillimeve spontane. Kjo situatë jonormale është tipike sidomos në zonat me ndërtime informale, por nuk përjashtohen as zonat me ndërtime të reja, me projekte të bëra nga arkitektët, të ashtuquajtura "me leje". Në këto kushte, kur probleme të qarta ekzistojnë ndërsa autoritetet janë pothuaj joekzistente, identifikimi dhe legjitimimi i lidershipit lokal bëhet domosdoshmëri. Ndërtimi i konsensusit social midis komunitetit dhe qeverisjes, për t'i parë komunitetet si partnerë në hartimin e një plani realist të zbatueshëm për përmirësime fizike dhe sociale, jo vetëm ndihmon që të identifikohen nevojat dhe prioritetet, por edhe lehtëson pjesëmarrjen e tyre në zbatimin e planeve.

Sfida kryesore e kësaj përvoje është kapërcimi i mentalitetit dhe pranimi se planifikimi nuk është baras vetëm me dimensionin fizik dhe nuk është domosdoshmërisht një dizajn grafik "perfekt", çka ishte tipike për mënyrën tradicionale të hartimit të planeve në atë kohë në Shqipëri nga institucione apo studio të shkëputura nga realiteti. Ndërsa gjetja e zgjidhjeve për planifikimin urban në nivel kombëtar kërkon analizë të gjerë politike, ekonomike dhe sociale, çdo gjetje në shkallë të vogël duhet të testohet paraprakisht dhe me përfituesit e vërtetë.

Themelimi i një institucioni profesional dhe kërkimor alternativ si Co-PLAN, jashtë ndikimeve të praktikave zyrtare të planifikimit, ishte një risi që ngjalli debat pozitiv, por edhe mjaft kundërshtime në një mjedis thuajse të kalçifikuar të planifikimit të territorit.

"Humnera" midis sistemit zyrtar të planifikimit dhe realitetit...

Analizimi dhe kuptimi i impaktit të paradigmës tradicionale të planifikimit në Shqipëri ka rëndësi parësore pasi elementë të saj ende paraqesin rezistencë të fortë ndaj praktikave të reja të planifikimit. Sikurse u përmend edhe më sipër, modeli i planifikimit i cili përpiqej t'i jepte zgjidhje realitetit kompleks që po krijohej në Shqipërinë e asaj kohe, ishte ai të cilin Taylor dhe Williams[1] e quajnë "paradigma tradicionale" e planifikimit. Kjo pasqyrohej në strukturat institucionale joefektive dhe në mungesën e mekanizmave për të ndjekur zbatimin e planeve; në vetë qëllimin e planifikimit: pra, nëse planifikimi synon të adresojë në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjet sociale, ekonomike, politike dhe fizike apo qëllimi i tij është i ngushtë; në atë se çfarë metadash përdorin planifikuesit për të arritur qëllimin. I rëndësishëm në këtë aspekt është lloji i procesit të planifikimit, pra sekuencat dhe hapat që ndiqen në praktikën e planifikimit.

Paradigma tradicionale presupozon gjithashtu arritjen e zgjidhjeve në kuadrin e kompleksitetit perfekt të të dhënave. Por, sikurse praktika ka treguar, në realitet veprohet në "paqartësi" dhe "joperfeksion" të të dhënave përgjatë të gjitha fazave të planifikimit. Nisur nga kjo, ky model mund të quhet si *utopi, pasi njohja nuk është kurrë e kompletuar*. Kjo duhet marrë parasysh që në fazën e hartimit të objektivave. Nga ana tjetër, duhet theksuar se mbledhja e *informacionit ka kosto të lartë* dhe normalisht duhet të ndalet aty ku kostoja fillon të bëhet më e lartë se ajo që përfitohet.

Shembull tipik i këtij modeli të planifikimit është "Modeli i Masterplanit", i cili synohej nga institucionet zyrtare të kohës si "instrumenti" i cili automatikisht do të sillte ndryshimin e situatës. E ndërsa prisej pafund që të dhënat të grumbulloheshin, (ndonjëherë edhe të dhëna të cilat nuk dihej përse do të përdoreshin dhe që kërkoheshin në mënyrë të shkëputur nga specialistë të veçantë të cilët humbnin krejtësisht lidhjet me atë që ishte objektivi kryesor: hartimi i një plani) realiteti ndërtohej sipas "ligjësive" sociale të cilat nuk kishin asnjë sintoni me këtë sistem që ekzistonte vetëm në letër.

"Masterplani" mund të konsiderohej si një "fotografi" e së ardhmes së qytetit që tregonte se si do të ishte përdorimi i tokës dhe pëlhura e qarkullimit duke u bazuar në tendencat e së tashmes. Kjo paradigmë e zhvilluar gati njëqind vite më parë, e cila buron nga tradita inxhinierike dhe arkitektonike, ka këto karakteristika kryesore[2]: (i) theks kryesor mbi parashikime shumë afatgjata, zakonisht 20-30 vjeçare, të cilat kanë tendencën të jenë jorealiste dhe nuk janë të fazuara qartë; (ii) zotërim i produktit ndaj procesit: realizimi i një harte "blueprint"[3] ishte më shumë një qëllim në vet-

1 John L. Taylor and David G. Williams – Urban Planning Practice in Developing Countries, Pergamon Press – Oxford, New York, Toronto, Sydney, Paris, Frankfurt, 1982

2 John L. Taylor and David G. Williams – Urban Planning Practice in Developing Countries, Pergamon Press – Oxford, New York, Toronto, Sydney, Paris, Frankfurt, 1982

3 Quheshin të tilla për shkak të letrës ngjyrë blu të heliografimit. Këto ilaç planesh janë përdorur edhe në Shqipëri, madje edhe në versionin ngjyrë rozë

Approved

Not Approved

Panding

Development framework
of Tirana - Durres coridor

Regulatory Plan
for Tirana

Strategic Plan for
Greater Tirana

Strategic Urban Development
Pan of Kamza

Tirana oning Study

JICA Sewerage Stuly for
Tirana Region

Preliminary Structure Plan
of Tirana

Suburban Zone of Tirana

egulatory Plan of
rana

Plan for Municipality of
Tirana

990 1994 1995 1997 1999 2002 2005 2007 2009

"Odisea" e planeve të Tiranës
Përshtatur nga J Driscoll, Harvard Center for Urban Development Studies

vete se sa një mjet që duhet të nxiste një proces dinamik planifikimi. Ashtu sikurse një arkitekt trajtonte planimetrinë e një objekti, në të njëjtën mënyrë supozohej se riprodhohej edhe plani i qytetit, duke e konsideruar atë vetëm si një arkitekturë gjigante. E megjithatë, kjo qasje nuk arrinte të bënte të qartë se si qyteti do të mund ta arrinte këtë objektiv të konfiguruar; (ii) Theks të fortë mbi aspektet fizike: kjo qasje i kufizonte qëllimet e propozimeve të përdorimi i tokës, qarkullimi, infrastrukturat fizike dhe në përgjithësi vetëm te elementët që mund të tregohen në hartë; (iv) Kualiteti jostrategjik që shfaqej në përdorimin e tokës, i cili synonte të përcaktonte çdo centimetër të zonës urbane në mënyrën sa më ideale, në shpërndarjen e popullsisë dhe në industrializimin, edhe pse këto shpesh ishin jorealiste; (v) Mungesë të ndërveprimit me përfituesit dhe përdoruesit duke u kushtuar pak vëmendje nevojave dhe shqetësimeve të banorëve, sidomos shtresave me të ardhura të ulëta.

Ata që kanë punuar në Shqipërinë e atyre viteve nuk mund të mohojnë se, çfarë përshkruhet më sipër, është krejt e ngjashme me mentalitetin tradicionalist me tendenca të theksuara teknokratike që mund të gjeje në zyrat e Institutit të Urbanistikës apo edhe në korridoret e Ministrisë që mbulonte funksionin e planifikimit në atë kohë. Sipas ligjit të kohës, Instituti i Urbanistikës njihej si e vetmja agjenci e cila mund të hartonte të gjitha planet e zhvillimit rajonal dhe vendor (përfshi edhe masterplanet), për të gjithë territorin kombëtar. E ndërsa instituti jetonte akoma botën virtuale të lavdisë së të shkuarës komuniste, kur të gjithë qytetet dhe fshatrat duhet t'i "faleshin" atij për të marrë hartën që do të varte në mur kryetari i komitetit ekzekutiv, dhe të gjithë (përfshi edhe vetë institutin) ishin të vetëdijshëm për mungesën e burimeve njerëzore të specializuara si edhe të burimeve financiare, zhvillimet territoriale dhe urbane në Shqipëri kaluan thuajse krejtësisht jashtë kontrollit të të gjithë institucioneve qendrore dhe vendore. Imponimi i planeve të tipit "*blueprint*" në mënyrë autoritariste nga institucione të cilat nuk gëzonin më këtë legjitimitet, çoi në thellimin e mëtejshëm të kaosit duke rritur akoma më shumë "humnerën" midis tradicionalizmit që ende vazhdonte të imponohej dhe ligjësive të realitetit, analizës dhe marrjes seriozisht të të cilave akoma u bëhej rezistencë.

Tendenca kryesore në lidhje me teoritë e sotme të planifikimit

Planifikimi sipas hapave në rritje graduale (inkremental)
Modeli i planifikimit sipas hapave në rritje graduale përfaqëson një tendencë të rëndësishme në teoritë e sotme të planifikimit. Kjo teori, e inspiruar nga autorë si Lindblom[1] , u zhvillua si kritikë ndaj modelit racionalist i cili, sipas tyre, ishte jorealist për sa i përket mundësisë së planifikuesve për të grumbulluar dhe centralizuar të


1 Ch. Lindblom, The Science of Muddling Throw , 1959

nevojshëm përpara se të marrin vendime, por mund ta sigurojnë atë gjatë dhe pas kohës së marrjes së vendimeve nëpërmjet një procesi tentativash që pranon edhe gabimin. Shpesh ky proces quhet "të mësosh duke bërë" (learning by doing). Sipas kësaj teorie, objektivat nuk arrihen duke u bazuar në modelin e kompleksitetit perfekt (si në rastin e mëparshëm), por mbi bazën e hapave më të vegjël në rritje. Në këtë model supozohet që njohuritë që nevojiten për të marrë vendime janë të "shpërndara" (në shumë persona dhe institucione), në ndryshim nga modeli i parë (i centralizuar). Në vend që informacioni të jetë i centralizuar në një "super agjenci planifikimi" të vetme, ai zotërohet nga agjentë të ndryshëm që mund të jenë në departamente të ndryshme të qeverisë të cilat merren me një gamë të gjerë politikash zhvillimi, fushash të sektorit privat dhe grupesh interesi. Në këtë kontekst, përdorimi i teknikave dhe mekanizmave të negocimit është një mënyrë për të grumbulluar njohuritë/të dhënat e shpërndara, të cilat janë të domosdoshme për hartimin e politikave.

Planifikimi me bashkëpunim
Planifikimi me bashkëpunim përfaqëson një rrymë tjetër shumë të rëndësishme. Ky model përbën "sulmin" më radikal drejtuar qasjeve teknokratike racionaliste. Sipas autorëve si Healey[1], vendosja e theksit mbi njohuritë shkencore nga ana e planifikimit racionalist përjashton format e tjera të njohurive që shpeshherë ekzistojnë në mënyrë të heshtur në formën e sensit praktik të kryerjes së gjërave dhe konstatimeve etike apo morale të cilat janë të pamatshme nga ana shkencore dhe nuk mund të kthehen në tregues sasiorë.

Nga këndvështrimi i këtij modeli planifikimi, pretendimi i planifikuesve "ekspertë" lidhur me objektivitetin e planifikimit vuan nga subjektiviteti i vlerësimeve, pasi edhe teknika të quajtura neutrale, si analiza e kostove sociale, janë subjektive. Ndërsa modeli inkremental përfaqëson një përmirësim në krahasim me modelin e planifikimit racionalist (zgjidhje e supozuar në kuadrin e kompleksitetit perfekt të të dhënave), ai përsëri duket se privilegjon rolin që luhet nga profesionistët ekspertë në vend që këta të fundit të bazohen mbi njohuritë lokale/subjektive të publikut në përgjithësi. Njohuritë të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë procesit të planifikimit, sipas Healey dhe pasuesve të tij, janë shumë më të decentralizuara sesa në modelet të cilat vënë ekspertët në qendër të vëmendjes. Një situatë ideale institucionale për hartimin e politikave do të kërkonte një formë planifikimi me pjesëmarrje ku të gjithë të interesuarve (të implikuarve) në proces t'u jepej shansi të thoshin fjalën e tyre. Kjo mënyrë lidhet me teoritë e "fuqizimit të qytetarëve" (empowerment – dhënie të drejtash) që nënkupton pjesëmarrje publike të një shkalle të lartë në vendimmarrje. Kjo krijon shanse për mosmarrjen e vendimeve arbitrare dhe rrit ndjenjën e përgjegjësisë ndaj procesit të planifikimit duke maksimizuar atë lloj informacioni i cili nuk do të mund të grumbullohej në asnjë nga modelet e planifikimit të përmendura më sipër ku teknokratët veprojnë të izoluar nga aktorët e tjerë.

1 P. Healey, Collaborative Planning, London 1997






Bathore 1
Dendësia 1997



Bathore 1
Dendësia 2002





Burimi Co-Plan & ULMP

"Kokëposhtimi" i sistemit të planifikimit.....

"Humnera" midis sistemit zyrtar të planifikimit

"rezistenca" ndaj ndryshimit

Lufta për ndryshimin e paradigmës tradicionale ë planifikimit

Zhvillim sipas sistemit tradicional

Planifikimi

Ndërtimi I Infrastrukturave

Ndërtimi I banesës

Popullimi

Ekonomi e centralizuar

100% Toke shtetërore

Banesa shtetërore

Planifikim I centralizuar

Lëvizje e kontrolluar e popullsis

Ekonomi e tregut

Tokë e privatizuar

Banesa private

Planifikim shumë sektorial

Lëvizje e lirë e popullsisë

Popullimi

Ndertimi I banesej

Ndertimi I

Planifikimi

Zhvillim Urban Informal

gjitha të dhënat si dhe mundësisë për të parashikuar efektet e mundshme që mund të vijnë si rezultat i zbatimit të politikave të propozuara prej tyre. Sipas Lindblom dhe përkrahësve të tij, planifikimi duhet parë si një proces në rritje i bashkëpunimit të pjesëzave të ndryshme që shpesh janë të shkëputura dhe jo të centralizuara. Gjithashtu, sipas tyre, planifikuesit urbanë nuk mund të njohin të gjithë informacionin e

Retrospektivë "2" – 1998-2003:
"Kontrasti" dhe sfida me sistemin vazhdon! Zgjidhja e problemeve reale...

Nga rrugë për shoqëri civile Breglumas tek zona pilot Bathore... dhe tek replikimi i modelit në shkallë të gjerë... Nga niveli komunitar... në nivelin e hartimit të politikave kombëtare për territorin.

"Programi: Rrugë për një Shoqëri Civile!". Hartohet dhe zbatohet në shkallë më të gjerë... Vijon konsolidimi i projektit pilot në Laprakë,Tiranë.
Replikohet i njëjti model në zona të tjera, sidomos në zonën më të madhe informale në vend, në veri të Tiranës, zona e Bathores, Kamëz. Pilotohet procesi planifikues në një zonë prej 13 hektarësh, për t'u zgjeruar më vonë, në faza të ndryshme, nga 100 deri në 250 hektarë. Por impakti shtrihej deri në 400 ha. Përfaqësitë komunitare dhe të grupeve të cenueshme përsëri konstituohen përmes një procesi demokratik dhe regjistrohen në gjykatë si subjekte ligjore. Ato udhëheqin në terren planifikimin dhe hapjen e mbi 6 km rrugë e hapësira publike dhe ngritjen e një qendre sociale-komunitare ku atashohen zyrat e autoriteteve vendore si dhe kopsht për fëmijët, terrene sportive, qendër shëndetësore dhe shërbime të tjera të koordinuara me institucione të ndryshme. Më tej, aktivitetet sociale synuan ndryshimin e mentalitetit për ndërveprim, së pari brenda komunitetit dhe më pas edhe midis komunitetit dhe autoriteteve.

Kjo përvojë pasohet nga dizajnimi dhe fillimi i një projekti qeveritar financuar nga Banka Botërore dhe mbështetur nga Qeveria Shqiptare, i njohur me emrin "Programi i Menaxhimit të Tokës Urbane" (ULMP) pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Rregullimit të Territorit. Ky projekt dha një kontribut për zhvillimin më tej të filozofisë së Co-PLAN të planifikimit me pjesëmarrje në shkallë të gjerë. Ekspertët vendas të Bankës Botërore Arben Baklamaja e Sotir Dhamo si dhe ekspertët e huaj John Driscoll, David Coock dhe Toru Konishi ishin ekspertët e parë që filluan zbatimin e këtij projekti.

Co-PLAN koordinoi aktivitetet e veta me ato të Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë për riaplikimin, në katër zona të ndryshme të qytetit, të konceptit të saj planifikues përmes skemave pilot që mund të frymëzonin autoritetet publike për dizajnimin e politikave dhe programeve të zhvillimit urban me një frymë bashkëkohore dhe fleksibël. Co-PLAN kreu studime të thelluara të profileve social-ekonomike të zonave në kuadrin e këtij projekti; identifikoi dhe fuqizoi lidershipin komunitar lokal; evidentoi skema qarkullimi dhe lehtësoi aksesin fizik dhe urbanistik të komuniteteve dhe, përmes mbështetjes së Cordaid, praktikisht "subvencionoi" projektin ULMP në Lagjet Bathore e Frutikulturë në Kamëz dhe Laprakë e "Mihal Grameno" në Tiranë. Lobimi me Bankën Botërore në Qeveri dhe Parlament për të aprovuar akte ligjore që do të siguronin zgjidhjen e çështjes së kthimit të pronave historike në zonat pilot, ka qenë një shembull tjetër i mirëkoordinimit midis Co-PLAN dhe ULMP.

Projekti "Menaxhimi i Tokës Urbane", i cili zbatonte filozofinë e pjesëmarrjes komunitare dhe ndarjes së kostove me autoritetet, studioi mundësinë e shtrirjes në qytete të tjera si Fier, Librazhd, Sarandë, Vlorë, Berat, zona të tjera të Tiranës etj. si dhe përfshiu projekte jo vetëm në zona me tipologji informale. Për të theksuar faktin që këto projekte nuk ishin

thjesht inxhinierike, por kishin në bazë krijimin e komuniteteve aktive dhe ndërveprimin e tyre me autoritetet, bashkitë pjesëmarrëse në këtë fazë të projektit u përfshinë në një konkurs ku për herë të parë autoritetet lokale duhet të tregonin se komunitetet përfituese nga projekti ishin të gatshme të kontribuonin në projekt. Në shkallë zyrtare, këto mund të konsiderohen si një impakt i rëndësishëm i filozofisë së planifikimit me pjesëmarrje përkundrejt planifikimit tradicional dhe shembujt e parë pozitivë të tij qenë arritur në projektet e Breglumasit dhe Bathores nga Co-PLAN. Sot, disa prej këtyre projekteve janë përfunduar me sukses.

Organizata zhvilluese holandeze Novib Hagë i bashkëngjitet projekteve të mbështetura nga Cordaid dhe së bashku mundësojnë programe zhvilluese në mbështetje të projekteve të Co-PLAN, sidomos për të asistuar ngritjen e kapaciteteve planifikuese të autoriteteve dhe komuniteteve lokale në Bashkinë Kamëz.

Në të njëjtën kohë, punohet edhe në qytete të tjera si Elbasan, Krujë, Peshkopi, Fier, Korçë etj., në zona me zhvillim formal apo me minoritete, bazuar në eksperiencën tashmë të konsoliduar të skemave pjesore urbanistike dhe të "axhendave të zhvillimit komunitar" në nivel lagjeje;

Hartohet vizioni i zhvillimit ekonomik dhe urbanistik të Bashkisë Kamëz. Plani Strategjik Urban i tij miratohet jo vetëm nga Këshilli Bashkiak, por edhe nga Qeveria Shqiptare. Ndërkohë, thellohet asistenca për ngritjen e kapaciteteve vendore dhe komunitare në koordinimin e ndihmës së huaj dhe OJF-ve si dhe në administrimin mjedisor e të shërbimeve publike apo të financave bashkiake. Programi ruan qëndrueshmërinë dhe efektshmërinë edhe në momentet e vështira të mungesës së stabilitetit politik në vend apo të krizës së refugjatëve nga lufta në Kosovë.

Programi ka një impakt përtej bashkisë Kamëz. Co-PLAN boton artikujt dhe publikimet e para, organizon Forumet Urbane, projekte pilot dhe fushata sensibilizimi në Tiranë dhe 15 qytetet kryesore të Shqipërisë si dhe realizon projektet e ngritjes së kapaciteteve në planifikim urban për administratën vendore dhe qendrore, në Shqipëri në bashkëpunim me IHS Roterdam dhe në Kosovë në bashkëpunim me UN-Habitat dhe OSBE.

Co-PLAN rritet me një staf prej 20-25 vetash dhe zhvillon një bërthamë energjike prej të paktën 15 ekspertësh si F. Kuçi, R. Toto, A. Tola, Th. Naçka, F. Nuri, A. Gjika, E. Goxhaj, O. Arapi, I. Faja, J. Cila, D. Nikolla, I. Duka etj. që kryejnë studime jashtë vendit dhe punojnë të pavarur. Ndërkohë, Co-PLAN merr vlerësime profesionale e ndërkombëtare nga UNDP dhe nga Banka Botërore. Organizata punon me standarde ISO dhe ndërton një sistem financiar të sofistikuar dhe transparent.

Në 2005, Co-PLAN paraqet një Platformë publike për administrimin e territorit dhe formalizimin e ekonomisë që i drejtohet Parlamentit dhe forcave politike. Pjesë të kësaj platforme do të adoptohen pas vitit 2005 në disa iniciativa ligjore të Parlamentit dhe Qeverisë si dhe në debatin politik të kohës. Në periudhën 2004-2005, drejtuesi ekzekutiv dhe rreth 10 ekspertë të Co-PLAN japin dorëheqjen në mirëkuptim me organizatën dhe angazhohen në politikë, administratën publike ose organizmat ndërkombëtare për ndjekjen në praktikë të zbatimit të kësaj Platforme. Ndërkohë organizata ruan pavarësinë dhe qëndrueshmërinë. Fjalët kyç të suksesit në këtë fazë janë: "qëndrueshmëria" - sidomos në kuptimin e investimit për kapacitetet e vetë organizatës dhe të partnerëve lokalë; "pronësia lokale" - në kuptimin e garantimit dhe transferimit të proceseve planifikuese dhe zhvilluese tek përfituesit; "impakti" - në kuptimin e ndikimit tek komunitetet në nivel lokal si dhe të vendimmarrjes e politikëbërjes në nivel kombëtar.



Mësimet e Nxjerra për Planifikimin

Aplikimi i modelit në shkallë më të gjerë në Tiranë e qytete të tjera bëhet një argument në favor të epërsisë së metodologjisë së planifikimit me pjesëmarrje në Shqipëri, pavarësisht kufizimeve dhe vështirësive që haste në zbatim, kryesisht për sjelljen e një mentaliteti të ri. Sidoqoftë, kalimi nga shkalla e komunitetit-lagjes në atë të qytetit-bashkisë ka kërkuar shpesh kreativitet dhe përshtatje të metodologjisë së planifikimit. Në këtë nivel, planifikimi bëhet më kompleks, sidomos në identifikimin e pikëtakimit të interesave komunitare dhe profesionale me ato të politikanëve e vendimmarrësve lokalë dhe qendrorë. Shpesh kjo kërkon neutralitet politik nga ana e planifikuesve si dhe aftësi të mira negocimi.

Co-PLAN konsolidoi në terren një strategji që adoptohet ndaj specifikave të çdo nivelli planifikimi. Kështu, në nivel komunitar, planifikimi me pjesëmarrje ka imponuar "riorganizimin" e lagjeve në njësi bazë ose qeliza urbane (të njohura si nënndarje me 15-25 familje-banesa që bashkëndajnë të njëjtën infrastrukturë dhe të njëjtat shërbime) ku nis nevoja për kompromis komunitar dhe vijedhënisht edhe nevoja për procese planifikimi dhe gjithëpërfshirjeje. Pikërisht mbi bazën e tyre janë hartuar më pas planet e zhvillimit fizik-social-ekonomik të secilës lagje ose, siç quhen ndryshe, Axhendat e Zhvillimit Urban Komunitar të Lagjes. Këto ushtrime planifikimi komunitar kanë garantuar bazën e konsensusit social dhe urbanistik duke u shërbyer autoriteteve vendore për të koordinuar dhe hartuar vizionet e tyre politiko-teknike për zhvillimin e qytetit/bashkisë në tërësi. Me pak fjalë, "axhendat e zhvillimit" të lagjeve lehtësojnë procesin e hartimit dhe miratimit të planeve rregullues/strategjikë të bashkive sepse në këtë mënyrë ata janë bërë praktikisht më të pranueshëm dhe më të zbatueshëm për autoritetet dhe komunitetet, ndryshe nga planet e ngurta dhe jorealiste të hartuara tradicionalisht të cilat janë praktikisht të papërdorshme në këtë situatë.

Në nivel qyteti, ka qenë e rëndësishme të bëhej koordinimi jo vetëm me autoritetet dhe komunitetet vendore, por edhe me institucionet qendrore dhe me vetë Qeverinë. Rast tipik ka qenë koordinimi i Planit të Zhvillimit Urban të Bashkisë Kamëz, që hartohej nga Co-PLAN, me procesin e planifikimit të rajonit të Tiranës së Madhe, i cili hartohej në kuadër të projektit "Menaxhimi i Tokës Urbane" (ULMP) të Qeverisë Shqiptare dhe financohej nga Banka Botërore. E ndërsa arriti rezultate pozitive në drejtimin teknik dhe konceptual, ky i fundit dështoi në koordinimin dhe njohjen nga Bashkia e Tiranës, pikërisht sepse palëve u mungonte procesi i planifikimit nga poshtë-lart, gjë e cila rezultoi e suksesshme në rastin e Planit të Zhvillimit Urban të Bashkisë Kamëz që hartohej nga Co-PLAN.

Thellimi i procesit të decentralizimit rriti shanset e aplikimit të metodologjisë me pjesëmarrje, por nga ana tjetër rriti dhe kompleksitetin e natyrës së problematikave vendore. Nuk duhet harruar se ndryshimet politike shpesh kanë provokuar ngadalësimin apo rikthimin e proceseve nga e para, shoqëruar kjo me dëmtimin e investimeve për kapacitetet e administratës publike.

Vetë evoluimi i shoqërisë shqiptare ndër vite, sidomos pas luftës në Kosovë, imponoi kalimin e natyrshëm nga koncepti i projekteve të natyrës së emergjencës, në ato të zhvillimit, duke i bërë sfidat edhe më të mëdha.

Retrospektivë "3" – 2000-2005

...në spirale të tjera...


Hartohet dhe zbatohet "Programi: Ndërtimi i urave të bashkëpunimit midis komuniteteve dhe autoriteteve!" - me synim thellimin e mëtejshëm të përvojave dhe metodologjisë së planifikimit me shumë aktorë, qoftë kjo në situata urbane agresive apo depresive.

Programi u mbështet nga Cordaid-Holandë dhe u koordinua me një sërë projektesh të mbështetura nga aktorë të ndryshëm si Novib dhe Qeveria Holandeze, Qeveria Austriake, Qeveria e SHBA, Fondacioni "Soros", FSHSC etj. Përvojat lidhur me planifikimin urban në këtë program dhe në këtë fazë të zhvillimit të Co-PLAN bazohen tek fjala kyçe "diversifikim" – i ekspertizës planifikuese, i partneriteteve dhe i burimeve.

Mësimet e Nxjerra për Planifikimin

...edhe këta nuk janë më mirë se Bathorja...

Co-PLAN teston konceptin e planifikimit komunitar në zona me status të qartë ligjor në pjesët "tradicionale" të Tiranës, në kushtet e degradimit të kualitetit të tyre urban. Eksperienca tregoi se filozofia e planifikimit me pjesëmarrje funksionon pothuajse njësoj si në zonat urbane informale edhe në ato formale. Në zonat formale, banorët shpesh janë edhe më të rezervuar dhe fillimisht hezitojnë për shkak të mosbesimit



Plani Strategjik Urban Kamez, fazat e zhvillimit
Burimi: Co-Plan

që lidhet ndoshta me zhgënjimin e krijuar nga neglizhenca historike e autoriteteve si edhe nga mungesa e besimit se të gjithë banorët mund të kontribuojnë; por, nëse ata ekspozohen me efektet pozitive dhe trajtohen me transparencë, ka më shumë gjasa të bëhen partnerë në ndryshim dhe në ndarjen e kostove.

Eksperienca e këtyre praktikave planifikuese tregon se sa më në nevojë dhe i përjashtuar të ndihet një komunitet, aq më i dëshiruar dhe aktiv për bashkëpunim bëhet ai. Në rastet e minoriteteve (p.sh. komunitetet Rome apo të personave me aftësi të kufizuar) proceset e pjesëmarrjes dhe planifikimit janë shumë më entuziaste dhe efektive, kryesisht për shkak të shkallës më të mirë të organizimit që nxitet ndoshta prej nevojës që kanë këto komunitete për të mbrojtur interesat e tyre si entitete kulturore-etnike.
Projektet ku u testuan këto ide ishin "*Projekti i përmirësimit urban në bllokun e banimit '1 Maji' Tiranë*", mbështetur nga Ministria e Punëve Publike dhe UNDP, dhe "*Projekti i përmirësimit urban në lagjen 'Allias' Tiranë*", mbështetur nga Novib-Holandë.

...gjenerimi i shpresës dhe energjive të fshehura...
Co-PLAN teston konceptin e planifikimit me pjesëmarrje në situata urbane me potenciale të pasura historike dhe kulturore, por në depresion ekonomik dhe zvogëlim të popullsisë. E tillë ishte përfshirja në Bashkinë Krujë në kuadrin e projektit "*Forcimi i pushtetit lokal dhe pjesëmarrjes së qytetarëve*" (1998-2009), financuar nga Qeveria Holandeze përmes VNG (Shoqata e Bashkive Holandeze) dhe mbështetur nga SHBSH (Shoqata Shqiptare e Bashkive). Ekspertëve të Co-PLAN iu kërkua të asistonin në zhvillimin e një koncepti fizibiliteti për detajimin e zonës prioritare të zhvillimit për qëllime strehimi, në kuadrin e Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit Krujë të hartuar në kuadrin e projektit të mësipërm, si edhe të mbështesnin procesin e miratimit të këtij plani, i cili ishte hartuar paraprakisht në kuadrin e një përfshirjeje të gjerë të komunitetit dhe grupeve të interesit, si një nga shembujt e parë të këtij lloji në Shqipëri.

Edhe në këtë qytet të vogël historik, për shkak të depresionit të krijuar nga kolapsi i ekonomisë kombëtare-lokale gjatë viteve '90, u inkurajua largimi-migrimi masiv i popullsisë duke krijuar një vakum demografik dhe ekonomik. Kjo situatë, ku mungonin krejtësisht referencat, kërkonte një metodologji planifikimi realiste me objektiv *gjenerimin e shpresës dhe energjive të nevojshme për autoritetet dhe komunitetet vendore*, të cilat mund të krijonin gradualisht shanse për frenimin e rënies së mëtejshme, dhe ringjalljen graduale ekonomiko-sociale. Kjo ishte një filozofi planifikimi pothuajse e kundërt me situatat në zonat me presion urbanizimi-migrimi si rajoni i kryeqytetit apo bregdetit ku problem kryesor mbetej menaxhimi i energjive të tepërta.

Në rastin e Bashkisë Krujë, potenciali historik e turistik dhe aktivitetet tradicionale rreth tyre u konsideruan si instrumenti thelbësor dhe pikënisja për gjenerimin e shpresës dhe procesit të planifikimit e zhvillimit. Pas analizave dhe ritestimeve, rezultoi që çështja e strehimit në të vërtetë ishte një keqkuptim që nuk duhet të figuronte si prioritet strategjik i autoriteteve dhe komunitetit, pasi kërkesa në treg ishte artificiale dhe pasojë e një koncepti jorealist për "të pastrehët" dhe duhej riformatuar në tërësi, në përputhje me kushtet e reja ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Për më tepër, kjo kërkesë bazohej në konceptin se shteti do të bënte gjithçka, në një kohë kur as mundësitë e tregut dhe as të financave lokale publike nuk e mbështesnin dot këtë zhvillim. Kjo do të thoshte se nevojat lokale për strehim duhet të kategorizoheshin më mirë në bashkëpunim me Entin Kombëtar të Banesave dhe iniciativat lokale të sektorit privat. Procesi i pjesëmarrjes këtu u pasurua me disa debate publike të mediatizuara. Sidoqoftë, problemi më i madh në këtë eksperiencë mbeti kapaciteti i kufizuar lokal, sidomos lidhur me zbatimin e planit rregullues të qytetit i cili u miratua në vitin 2001 nga KRRTRSH, plan i cili në ditët e sotme duket se është shkelur në parimet e tij kryesore, nëse i referohemi situatës reale në Krujë. Kjo tregon edhe një herë se asistenca teknike për hartimin e planeve rregulluese nuk mund të ketë impaktin e duhur nëse nuk shoqërohet me investime të konsiderueshme për "modernizimin e njohurive" të burimeve njerëzore që punojnë në pushtetin vendor.

Pjesëmarrje në procesin e planifikimit? ...Si dhe sa?
Co-PLAN teston idetë e planifikimit me pjesëmarrje në situata edhe më të vështira ekonomike dhe burimesh zhvillimi. I tillë ka qenë rasti i *Planit rregullues në Bashkinë Peshkopi* (në kuadër të "*Projektit Compass: Komuniteti dhe Administrata Publike së Bashku*", mbështetur nga Qeveria Holandeze dhe zbatuar në bashkëpunim midis VNG, SNV dhe Novib).

Përvoja e Peshkopisë dëshmon se procesi i zhvillimit urban nuk është një proces rutinë, prandaj aktorët në këtë proces duhet të jenë të qartë mbi çka duhet të bëjnë dhe çfarë duhet të presin nga vetë procesi. Shtylla kryesore e procesit planifikues mbetej pjesëmarrja, por çështja ishte deri ku mund të shkohet me pjesëmarrjen?

Në këtë rast u tentua të kalohej nga logjika "*vetëm produkti ka rëndësi*" në logjikën "*produkti është i rëndësishëm, por procesi bën diferencën*".

Kjo e fundit varion nga koncepti i "*informimit*" tek "*vendimmarrjet e përbashkëta*". Në këtë kuptim, duhej bërë kujdes që plani të mos trajtohej si një vendimmarrje thjesht teknike... Kështu, niveli teknik u fokusua në përpunimin e ideve dhe propozimeve, të cilat vinin edhe si rezultat i proceseve pjesëmarrëse, si dhe në detajimet teknike; ndërkohë që niveli politik u përqendrua tek vendimmarrja në përputhje me bindjet politike dhe këshillat e nivelit teknik, duke marrë përsipër edhe përgjegjësinë dhe riskun për zgjedhjet e bëra.

Struktura e projektit u mbështet nga *Grupi i Pjesëmarrjes Qytetare* përgjegjës për sigurimin e informacionit dhe komentimin e ideve. Ky grup ishte "ura" mes strukturës së projektit dhe banorëve duke mundësuar pasqyrimin e dëshirave të komunitetit në planin urban. Ky proces respektonte afatet e aktiviteteve të planifikuara sipas një plani veprimi të paracaktuar me konsensus.

Përvoja dëshmoi se nuk mund të ketë, sidoqoftë, ndarje të qarta të afateve të fillimit të aktiviteteve, veçanërisht kur flitet për integrimin e pjesëmarrjes në procesin e planifikimit. Në rastin e planit rregullues urban në Peshkopi u arrit një integrim i mirë i Pushtetit Vendor me strukturat e Shoqërisë Civile, me moton: *Mos prediko, por bëje realitet!*

Një tjetër mësim ishte se procesi i hartimit të planit u shoqërua paralelisht me ngritjen e sistemit për menaxhimin e informacionit gjeografik dhe të bazës së të dhënave, për të garantuar vazhdimësinë e gjithë procesit. Pra, informacioni dhe garantimi i një baze të qëndrueshme për grumbullimin dhe përditësimin e tij si dhe pjesëmarrja e të interesuarve në planifikim janë dy aspekte shumë të rëndësishme të një procesi bashkëkohor të planifikimit.

Plani Strategjik Urban Kamez, vlerat e tokes
Burimi: Co-Plan

Kujdesi në proceset parapërgatitore të planifikimit... Vizionime

Ndërhyrje të pjesshme me filozofi të ngjashme planifikimi realist janë synuar edhe në *Bashkitë Lushnjë, Berat dhe Durrës*. Në Lushnjë dhe Berat u punua për proceset e hartimit të *Detyrës së Projektimit* si faza e parë drejt hartimit të planeve rregullues dhe pjesë e detyrimit ligjor paraplanifikues. Eksperienca ka treguar se këto detyra projektimi nënvleftësohen dhe reduktohen në materiale formale të shkruara me nxitim dhe, në rastin më të mirë, janë një katalog të dhënash. Co-PLAN ka asistuar në këto bashki dhe ka treguar se hartimi i plotë i këtyre dokumenteve është guri i themelit për të pasur një proces të suksesshëm vizionimi profesional dhe politik me konsensus publik, mbi bazën e të cilit mund të kryhet edhe një proces i suksesshëm planifikimi me pjesëmarrje.

Teksa në Lushnjë ndryshimet politike për shkak të zgjedhjeve lokale e frenuan këtë iniciativë, në Berat qëndrueshmëria e administratës vendore garantoi rezultate pozitive. Bashkia e këtij qyteti kërkoi asistencën e Co-PLAN për të iniciuar, përmes detyrës së projektimit, procesin e planifikimit rregullues, në mënyrë që jo vetëm të siguronte zhvillimin e qytetit sipas nevojave të komuniteteve, por sidomos të garantonte mbrojtjen e vlerave të pasura historike në arkitekturë dhe urbanistikë si trashëgimi lokale e UNESCO-s. Kështu, në Berat, procesi i përshkruar më sipër filloi përmes ngritjes së një grupi pune nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë, me pjesëmarrjen aktive të Zyrës lokale të Urbanistikës si dhe të një grupi ndërsektorial për mbledhjen e të dhënave bazë dhe koordinimin e politikave. E rëndësishme është të kuptohet që në këtë proces mbledhja e të dhënave nuk është një qëllim në vetvete dhe që zgjat pafundësisht, por shërben si bazë për tërheqjen në pjesëmarrje të institucioneve të ndryshme si edhe për ngritjen e procesit të vizionimit dhe krijimin e një ideje konsensuale lidhur me të ardhmen e qytetit. Iniciativa të tjera me rëndësi për këto procese kanë qenë vrojtimi vizual në terren përmes aktivizimit të studentëve të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe ngritja e bazës së të dhënave për hartografinë sipas sistemit GIS (sistem gjeografik i informacionit).

Detyra e Projektimit tashmë është miratuar dhe, falë këtyre ushtrimeve me pjesëmarrje, Bashkitë Berat, Kamëz dhe Lushnjë janë përzgjedhur nga Ministria e Punëve Publike dhe Banka Botërore që të asistohen për finalizimin e planeve rregulluese urbanistike përmes projektit *LAMP Land Administration and Management Program* ("*Programi i Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës*", vijimi i projektit "Menaxhimi i Tokës Urbane" ULMP) të Qeverisë Shqiptare, mbështetur nga Banka Botërore; projekt i cili reflekton eksperiencën e Co-PLAN në këto Bashki dhe bashki të tjera të vendit.

...ritestim i eksperiencës në një shkallë të re...

Co-PLAN aplikon iniciativën planifikuese në nivel komunitar në zonën informale të Kënetës në Bashkinë Durrës, në një sipërfaqe totale prej rreth 350 hektarësh dhe me më shumë se 30,000 banorë. Projekti mbështetet nga *ADA, Zyra Teknike për Kooperim* e Qeverisë Austriake. Ky projekt u fokusua në një zonë prej 50 hektarësh duke synuar planifikimin dhe strukturimin e zonës për të mbështetur procesin e formalizimit dhe integrimit, duke replikuar dhe përmirësuar më tej përvojën e akumuluar në Kamëz. Edhe pse ishte i ngjashëm me atë të Kamzës, projekti u zhvillua në kushte të tjera lokale dhe sidomos të zhvillimeve të reja ligjore në Shqipëri për sa i takon statusit të zonave informale.

Co-PLAN mundësoi edhe këtu procesin e planifikimit dhe përmirësimit të infrastrukturës bazë me pjesëmarrje. Kjo nisi me procesin e hartimit dhe miratimit të Detyrës së Projektimit që përfshiu një sërë analizash social-ekonomike dhe hartografike. Tre ishin prioritetet planifikuese që duhet të aplikoheshin: i) dizajnimi i planit të detajuar urban përmes angazhimit të komunitetit; ii) investimi në kapacitetet e cenueshme sociale të komunitetit si dhe në kapacitetet planifikuese të autoriteteve vendore; iii) sigurimi i asistencës teknike dhe bazës së të dhënave për fillimin e procesit të legalizimit. Si rezultat i kësaj pune, niveli i vetëdeklarimeve në zonë arriti në masën 75%, nga 50% që ishte mesatarja kombëtare. Aktualisht kjo zonë është në proces formalizimi dhe në të po realizohen investime serioze publike në infrastrukturë.

Refleksion...

Në përfundim, proceset e nisura nga Co-PLAN janë finalizuar. Si Plani Rregullues i Peshkopisë, ashtu edhe Plani Strategjik në Kamëz apo ai rregullues në Krujë etj. janë miratuar dhe tashmë janë në sfidën e zbatimeve konkrete; ndërsa, në disa nga qytetet e tjera proceset planifikuese janë gati për t'u filluar ose në proces... e në disa të tjera e kanë kuptuar që duhet t'i fillojnë.

Sfida është çfarë do të ndodhë më pas? Suksesi mund të provohet në planin afatgjatë dhe koha do të tregojë efektivitetin e tyre apo nevojën për rikorrektime të metodologjive të përdorura apo për të kaluar në nivele të reja të planifikimit që u përgjigjen zhvillimeve të reja sociale dhe ekonomike të Shqipërisë.

...si të gjejmë balancën e duhur midis metodologjive të planifikimit racional, inkremental apo me pjesëmarrje... Të gjitha nga pak, sipas situatës...


E rëndësishme është të kuptojmë se, për të arritur një cilësi të re, na duhet të rizbulojmë potencialet e "fjetura"; se planifikimi urban dhe arkitektura nuk janë gjithmonë një "happy ending", por duhet të lejojnë jetën dhe historitë të vazhdojnë...







Zona Pilot Kënetë
Riaplikimi i metodologjisë Co-Plan në Kënetë, Durrës
Mbështetur nga ADA, Zyra teknike për Bashkëpunim,Austri



2

Programi EGUG: Drejt Qeverisjes së Mirë Urbane! (Making Cities Work!)

Njerëzit shpesh mendojnë se bota përbëhet nga gjëra të shkëputura dhe pa lidhje midis tyre... Që në moshë të vogël na kanë mësuar që problemet e vështira t'i ndajmë dhe t'i zgjidhim pjesë-pjesë.... E kështu ne "fragmentojmë botën". Sigurisht që kjo mënyrë i bën më të menaxhueshme detyrat komplekse por, "pa dijeninë" tonë, ne paguajmë një kosto shumë të lartë: humbasim ndjesinë mbi lidhjet që ekzistojnë në raport me të tërën. Dhe, kur provojmë të shohim "pamjen" e përgjithshme, tentojmë të rimbledhim fragmente me mendjen tonë dhe të organizojmë gjithë pjesëzat... Por, sikurse thotë fizikani Bohm, ky veprim është i kotë, pasi është njësoj sikur të provonim të bashkonim pjesëzat e thyera të një pasqyre dhe më pas të provonim të shikonim pamjen e plotë mbi to... Pas pak kohe do të dorëzoheshim, pasi kjo nuk është e mundur...

Peter Senge

The fifth disipline, the art and practice of the learning organization, 1994



Retrospektivë "4" – 2003-2006

...nga planifikimi në nivel komunitar dhe qyteti në qeverisjen urbane

Ndërsa Co-PLAN nisi punën me komunitetet në fillim të viteve '90, shoqëria kishte hyrë në një proces ndryshimi radikal. Organizata ishte e re në moshë e praktikë sikurse edhe vetë institucionet publike të demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Këto të fundit nuk dinin si të "silleshin" në kushtet e lëvizjes së lirë të populsisë, të urbanizimit të shpejtë dhe të pronës private. Planifikimi dhe qeverisja urbane ende kuptoheshin vetëm si një plan në letër, i palidhur me realitetin. Kjo përbënte sfidën për të qenë një hap para asaj që ndodhte... për të ndikuar zhvillimet pozitive në fushën e planifikimit urban në vend dhe zhvillimin në përgjithësi.

EGUG është emri i shkurtër i projektit (me shkronjat e para të titullit në gjuhën angleze Enabling Good Urban Governance) - mbështetur nga Qeveria Holandeze përmes Ambasadës së saj në Tiranë (2003-2008). EGUG si fjalë në vetvete nuk thotë shumë; madje, në atë kohë, titulli shkaktoi diskutim edhe midis vetë stafit të Co-PLAN, nëse duhej ndryshuar ose përmirësuar si akronim. Por, më shumë sesa titulli në vetvete rëndësi kishte koncepti. Ndoshta vetë karakteri paksa "i pazakontë" i këtij emërtimi e bënte publikun edhe më kureshtar për të kuptuar se ç'ishte ky "belbëzim"... dhe atëherë, ky emërtim intrigues kthehej në një mbështetje për projektin.

EGUG në të vërtetë ishte një vijim normal i asaj që Co-PLAN kishte bërë dhe realizuar që nga origjina e vet deri në fillim të viteve 2000... udhëtim sa i vështirë aq edhe "energjidhënës" që kish nisur nga zonat dhe komunitetet "problematike" të Tiranës dhe po arrinte drejt qyteteve e qendrave të qyteteve kryesore të vendit, duke synuar gjithmonë e më shumë të rriste vetëdijen e komuniteteve dhe autoriteteve vendore. Kështu, programi integral eksperiencat e mëparshme të cilat kishin krijuar disa blloqe njohurish "kapacitetndërtuese", duke filluar nga projektet e vogla komunitare Laprakë-Tiranë, 1995-2000; programi i planifikimit dhe zhvillimit ekonomik-urban në Bashkinë Kamëz (1997-2003) e deri tek programet e integruar për ngritjen e kapaciteteve vendore COMPASS (1998-2003).

Kjo fazë e re do të kërkonte ngritjen e këtyre eksperiencave në një nivel më të "sofistikuar", duke shënuar një "moshë" të re të rritjes së Co-PLAN, – nga niveli komunitar drejt nivelit të qeverisjes urbane – si dhe aplikimin e një paradigme të re të planifikimit urban, nevojat dhe eksperiencat e para të të cilit tashmë ishin qartësisht të ravijëzuara. Kjo kërkonte aktivizimin e instrumenteve të planifikimit shumaktorësh ku, veç komuniteteve dhe grupeve të interesit, bëheshin gjithmonë e më të rëndësishme autoritetet vendore dhe ato qendrore.

Faza e parë e projektit EGUG u fokusua në 15 bashkitë më të mëdha të vendit, ku problematikat e planifikimit dhe menaxhimit urban ishin më urgjente. Ai u konceptua fillimisht si një program kombëtar trevjeçar për ngritjen e kapaciteteve lokale në fushën e planifikimit dhe menaxhimit urban, duke shërbyer njëkohësisht si një 'termometër' që do të maste nevojat për të përmirësuar aftësitë bazë në këtë fushë.

Për të kuptuar më mirë problematikën specifike për çdo Bashki, u ndërmor një vlerësim paraprak për identifikimin e problemeve reale dhe nevojave të pjesëmarrësve për trajnim si dhe të tematikave, përfshi planifikimin e veprimit/strategjik, financat bashkiake,

shërbimet publike, zhvillimin ekonomik lokal, menaxhimin e mjedisit etj. Ndryshe nga deri atëherë, kjo fazë e parë mundësoi përfshirjen në trajnime të ekipeve të integruara të ekspertëve nga drejtoritë e planifikimit urban, të politikave të zhvillimit, të financave lokale, të infrastrukturës, shërbimeve publike e sociale dhe mjedisit, ekspertë të cilët nuk ishin përfshirë ndonjëherë në proceset e planifikimit. Në përfundim, të gjitha ekipet bashkiake patën nga një plan veprimi konkret të cilin ata e përcollën në bashkitë e tyre.

Kjo fazë paraprake e projektit ishte një mënyrë testimi dhe reflektimi jo vetëm për Co-PLAN, por edhe për partnerët lokalë si SHBSH Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe MPVD Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit; për partnerin ndërkombëtar në zbatim IHS, Instituti për Studimet e Strehimit dhe Zhvillimin Urban në Roterdam Holandë, ku kontribut të veçantë dha eksperti brazilian Andre Herzog, si dhe për njësinë e projekteve të zhvillimit të Ambasadës Holandeze në Tiranë. Më e rëndësishmja është që ekipet e bashkive pjesëmarrëse kuptuan rëndësinë e planifikimit strategjik.

Konkluzionet e Nxjerra për Planifikimin

Sidoqoftë kjo etapë e projektit evidentonte disa konkluzione të qarta:

i)- Edhe pse nevojat ishin të dukshme dhe në rritje, nuk mund të thuhej se ishte koha për një program masiv kombëtar për ngritjen e kapaciteteve në këtë sektor. Kjo sepse në terren problematikat ishin tepër komplekse e të larmishme dhe prioritete të tjera akoma më urgjente bëheshin edhe më të rëndësishme sesa vetë planifikimi urban. Kjo impononte logjikën e zhvendosjes së investimit për kapacitetet në një fazë të mëvonshme të Programit, duke e nisur procesin e ndryshimit përmes disa projekteve të karakterit "pilot", të cilat së bashku mund të krijonin modele të prekshme dhe një masë kritike drejt qeverisjes së mirë urbane në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

ii)- Trajnimi në formën klasike/teorike konsiderohej i vjetruar dhe jo mjaft i suksesshëm në praktikë. Kështu, me gjithë mikpritjen dhe respektin maksimal të drejtuesve lokalë, jo rrallë evidentohej një lloj hezitimi i tyre për të shkëputur nga puna e përditshme persona kyç të administratës, të cilët do të duhej sipas tyre të "sakrifikoheshin" në trajnim, pasi ky i fundit konsiderohej si humbje kohe. Kjo impononte logjikën e trajnimit në punë dhe si proces në përgatitjen e planeve dhe strategjive të zhvillimit dhe, mbi të gjitha, në zbatimin e tyre. Megjithatë, metodologjia e trajnimeve "klasike" shërbeu për sensibilizimin fillestar në nivel lokal në lidhje me evidentimin e prioriteteve që mund të ndihmonin reformimin e planifikimit dhe administrimit të territorit në tërësi.

iii)- Të trajnuarit u trajtuan me filozofinë ToT (Trajnimi i Trajnuesve) gjë që nënkuptonte vijimin e këtij procesi në qendrat e tyre të punës. Por kjo në fakt, në shumicën e rasteve, varej jo vetëm nga iniciativa, vendosmëria dhe serioziteti i të trajnuarve, por sidomos nga mentaliteti dhe fryma e drejtuesve dhe e mjedisit lokal si dhe nga aftësia e tyre për të qenë të hapur ndaj ideve të reja. Dhe për këtë ata duheshin mbështetur dhe asistuar në kontekstin e tyre të përditshëm ku realiteti shpesh është mjaft agresiv.

Kjo filozofi i bëri aktorët kryesorë të Programit të ishin më kritikë ndaj vetes në konceptimin e një ndërhyrjeje në fazën e dytë (EGUG-2). Veçanërisht Ambasada Holandeze vërente se faza e dytë e programit duhet të ishte sa më realiste dhe të ndërtonte mbi gjetjet e fazës së parë. Kjo nënkuptonte që, para së gjithash, përmes inkurajimit të elementeve të qeverisjes së mirë, të garantohej zhvillimi i instrumenteve që çojnë drejt një mjedisi më cilësor për shoqërinë. Kërkohej gjithashtu që, në vend të predikimit teorik, zbatuesit të tregonin aftësinë për të impaktuar, ndërsa përfituesit aftësinë për të qenë të hapur ndaj mentaliteteve të reja në punë si edhe ndaj fillimit të zbatimit të projekteve dhe investimeve. Kjo çoi në hartimin e Programit EGUG-2...

EGUG II – Laboratori i Instrumenteve

A do të lëmë gjurmë???

Kur mund të flasim për qytet? Teoricieni i arkitekturës dhe urbanistikës Aymonino[1], ndër të tjera, jep edhe këto argumente: akumulimin dhe bashkimin në një vend të caktuar të energjive e kapitaleve të tepërta që sjellin hopin cilësor të kalimit nga situata ku garantohet vetëm plotësim nevojash, në një situatë të ofrimit të më shumë mundësive. Tejkalimi i plotësimit të nevojave solli lënien e gjurmëve. Qyteti është pra një vend ku lihen gjurmët e një epoke të caktuar duke tentuar tejkalimin e asaj që është vetëm nevoja lidhur me ndërtesat – përmes krijimit të objekteve më "të durueshme": monumente në gur, mermer, metal, çimento.

1 C.Aymonino, Il significato della Citta, Marsiglio Editori, 2000

Qyteti do të ketë lagjen e re të banimit... Kodrat e Radostinës janë shumë të përshtatshme... Asaj ia kanë vënë syrin shumë qytetarë të Fierit... Kemi shumë kërkesa për vila... Edhe pishina do të kenë... Paratë ua kanë sjellë djemtë që i kanë në emigracion... Rrugët i duam që të kenë trotuare të gjera dhe pemë e palma anash se verën e kemi të nxehtë... Do ta kthejmë në qytet bregdetar...

Rruga e re duhet ta "përqafojë" qytetin dhe jo ta ndajë atë në mes... por edhe shumë të mos i largohet sepse ndryshe njerëzit do të na harrojnë... Kështu qyteti do t'u shfaqet udhëtarëve me "fytyrën" e tij të re... qendra tregtare, zona stacionesh transporti... sera... Nuk mund të kalojë andej rruga e re sepse kemi zonën arkeologjike... E-city do ta bëjmë...

Dikur nënat tona lanin rrobat në Lumin e Gjanicës... Do ta kthejmë në një lumë të pastër siç ka qenë... me lulishte anash, pista vrapimi e biçikletash... Nuk kishte ndonjë gjë më shumë Athina... rrugët edhe ne i kemi të drejta e me sistem të rregullt... Kjo zonë do të jetë me ndërtesa të një lartësie deri në 12 kate...

Duhet të parashikojmë edhe kampusin universitar... Por, qendra tregtare do të jetë më e madhja në Ballkan... Qendra do të jetë këmbësore dhe trafiku do të rregullohet me unazat e vogla... Teatri do të vishet me mermer, ndërsa bashkia do të bëhet nga e para... Xhamia, pas asaj të Shkodrës, është më e madhja... Që nga autostrada do të duket silueta e qytetit... Edhe kopsht zoologjik do të ketë...



Qyteti do të ketë lagjen e re të banimit... Kodrat e Radostës janë shumë të përshtatshme... Asaj ia kanë vënë syrin shumë qytetarë të Fierit... Kemi shumë kërkesa për vila... Edhe pishina do të kenë... Paratë ua kanë gjellë djemtë që i kanë në emigracion... Rrugët i duam të kenë trotuare të gjera dhe pemë e palma anash se verën e kemi të nxehtë... Do ta kthejmë në qytet bregdetar... Rruga e re duhet ta "përqafojë" qytetin dhe jo ta ndajë atë në mes... por edhe shumë të mos i argohet sepse ndryshe njerëzit do të na harrojnë... Kështu qyteti do t'u shfaqet udhëtarëve me "fytyrën" e tij të re... qendra regtare, zona stacionesh transporti... sera... Nuk mund të alojë andej rruga e re sepse kemi zonën arkeologjike... E-city do ta bëjmë... Dikur nënat tona lanin rrobat në Lumin e Gjanicës... Do ta kthejmë në një lumë të pastër siç ka qenë... me ulishte anash, pista vrapimi e biçikletash... Nuk kishte ndonjë gjë më shumë Athina... rrugët edhe ne i kemi të drejta e me sistem të rregullt... Kjo zonë do të jetë me ndërtesa të një lartësie deri në 12 kate...

Duhet të parashikojmë edhe kampusin universitar... Por, qendra tregtare do të jetë më e madhja në Ballkan... Qendra do të jetë këmbësore dhe trafiku do të rregullohet me unazat e vogla... Teatri do të vishet me mermer, ndërsa bashkia do të bëhet nga e para... Xhamia, pas asaj të Shkodrës, është më e madhja... Që nga autostrada do të duket silueta e qytetit... Edhe kopsht zoologjik do të ketë...

Retrospektivë "5" – 2004-2006

Identifikimi dhe seleksionimi i dy bashkive përfituese të projektit EGUG u bë përmes një procesi transparent aplikimi dhe konkurrimi. Çdo bashkie i duhej të angazhohej seriozisht që të paraqiste një propozim konkret lidhur me fushat në të cilat kërkonte mbështetjen e programit EGUG-2 duke shpjeguar si lidhej kërkesa për mbështetje me problemet lokale, me iniciativat e mëparshme dhe aktuale, mbi të gjitha, me prioritetet e lidershipit të sapodalë nga zgjedhjet lokale 2003. Vlerësimi i fituesve nga një ekip me aktorë miks dhe të pavarur si dhe verifikimi i aplikimeve me vizita në terren, garantuan që në fillim të procesit pronësi dhe përgjegjësi të qartë vendore. Në konkursin kombëtar për t'u përfshirë në projekt morën pjesë 15 bashki... Në përfundim u shpallën fituese Bashkitë e Fierit dhe Elbasanit. Projekti fillon...

Përtej të deritanishmes... Dilemat e parafillimit

Një gjë ishte e qartë që në fillim: ndryshimi do të vinte jo aq nga produkti në vetvete sesa nga procesi përmes të cilit do të hartohej çdo produkt. Procesi duhet të ndikonte jo vetëm cilësinë e produktit, por edhe vetë mendësinë e njerëzve të përfshirë në të... Faza e dytë e EGUG përkonte me një periudhë në të cilën institucionet shqiptare ishin "të lodhura" me projektet pa fund të donatorëve, sidomos ato me karakter të tejngopur trajnues të cilat dukej sikur i trajtonin përfituesit si subjekte me "inteligjencë të ulët", duke minimizuar kështu interesin dhe impaktin e tyre. Nga pikëpamja metodologjike do të ecej në hapat e procesit të planifikimit strategjik... Deri në atë kohë, në Shqipëri ishin hartuar disa plane strategjike në nivel lokal dhe nivel qarku. Por, çfarë të reje do të mund të sillte EGUG-2? Cila do të ishte vlera e shtuar e tij? Si do të bëhej ky proces pjesë e interesit dhe menaxhimit të gjithë bashkisë?

Kjo vendosi sfidën: çfarë duhet të bëjmë që të fitojmë interesin dhe përfshirjen reale të përfituesve? Nga studimi analitik i eksperiencave të mëparshme dhe i rasteve të ngjashme në Shqipëri dhe jashtë saj, u rikujtuan disa "mësime" shumë të thjeshta por të rëndësishme që praktikat rutinë shpesh i nënvleftësojnë:

Interesi është i ulët kur projektet imponojnë ato çka janë prioritetet e tyre, por jo të përfituesve.

Përfituesit duhen përzgjedhur mbi bazën e shprehjes së interesit dhe nivelit të iniciativës për të organizuar procese.

Përfshirja e përfituesve të projektit në hartimin e objektivave të tij i bën ata të interesuar për të qenë realisht pjesë e proceseve. Përfituesit duhet të ndihen gjatë gjithë kohës të rëndësishëm në organizimin e proceseve dhe të punojnë së bashku me ekipin konsulent të projektit.

Lidershipi vendor duhet të jetë pjesë e proceseve... dhe që të ngjallet ky interes, drejtuesit vendore duhet ta shikojnë projektin si pjesë e programeve dhe premtimeve të tyre ndaj komunitetit.

"Përjetimi" i përbashkët i problemeve: kjo do të thotë se ekipi mbështetës i projektit nuk mjafton të ketë vetëm ekspertizën teknike, por duhet të shpenzojë kohën e nevojshme në bashki për të kuptuar nevojat lokale. Për ta arritur këtë, ekipi duhet të funksionontë brenda kornizës së administratës dhe kërkesave të saj, të "shkrihej" me qytetin, jo thjesht në aspektin profesional por edhe në atë social. Koha krijonte ngut për të realizuar njohje të thellë të qytetit në të gjitha aspektet e tij.

Vërtetësia e proceseve: kjo ndodh nëse qytetarët ndiejnë se po kontribuojnë në diçka konkrete për të cilën do të ndihen krenarë... dhe njëkohësisht ndiejnë se mund të përfitojnë nga pjesëmarrja në këtë proces. Në Shqipërinë e pasviteve '90 ka qenë mjaft e vështirë të rikthejë përsëri njerëzit në procese komunitare vullnetare dhe jo të sforcuara...

Kreativiteti: ky duhej parë në këndvështrimin e plotësimit të standardeve që shkonin përtej praktikave rutinë dhe "atrofizuese" të deriatëhershme. Elementet novatorë duhet të ishin të shkrirë në praktikat e përditshme të punës së bashkisë dhe të mos shkaktonin tension tek lidershipi i bashkisë dhe tek stafi, të cilët kërkonin t'i rezistonin ndryshimeve.

Planifikimi alternativ – "Jashtë" vizatimit

Konkluzionet e nxjerra për planifikimin

Qëllimi i përgjithshëm i Programit EGUG-2 (2004-2006) ishte krijimi i modeleve të qeverisjes së suksesshme urbane përmes tre komponentëve: i). Formulimi i strategjive të zhvillimit për qytetet Elbasan dhe Fier; ii). Zbatimi i projekteve konkrete të përmirësimit urban në terren; iii). Shpërndarja e përvojës në qytete të tjera të vendit. Ky projekt u konceptua si një proces gjithëpërfshirës i aktorëve të interesuar për reformimin e proceseve të planifikimit dhe menaxhimit urban dhe asistimin e autoriteteve vendore për një administrim më të mirë të qyteteve. Bashkëpunimi i Co-PLAN dhe IHS-Roterdam me SHBSH (Shoqata e Bashkive të Shqipërisë) dhe Ministrinë e linjës për Qeverisjen Vendore garantoi edhe më shumë një koncept projekti realist dhe të zbatueshëm.

Co-PLAN instaloi ekipe të posaçme ekspertësh pranë bashkive. Së bashku me administratat bashkiake, këto ekipe formuan Task-Forca të posaçme dhe tematike për hartimin e strategjive të zhvillimit dhe të elementeve të tyre përbërëse. Proceset pjesëmarrëse të EGUG-2 kanë qenë të gjata dhe komplekse, por të zhburokratizuara.

Procesi i planifikimit strategjik ishte ombrella për të gjithë kornizën e projektit dhe mbi të gjitha synonte të fuste stafet lokale në një mendësi të re planifikuese, gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale. Këto procese kulmuan me organizimin e Forumeve Qytetare ku qytetarët dhe aktorët pjesëmarrës debatuan e votuan mbi vizionet tekniko-politike të autoriteteve dhe mbi prioritetet e zgjedhura që mbulonin katër fusha tematike: i) zonat e zhvillimit urban; ii) zhvillimi ekonomik lokal; iii) mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm; iv) arsimi dhe kultura.

Instrument tjetër i procesit ishte hapja e Ekspozitave Publike për të promovuar strategjitë dhe planet e zhvillimit përmes materialeve të larmishme grafike-vizuale, përfshi konkurset vizatimore për fëmijët dhe të rinjtë me temën "Qyteti im, Shtëpia ime." Në mënyrë paralele, ekipet e të dy bashkive Fier dhe Elbasan punuan për të hartuar Strategjitë e Zhvillimit të Qytetit dhe Detyrat e Projektimit të Planeve Rregulluese Urbane. Procesi i pjesëmarrjes dhe ai analitik që u nevojiten këtyre instrumenteve – i pari më vizionar dhe i dyti më teknik – kërkojnë rigorozitet, konsensus, qëndrueshmëri dhe realizëm. Të dy këto instrumente garantojnë gurin e themelit për një plan të mirë urban për qytetin.

Festat e qytetit

Co-PLAN beson se qytetet ndërtohen nga energjia e njerëzve. Për këtë, filozofia e procesit duhej të ishte frymëzuese si për qytetarët, ashtu edhe për bashkinë. Ky është një "moment" që shpesh neglizhohet në procesin e planifikimit, por ka një rëndësi parësore për mbarëvajtjen e procesit dhe sidomos për cilësinë e tij. Çdo njeri "ka për të treguar diçka" në lidhje me qytetin e tij... mjafton që ne ta bëjmë të "ndihet i konsideruar". Kështu profesionistët do t`i ndihmonin banorët që energjinë e tyre ta hidhnin pozitivisht mbi qytetin. Në qytetet shqiptare energjia jo vetëm nuk mungon, por ekziston e bollshme dhe në pritje të një mendimi profesional për ta orientuar drejt. Ky do të ishte vizioni i qytetit i hartuar në mënyrë pjesëmarrëse... i përmbledhur në motot "E dua qytetin tim" për Elbasanin dhe "Qyteti im, shtëpia ime" për Fierin...

Mbi këtë besim u ndërtua filozofia e EGUG-2: filozofia e zbulimit të instinktit njerëzor në procesin e formësimit të vendit; filozofia që ringjall dashurinë për qytetin; filozofia që mbrun procese humanizuese; filozofia e planifikimit për performancë.

Përgatitja e Strategjisë së Zhvillimit të qytetit kërkonte një vlerësim të kujdesshëm të situatës ekzistuese, hartimin e një vizioni gjithëpërfshirës, renditjen e objektivave realiste dhe projekteve konkrete që do të bëheshin pjesë e buxhetit të bashkisë apo projekt-propozimeve... Materiali ishte shkruar në një gjuhë sa profesionale aq edhe me nota frymëzuese, pasi ishte shumë e rëndësishme edhe se si do të përcillej mesazhi i tij.

Janë ata të strategjisë

Pothuajse çdo ditë kishte një lajm në TV lokale për procesin e strategjisë... Postera dhe fletushka ishin shpërndarë në qytet... spotet e strategjisë ishin tashmë të njohura për banorët... Kështu, strategjia kishte "fytyrën" e vet... një "vajzë e vogël" në Elbasan dhe një "djalë i vogël" në Fier... të dy vështrojnë qytetin nga lart dhe thurin ëndrra për qytetin "më të bukur në botë"...

"E dua Qytetin Tim: Të njohësh qytetin do të thotë të ecësh në rrugëtimin e tij përmes kohërave, të prekësh trajtën e tij përmes shtresave historike urbane, të përfshihesh në atmosferën e tij përmes njohjes së shpirtrave njerëzorë që e ndërtojnë atë përditë, të jesh pjesë e gjallërisë së tij ekonomike përmes ndikimit mbi vlerat dhe burimet materiale e natyrore, të hysh në zemrën e tij dhe të zbulosh thelbin e ekzistencës dhe të transformimit të qytetit. Njohja e qytetit është një proces i vazhdueshëm. Në fakt, nuk mbaron kurrë. E rëndësishme është që ky proces njohjeje të jetë dinamik dhe ne si qytetarë të jemi proaktivë ndaj qytetit gjatë këtij procesi. Pra, të depërtojmë në thellësinë e fakteve, të ndiejmë gjerësinë e tyre, të zbulojmë shkaqet, të analizojmë arsyet, të kuptojmë pasojat apo t`i parashikojmë ato dhe, më në fund, të kuptojmë se cilat janë tendencat dhe skenarët e mundshëm të zhvillimit".

Plane, jo "plane"... Hartimi i planeve rregulluese ishte momenti i dytë i rëndësishëm gjatë zbatimit të projektit EGUG-2. Thelbi ishte: "Të menaxhosh ëndrrat". Kështu, duke përdorur taktika dhe instrumente kreative, u munduam të mos humbasim dimensionin njerëzor të planeve tona. Për këtë ndryshuam mënyrën e të parit të qytetit... Co-PLAN vinte nga një eksperiencë e përjetimit të realiteteve të vështira urbane ku roli i komunitetit ishte thelbësor dhe mjaft entuziazmues.

Kushtetuta e qytetit – U kalua nga koncepti i planit rregullues si një produkt qëllim në vetvete drejt Planit Rregullues si instrument dhe pjesë e Strategjisë së Zhvillimit dhe qeverisjes urbane.

Qyteti është ëndrra... – Ëndrrat e njerëzve janë një dimension që duket se nuk ka të bëjë shumë me planet dhe që ne planifikuesit rrallë e marrim në konsideratë. Kjo ishte arsyeja pse procesi i planifikimit në Fier dhe Elbasan filloi me procesin e vizionimit... lagje më lagje. Ishte e rëndësishme që njerëzit të kuptonin se "qyteti do të ishte i bukur nëse ata do ta shihnin të bukur"... Nuk ishin të tjerët që do ta bënin atë, por vetë banorët e tij... Gjatë këtyre proceseve, theksi kryesor u vendos tek anët pozitive të qytetit për të kuptuar se cilat ishin pikat mbi të cilat vizioni i ardhshëm mund të ndërtohej. Kështu ëndrrat do të çlironin energjinë e tyre pozitive dhe nuk do të ishin më vetëm ëndrra por një forcë frymëzuese dhe instrument zhvillimi...

Ta shikojmë situatën pozitivisht... - Plani i qytetit duhet të krijonte jo vetëm një produkt në vetvete, por një premisë për ndryshimin e qytetit. Në këtë kuptim, njerëzit janë targeti ynë kryesor pasi janë ata të cilët shpesh ngrenë sisteme "informale paralele" për të shmangur ligjet dhe rregullat. E parë me syrin pozitiv, qyteti nuk është një vend për t'u shfrytëzuar, por shtëpia jonë e përbashkët...

...Është gjallesë - Leximi i kujdesshëm dhe me ndjeshmëri i qytetit ka të bëjë me procesin e kompozimit dhe dekompozimit të tij nga pikëpamja fizike/ territoriale; sociale-historike; tematike; funksionale; tipologjiko-morfologjike etj. dhe na zbulon identitetin dhe thurjen sociale e hapësinore të tij. Kjo rezulton në "anatomizimin" e qytetit në sektorë, mbi bazën e të cilëve është bërë analiza e gjendjes ekzistuese dhe të cilët njëkohësisht "përcjellin" propozimet sasiore dhe cilësore të planit të një rikonfigurimi të tyre në fasha strukturale që janë një lexim i ri i qytetit si edhe elementët "motorë" të ndryshimit. Nuk ka situata, sado të degraduara, që të mos mbartin brenda tyre "çelësin e zgjidhjes" dhe ky çelës gjendet përmes leximit të kujdesshëm dhe analizave të vendit.

Qyteti im Shtëpi

I love MY city

Strategjitë e Zhvillimit të Qytetit

Ndërtim Kapacitetesh

Pjesëmarrje

Sensibilitet Mjedisor

Strategji Ndër-sektoriale:

Planet Rregulluese Urbane

Procesi i Buxhetimit me Pjesmarrje

Profili Ambiental i Qytetit

Procesi Rregullimit. Formalizimit të Tokes

Hartat e Varfërise

Zhvillim Ekonomik Lokal

Sistem Informacioni


Vizionet Komunitare të Zhvillimit të Lagjeve

Strategji e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane dhe Plani Veprimit

Plani Veprimit të Kultures dhe Arsimit

Grumbullimi i të Dhënave, Diagnoza e Situatës
Ndërtimi i "Data-Base"

Koncepti i ndërhyrjes dhe asistences
Burimi Co-Plan



Koncept nga Plani Rregulues Fier
Burimi Co-Plan



Koncept nga Plani Rregullues Elbasan
Burimi Co-Plan

...Nëse shumica jonë sot këtu shtron pyetjen nëse një ditë do të arrijmë të shohim në realitet qytetin që sot po mundohemi të paraqesim... kjo varet nga:
-sa do të jemi të aftë të ndërtojmë partneritete dhe të ngremë kapacitetet
-sa do të jemi të aftë të përdorim planin si platformë ndërveprimi (midis qeverisë, biznesit dhe shoqërisë në tërësi).
-sa do të jemi të aftë të ndërthurim në mënyrë realiste principe dhe filozofi që integrojnë vlerat me nevojat...
-sa do të jemi të aftë të dalim mbi rutinat dhe mënyrat e zakonshme me të cilat veprohet për të ndërtuar një qytet.
-sa do të jemi të aftë të rizbulojmë bukurinë e fshehur të qytetit tonë, karakterin dhe botën shpirtërore të vendit... të shohim atë që nuk duket... të kuptojmë qytetin në kompleksitetin e vet.
-sa do të jemi të aftë të kuptojmë planifikimin si performancë, si pjesëmarrje, si "koncert" gjithëpërfshirës që ndihmon qytetin të frymëzohet dhe zhvillohet.
-sa do të jetë gjithsecili i aftë të kuptojë se qyteti bëhet nga njerëzit... zgjidhja e problemit fillon kur ne bëhemi të ndërgjegjshëm se secili nga ne mund të influencojë si në "shkatërrimin" ashtu edhe në arritjen e qytetit të ëndrrave.

-Jo shumë qytete deri tani e kanë pasur këtë fat... që të diskutojnë për të ardhmen e tyre dhe të ftojnë qytetarët të bashkëpunojnë për atë që mund ta konsiderojmë si "kushtetutën" e qytetit.

Shkëputur nga takimet e vizionimit në Bashkinë Fier, Maj 2005

PLANI si pjesë e "dashurisë së qytetarëve për qytetin"
Plani rregullues i paraqitur në materialin që vijon nuk është gjë tjetër veçse "përkthim" i vizionit, strategjisë dhe objektivave të zhvillimit të qytetit, të hartuara së bashku me qytetarët e Fierit/Elbasanit si rezultat i një procesi të gjerë me pjesëmarrje.

PLANI si kornizë lidhëse midis hapësirës, investimeve dhe institucioneve
Praktika e këtyre viteve na sugjeron korrigjime të metodologjisë së deritanishme të cilat shkojnë përtej natyrës hapësinore të planeve urbanistike. Faktet kanë treguar se degradimi i mëtejshëm urban dhe mjedisor mund të ndalohet vetëm nëse kombinohen masa të natyrës urbanistike, ekonomike dhe ambientale të cilat, të materializuara në ndërhyrje konkrete fizike në territore të caktuara të qytetit, krijojnë situata urbane të qëndrueshme dhe të balancuara.

Fizionomitë e reja urbane të krijuara si rezultat i këtyre ndërhyrjeve, të konceptuara për të pasur një ndikim minimal në mjedis dhe të pozicionuara nga pikëpamja hapësinore në mënyrë të tillë që të konsolidojnë strukturën organike të territorit, do të shërbejnë për të fuqizuar shkallën e shkëmbimeve sociale dhe ekonomike, të cilat përbëjnë materialin jetësor të funksionimit të një territori urban, në rastin konkret të qytetit të Fierit. Procesi i analizave dhe konsultimeve gjatë hartimit të planit ka identifikuar "pikat dhe akset gravitacionale" të qytetit si elemente me rëndësi katalitike për nga influenca transformuese që mund të ushtrojnë në pjesët e tjera të territorit. Sipas kësaj perspektive, ndryshimet janë rezultat i rregullimeve që vijnë nga përfshirja në to e elementeve "jetëdhënës" gjallërues.

PLANI si një instrument menaxhimi
Ky plan tenton të mos jetë thjesht një dokument teknik, por një instrument për të stimuluar dhe influencuar ndryshime pozitive socio-ekonomike. Pjesëmarrja e publikut dhe angazhimi i institucioneve në nivel lokal dhe qendror në procesin e hartimit dhe zbatimit të tij e bëjnë këtë proces një proces në vijueshmëri dhe rrisin shanset e arritjes së vizioneve të planit. Për këtë plani është përkthyer në "kodet e zbatimit" që mbartin veprimet menaxhuese kryesore.

PLANI si instrument që nxit zhvillimin
Ky plan është konceptuar si një instrument që "krijon mundësi" dhe jo vetëm "pengesa", me përjashtim të rasteve kur kjo shërben për të krijuar mundësi të tjera më të mëdha. Një nga detyrat kryesore të çdo plani është nxitja e investimeve nga të gjitha burimet financiare dhe sidomos ato private, për t'i dhënë më shumë frymëmarrje ekonomisë lokale dhe për të krijuar më shumë vende pune dhe biznese të cilat do të hapin një proces rinovues në rritje graduale.

Shkëputur nga tekstet shpjeguese të principeve kryesore të planeve rregullues Fier dhe Elbasan.
Publikuar në proceset pjesmarrëse të planeve, Prill 2006

...**Nga hartimi në zbatim** - Miratimi i planeve rregullues nuk duhet konsideruar si fundi i procesit. Një nga të metat e sistemit të planifikimit ka të bëjë me ndarjen "e prerë" të fazës së hartimit nga ajo e zbatimit. Në fakt, procesi i planifikimit është një i tërë dhe fazat ndjekin në mënyrë të natyrshme njëra-tjetrën.

Kështu, në rastin e EGUG u identifikuan ndërhyrjet prioritare dhe modelet që do të shërbenin si shembuj në zbatimin e planeve. Këto projekte prioritare u përqendruan në ngritjen e sistemeve të informacionit bashkiak, por edhe në produkte më të prekshme për publikun si shtrimi dhe ndriçimi i rrugëve apo hapja dhe gjelbërimi i hapësirave publike etj.

Garantimi i burimeve njerëzore për vazhdimësinë e zbatimit të planit dhe modernizimi i metodave të menaxhimit bashkiak mbeten një sfidë e vazhdueshme e cila duhet të ecë paralel me emancipimin e shoqërisë shqiptare dhe rritjen e nevojës për të bërë "gjëra që nuk i kemi bërë më parë"... Kjo lidhet direkt me stadin në të cilin ndodhet e gjithë administrata shqiptare dhe përpjekjet që ajo duhet të bëjë për të dalë nga "qerthulli i vetvetes"... Kjo është një sfidë për krejt shoqërinë shqiptare. Pikërisht për të përhapur këtë eksperiencë në nivel kombëtar, u mundësua hartimi i Platformave të Njohurive si dhe u organizuan konferenca kombëtare.

1 - Aplikimi i konceptit të qeverisjes urbane me pjesëmarrje, përmes një filozofie që bazohet tek thjeshtësia si e kundërta e "komplikimit të problemeve" deri në moszgjidhje, pa kaluar as në ekstremin tjetër, atë të rrezikut prej banalizimit reduktiv.

2 - Garantimi i pronësisë së përfituesve nga projekti dhe i të gjithë aktorëve lokalë lidhur me projektin, gjë e cila filloi të ndërtohej që në fazën e hartimit të projektit; në seleksionimin e bashkive përfituese përmes proceseve konkurruese; në trajnimet dhe asistencën për ngritjen e kapaciteteve në punë; në inkurajimin e atmosferës optimiste dhe idesë që gjërat që ëndërrohen mund të arrihen, për ta mbyllur me vlerësimet dhe monitorimet e pasprojektit.

3 - Formulimi i planit si instrument menaxhimi dhe jo thjesht si dokument teknik. Kjo do të thotë që plani duhet të përmbante "formulat" e zbatimit të tij. Kësaj i ka ardhur në ndihmë edhe evidentimi dhe aplikimi i instrumenteve dytësore që ndihmojnë zbatimin

e planit strategjik dhe planit rregullues. Disa nga instrumentet dytësore kanë qenë: Eksperienca e Co-PLAN me EGUG-2 dëshmon disa gjetje si instrumente kyç që garantojnë zbatimin e një plani/strategjie zhvillimi urban.

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve lokale në punë, në mënyrë që instrumentet e planifikimit dhe qeverisjes urbane të kuptohen në mënyrë të pavarur nga administrata vendore dhe lidershipi i saj.

Përputhja e interesave ekonomike-politike me interesat e komuniteteve të qytetarëve. Jo rastësisht zbatimi i planeve/strategjive të hartuara gjatë EGUG-2 filloi me miratimin e Strategjive të Zhvillimit dhe të Detyrave të Projektimit e deri tek zbatimi i projekteve-pilot të prioritizuara nga Këshilli Bashkiak, ku këto interesa proporcionohen në procese të legjitimuara politike.

Realizimi i detajimeve pjesore urbane që njihen si Planet e zhvillimit të njësive dhe poleve dominuese të qytetit (Local area development plans). Këto zbërthime nuk u realizuan vetëm sipas modeleve statike-klasike të praktikave shqiptare të "studimeve pjesore të detajuara"; por në vend të detajimit të parakohshëm që ka pak gjasa të zbatohet u paraprinë nga zbërthime të natyrës urbane (sipas modelit të "design-briefs" në Angli apo të "Dizajneve Urbane" në Francë) duke garantuar fleksibilitet dhe përshtatshmëri për zhvilluesit dhe aktorët potencialë lokalë. Çështja këtu është si të bëhet autoriteti lokal aktor dhe protagonist në këtë lloj zhvillimi që

de facto zbaton ose zbërthen në detaj planin/strategjinë e miratuar, duke garantuar balancimin e interesave private me ato publike...

4 - Shtjellimi i projektit në praktikë dhe jo thjesht në "ndihmë teorike" si dhe kombinimi i procesit të planifikimit strategjik e urban me atë të buxhetimit me pjesëmarrje.
Kjo inkurajon hapje të Bashkive ndaj qytetarëve dhe aktorëve të tjerë, gjë e cila i kundërvihet vendimmarrjes së izoluar si edhe presioneve për politizim të proceseve të zhvillimit.

"Anija kozmike" pa/me "Pilot" – vazhdimi i projektit (EGUG-2 shtesë për 2 vjetë të tjera)
Ndodh shpesh në një projekt që ta kemi të vështirë të gjejmë momentin e përfundimit të tij... por ky nuk është rasti i projekteve në shkallë qyteti. Këto projekte vazhdojnë për aq kohë sa vazhdojnë edhe proceset transformuese të qytetit... një projekt i lë vendin tjetrit... e kështu me radhë. Ndodh shpesh në praktikë që shkëputja e asistencës teknike të shënojë edhe "fundin" e projekteve; transmetimi i njohurive kthehet në çështjen kyç që ky "fund" fatkeq të mos ndodhë. Kjo ishte edhe "pikëpyetja" për Co-PLAN: ç'do të ndodhte pas përfundimit të këtij projekti në praktikë? Një periudhë e ndërmjetme u gjykua si e nevojshme për të garantuar një kalim sa më të butë... Në fakt, pas përfundimit të EGUG-2, u vunë re diferenca specifike midis bashkive pjesëmarrëse në projekt.



Fragment nga posterat e qytetit, Kënetë, Durrës
Punimi Co-Plan

Diferenca kryesore ka të bëjë me një "simptomë" të njohur për shoqërinë shqiptare: trajtimi i politizuar i instrumenteve të planifikimit urban. Ndërsa proceset u kryen teknikisht pothuajse njësoj dhe në të njëjtën periudhë, si në qytetin e Fierit ashtu edhe në atë të Elbasanit, rasti i Fierit mund të cilësohet si më i suksesshëm për shkak të vazhdimësisë së lidershipit politik. Pra, vazhdimësia e lidershipit politik në Bashki, që është në favor të efektshmërisë dhe qëndrueshmërisë së investimit të bërë mbi kapacitetet lokale, kthehet në diçka të rëndësisë parësore për kontekstin aktual shqiptar. Aktualisht, Qyteti i Fierit është një nga rastet unike në Shqipëri ku një qytet është i pajisur me Strategji të Përgjithshme të zhvillimit të tij dhe Plan të Përgjithshëm Rregullues të miratuar në të gjitha instancat ligjore, plan të cilin Bashkia është duke e zbatuar për ta transformuar qytetin, në përputhje me vizionet e tij, në një nga polet kryesore të rajonit perëndimor të Shqipërisë. Në këtë rast, proceset e zhvilluara gjatë fazës së planifikimit vijojnë të kenë efekte pozitive si për autoritetet ashtu dhe për komunitetet.

Ndryshimi i lidershipit politik në rastin e qytetit të Elbasanit e shtyu miratimin e planit rregullues "në pafundësi". Edhe pse lidershipi i ndryshuar mund të ketë qenë pjesë e proceseve të zhvilluara në fazat e hartimit të planeve, përsëri duket se përdorimi i planeve rregulluese si mjete të presionit politik mbetet ende një temë mjaft atraktive për politikën shqiptare. Pavarësisht mosmiratimit të planit sipas instancave ligjore, ndodh shpesh në praktikë që plani të marrë statusin e një "plani informal" të cilit, në mungesë të një kornize orientuese, i referohen për të marrë vendime lidhur me investime në qytet... Ky plan, së bashku me Strategjinë e Zhvillimit të Qytetit, mbeten dokumentet orientues kryesorë.

Duhet kujtuar se në këtë periudhë në Shqipëri ishin hartuar shumë strategji nga organizatat ndërkombëtare, sidomos në nivel rajonal, por asnjëra prej tyre nuk gëzonte kredibilitetin e mjaftueshëm në nivel lokal. Kjo sidomos për shkak të nivelit të lartë të përgjithësimit (mungesës së elementeve specifike) dhe shkallës së abstraksionit që ato kishin. Nisur nga kjo, për të garantuar vijueshmërinë e strategjive dhe përkthimin e tyre në rezultate konkrete, Co-PLAN u angazhua me bashkitë për ta operacionalizuar strategjinë e zhvillimit dhe planin rregullues në procesin e formulimit të buxhetit vjetor dhe afatmesëm. Në këtë kontekst, u punua shumë për operacionalizimin e strategjisë në proceset e brendshme të bashkisë, për të analizuar të ardhurat e bashkisë, për të gjetur mënyra për rritjen e tyre... Kështu, strategjia nuk ishte një dokument statik; përkundrazi, bashkitë, përmes zyrave të koordinim-zhvillimit, ndërtuan mekanizma për monitorim-vlerësimin dhe rishikimin e tyre në funksion të dinamikave lokale.

Kjo bëri që të dy bashkitë, por sidomos ajo e Fierit, të ishin partnerë më të besueshëm për të investuar. Në këtë kontekst, Bashkia Fier ripozicionoi marrëdhënien e saj me biznesin duke u përpjekur të ndërtojë projekte konkrete në frymën e partneritetit publik-privat. Rasti i terminalit të autobusëve, edhe pse në fazë studimi, dëshmon qartë përpjekjen e bashkisë për të kapitalizuar mbi rolin e saj rregullator dhe lehtësues të zhvillimit duke i mundësuar kapitalit privat të ofrojë shërbime publike me përfitime të ndërsjella. Një qasje e tillë shënon një hap shumë të rëndësishëm për shndërrimin e rolit të bashkisë nga një rol pasiv në një rol proaktiv udhëheqës të zhvillimit. Natyrisht që qasjet e reja shtronin sfida në rritje për burime njerëzore të tilla që të kuptonin se financimi dhe zbatimi i vizioneve dhe planeve nuk mund të kryhej më me metodat tradicionale ku vetëm shteti financon, por duke vënë në lëvizje të gjitha "energjitë pozitive".

Duke iu kthyer përsëri konkluzioneve të këtij Programi, mund të thuhet se EGUG përfaqëson në vetvete një lloj 'Platforme' që grumbulloi përvojën e Co-PLAN dhe partnerëve të tij dhe e vuri atë në funksion të autoriteteve vendore në Shqipëri, për të reflektuar mbi mënyrat me të cilat mund të kapërcehen situatat komplekse të planifikimit dhe administrimit të territoreve nën juridiksion përtej logjikës së rëndomtë të "rutinës së emergjencave" që simbolizohej me fenomenin e mjerë të "mbushjes së gropave të rrugëve"! EGUG demonstroi një përqasje më strategjike ku lidhen vizionet dhe ëndrrat me mundësitë reale të financave publike e lokale.

Për Co-PLAN, Programi mund të konsiderohet si një shkollë e konsolidimit të metodologjisë së planifikimit i cili integron parime dhe instrumente të planifikimit realist sipas hapave graduale në rritje dhe qeverisjes së mirë me pjesëmarrjen e komuniteteve.

Sidoqoftë, mbetet ende kohë dhe nevojiten monitorime për të lexuar më mirë efektet e këtij projekti...

Produkte të proceseve planifikuese në EGUG:

Së pari - Hartimi i strategjisë së zhvillimit të qytetit (City Development Strategy) përmes një procesi konsultativ në nivel qyteti.

Së dyti - Përkthimi i strategjisë së zhvillimit të qytetit në Planin e Përgjithshëm Rregullues. Plani Strategjik ndihmoi për të kuptuar se cilat ishin dëshirat lokale dhe tregoi rrugët për të arritur plotësimin e tyre, por akomodimi i këtyre "ëndrrave" u detajua më tej përmes planit rregullues. Kombinimi i këtyre dy proceseve siguron shanse më të mëdha për qeverisjen e mirë.

Së treti - Vendimmarrja dhe menaxhimi strategjik kanë nevojë për ngritjen e sistemeve të integruara të Informacionit, si për institucionin e Bashkisë ashtu edhe për territorin (GIS). Të dhënat në këtë rast rifreskohen në mënyrë periodike, jo si një akt por si një proces. Kjo siguron menaxhim më të mirë të informacionit brenda vetë bashkisë, p.sh. si në rastin e zyrave të shërbimit me konceptin "One Stop Shop" etj.

Së katërti - Lidhja e planifikimit afatgjatë me interesat dhe nevojat e ditës së komuniteteve përmes procesit të buxhetimit me pjesëmarrje (në bashkëpunim me Bankën Botërore). Ky proces përfundon me ballafaqimin e gjetjeve dhe rënien dakord midis palëve në mënyrë konsensuale për projektet prioritare finale të cilat i prezantohen këshillit bashkiak. Së pesti - Ndërmarrja e projekteve konkrete në funksion të zbatimit të strategjisë përmes bashkëfinancimeve me bashkinë.

Së pesti - Lidhja e strategjisë, planeve të detajuara dhe GIS-it me financat publike e bashkiake përmes Planeve të Investimeve Kapitale, të cilat mundësojnë përkthimin e vizionit të zhvillimit në terma konkrete zbatimi në përputhje me kapacitetin fiskal të bashkive.

Së gjashti - Nxitja e skemave të Partneritetit Publik Privat (PPP) për të inkurajuar shërbime me interes publik. Këto skema mundësojnë mobilizimin e burimeve të tjera materiale dhe financiare për zbatimin e projekteve urbane, ku secili merr atë që i takon. Sfida që mbetet është si të gjenden skema zyrtare negocimi dhe ekuilibra të tillë ku të dyja palët (publiku dhe privatët) të mbeten të kënaqura.





"Design Briefs" per projektin e terminalit të autobazeve në qytetin e Fierit (nyja e Patosit)
Ky design ka shërbyer për të filluar procesin e bashkëpunimit midis bashkisë dhe investitorëve privatë, Berimi Co-Plan


Karakteristikat e bllokut:

Krijimi i oborreve të brendshme midis bllo-qeve të banimit për të krijuar një hapësirë komunitare të mbrojtur nga zhurmat dhe pluhuri.


Rrugë të brendshme që u japin prioritet këm-bësorëve dhe biçikletave ndërkohë që lehtë-sojnë qarkullimin e automjeteve. Kryqëzime të ngritura që funksionojnë si kurriz rruge janë një nga masat e uljes së shpejtësisë së makinave.

Parkime në rrugë të kombinuar me parkime në oborret e brendshme.


Lartësia e objekteve ulet në drejtim të periferisë së zonës.







Shembull i një profili rruge i ngjashëm me atë që mund të aplikohet në brendësi të bllogeve të banimit



"Design-Briefs" Elemente të Koncept-Planit: Bllogjet e Banimit në hyrjen e re të qytetit të Fierit nga nyja e Sheqit, Burimi Co-Plan

Vizione përtej barrierave...

Më poshtë tregohet një periodizim sintetik i zhvillimit urban të Shqipërisë së pasviteve '90, parë me sytë e Co-PLAN. Mbi bazën e këtyre sekuencave u ngrit koncept ekspozita me rastin e 10-vjetorit të tij. Ekspozita ishte organizuar në 4 evenimente.

Ndodhia:
...transformimet e para territoriale negative të "kërpudhave urbane".

Ndeshja:
Tentativa dhe filozofia e Co-PLAN për t'u orientuar përmes kaosit... për të kuptuar dhe për të ndërhyrë në këtë situatë.

Impakti:
Projektet e para fillojnë... Shenjat e para të ndryshimeve pozitive ndodhin në zonë... Krijohen shoqata banorësh që mbështesin përmirësimet në zonë...


Vizione përtej barrierave:
Përtej periferive të degraduara prirja është "qyteti i jetueshëm" dhe qeverisja e mirë urbane në tërësinë e saj. Planet në nivel qyteti.

Ëndrrat drejt qytetit të jetueshëm

..pas 4-5 vitesh jetë projekti, vetë shoqëria shqiptare arriti një stad më të zhvilluar Kjo bëri që Co-PLAN dhe bashkitë t'i rishikonin dhe përshtatnin këto instrumente përgjatë zbatimit. Njëkohësisht, kjo dëshmonte edhe për shtimin e pjesëmarrësve dhe aktorëve të rinj në projekt...

"E dua Qytetin Tim: Produktet e mira për një qytet realizohen përmes angazhimeve të vullnetshme dhe të vërteta të atyre që e bëjnë, e jetojnë dhe e gëzojnë qytetin. Dhe këta janë banorët e tij. Gjithsesi, angazhimet kanë nevojë të mbështeten nga procese të qarta, të mirëstrukturuara dhe të udhëhequra me durim, inteligjencë dhe urtësi".

Fragment nga Plani Rregullues Elbasan



Në qendër të Feodorës (kupto qytetin tënd), metropol me gurë gri, gjendet një pallat metalik me nga një sferë qelqi në çdo dhomë. Duke parë brenda secilës sferë sheh një qytet të kaltër që është modeli i një Feodore tjetër. Janë trajtat që mund të kishte marrë qyteti po të mos ishte shndërruar, për një arsye apo një tjetër, në atë që e shohim sot. Në çdo epokë, dikush, duke vështruar Feodorën siç ishte, kishte përfytyruar mënyrën për të krijuar qytetin ideal, por ndërsa ndërtonte qytetin e tij në miniaturë, Feodora nuk ishte më e njëjta si më parë dhe ajo që deri dje kishte qenë një e ardhme e mundshme për të, tashmë ishte vetëm një lodër në një sferë xhami.

Feodora ka tani në pallatin e sferave muzeun e saj: çdo banor e viziton, zgjedh qytetin që i përgjigjet dëshirave të tij, e sodit duke e përfytyruar... Në hartën e perandorisë duhet të gjejë vend si Feodora e madhe prej guri ashtu edhe Feodorat e vogla në sferat e xhamit. Jo pse janë të gjitha njësoj reale, por sepse janë të gjitha veçse të hamendësuara. Njëra përfshin atë që është pranuar si e nevojshme, por ndërkohë nuk është akoma; të tjerat atë që është përfytyruar si e mundur e që më pas nuk është më e tillë.

Italo Calvino
Qyteti dhe Qielli; tek Qytetet e Padukshme, 2007

Qyteti ëhlë Ftipia dhomë

Në qendër të Feodorës, (kupto qytetin tënd), metropol me gurë gri, gjendet një pallat metalik me nga një sferë qelqi në çdo dhomë. Duke parë brenda secilës sferë sheh një qytet të kaltër që është modeli i një Feodore tjetër. Janë treguar që mund të kishte marrë qyteti po të mos ishte shkatërruar, për një arsye apo një tjetër, në atë që e shohim sot. Në çdo epokë, dikush, duke vështruar

i pl[illegible]sc e qytetit !

Feodorën siç ishte, kishte përfytyruar mënyrën për të krijuar qytetin ideal, por ndërsa ndërtonte qytetin e tij në miniaturë, Feodora nuk ishte më e njëjta si më parë dhe ajo që deri dje kishte qenë një e ardhme e mundshme për të, tashmë ishte vetëm një lodër në një sferë xhami.

Feodora ka tani në pallatin e sferave muzeun e saj: çdo herë viziton, zgjedh qytetin që i përgjigjet dëshirave të tij, e sodit e përfytyruar...

Në hartën e perandorisë duhet të gjejë vend si Feodora e mbë prej guri ashtu edhe Feodorat e vogla në sferat e xhamit. Jo pse janë të gjitha njësoj reale, por sepse janë të gjitha veçse të hamendësuara. Çdo përfshin atë që është pranuar si e nevojshme, por njëkohësh nuk është akoma; të tjerat atë që është përfytyruar si e mundur e që më pas nuk është më e tillë.

Italo Calvino

QYTETI ESHTE NJE ORGANIZEM I GJALLE

PLANO NDIHMOJENI TE JETOJE

Fragment nga muralet e Ekspozitës së 10 vjetorit të Co-plan

3
Reflektim Post-EGUG...
Vizione globale dhe kombëtare

Nisur nga zhvillimet që po merr sot shoqëria njerëzore, cila do të jetë forma e ardhshme e vendbanimeve njerëzore? Sikurse thotë Castells, hapësira është një shprehje shoqërore dhe teksa shoqëria njerëzore po kalon transformime strukturale, është e natyrshme që po lindin edhe forma hapësinore dhe procese të reja.



Vizione globale– Parathënie historike: procese dhe forma hapësinore në ndryshim

Historia e zhvillimit të vendbanimeve në shkallë botërore përsëritet. Ajo që ndodhi në Shqipëri duke filluar nga vitet '90 është një fenomen i njohur në historinë e zhvillimit të qytetit. Në mënyra të ngjashme, por me aspekte historike të ndryshme, ka ndodhur më parë në mjaft vende të botës. Kështu, gjatë shekujve të tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë, në Evropë dhe Amerikën e Veriut ndodhi një urbanizim gjithmonë në rritje për shkak të revolucionit industrial. Londra, Parisi dhe Nju Jorku kanë qenë magnetet e përhershëm të thithjes së populsisë me "premtimin" për më shumë pasuri dhe për një jetë më të mirë. Kjo u manifestua për herë të parë në Angli gjatë gjysmës së parë të shekullit të XVIII. Kështu, popullsia e Mançesterit u tetëfishua përgjatë një shekulli nga 75,000 në vitin 1801 në 600,000 më 1901; Londra u gjashtëfishua dhe nga 1 milion banorë arriti 6,5 milionë banorë gjatë së njëjtës periudhë; Parisi po ashtu pati rritje të ngjashme, por më modeste gjatë fazës së parë (nga 500,000 në 3 milionë gjatë të njëjtës periudhë) . Shtrirje kaq të dendura ishin të privuara nga drita, ventilimi dhe hapësirat e hapura. Rrjetet e kanalizimeve dhe ujësjellësit nuk i përballonin kapacitetet e shtuara. Mirëmbajtja shumë e keqe çoi në grumbullimin e plehrave dhe mbeturinave (Frampton)[1].

Në këtë periudhë, metropolet morën përmasa të tilla të cilat vunë në krizë instrumentet pjesore të kontrollit dhe të parashikimeve të përdorura deri në atë kohë. Kjo do të sillte, si në nivel teorik ashtu edhe praktik, riorganizimin e eksperiencave, gjë që rezultoi në hipoteza të reja të vendbanimeve, të raporteve qytet-fshat, të zonave ekonomike dhe natyrale etj. Këto lidheshin me programimin ekonomik, me planifikimin rajonal, me teknikat e reja të kërkimeve, me analizën urbane etj. Në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX, edhe në nivel të morfologjisë urbane u konstatua tendenca për të kontrolluar formën e rritjes së qyteteve sipas modeleve tipike – në raport me trafikun, gjelbërimin, zonat e banuara e ato industriale etj. – që mund të ishin të ripërsëritshme në vija të përgjithshme.

Në Evropë kjo është periudha kur përmbyset mekanizmi i koncentrimit urban duke kaluar në një fazë të re, atë të dekoncentrimit. Kështu, qyteti tradicional po transformohej në një rajon metropolitan në shtrirje të vazhdueshme, ku zonat e përhapura të banimit dhe qendra e përqendruar urbane ishin të lidhura nëpërmjet transportit me vendet e punës. Qyteti kompakt që ishte formuar në Evropë përgjatë 500 viteve të mëparshëm u transformua krejtësisht përgjatë një shekulli si rezultat i ndërveprimit të forcave teknike dhe atyre socio-ekonomike .

Për të kuptuar dinamikën e zhvillimeve urbane, mund t'u referohemi përsëri shifrave. Më 1900, vetëm 160 milionë njerëz – një e dhjeta e popullsisë së botës – banonin në qytete; ndërsa tani, në vitet 2000, në qytete banojnë më shumë se 3 miliardë njerëz – gjysma e popullsisë së botës. Në këto 100 vjet, popullsia e botës është rritur nga 1.6 në 6 miliardë banorë. Ky katërfishim i popullsisë në përgjithësi u shoqërua me njëzetfishimin e popullsisë urbane (Fornos; Thirunarayanapuran; Burdet)[2].
E ndërsa shoqëria njerëzore po kalon transformime strukturale, është e natyrshme lindja e proceseve dhe formave hapësinore të reja. Shumë zona metropolitane sot në botë janë në krizë. Qytetet po humbasin kufijtë dhe po fragmentohen nga pikëpamja hapësinore dhe sociale. Fenomeni i eksplozionit urban është bërë pothuajse ekskluzivitet i vendeve në zhvillim. Pa mohuar progresin, ky ritëm i rritjes është shoqëruar me efekte anësore dhe dëme të cilat janë në qendër të diskutimeve për planetin tonë. Suburbanizimi është fenomeni që nga pikëpamja hapësinore pasqyron më së miri paradoksin e fragmentimit hapësinor dhe social që po ndodh në brendësi të "vazhdimësisë urbane" në shumë qytete të botës: zemra urbane kompakte të rrethuara nga një lloj "qyteti i dytë" i paintegruar me të parin. Këto "shpërhapje" urbane në hapësirën e gjelbër, të ndërtuara sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, janë problem edhe në qytetet e Evropës, pasi rezultojnë në një hapësirë "disfunksionale". Në këto kushte, prioriteti i planifikimit urban të shekullit të XXI do të jetë mbështetja e axhendës globale për zhvillim mjedisor të përgjegjshëm e barazi shoqërore për të gjithë njerëzit.

Është një pyetje e cila në ditët e sotme bëhet shumë shpesh dhe nga të gjithë: nisur nga zhvillimet që po merr sot shoqëria njerëzore, cila do të jetë forma e ardhshme e vendbanimeve njerëzore? Sikurse thotë Castells[1], hapësira është një shprehje shoqërore dhe teksa shoqëria njerëzore po kalon transformime strukturale, është e natyrshme që po lindin edhe forma hapësinore dhe procese të reja.

Në konkluzion mund të themi se fazat aktuale nëpër të cilat po kalojnë qytetet kryesore shqiptare nuk janë aspak të reja në historinë e urbanizimit. Situata e migrimit masiv nga zonat rurale që ndodhi veçanërisht pas viteve '90 në Shqipëri, siç treguam më lart, është e ngjashme me situatën e formimit të metropoleve të shekullit të XIX të përshkruara më sipër, edhe pse në shkallë dhe në kushte ekonomike e sociale të ndryshme. Aktualisht, mund të themi se më shumë se gjysma e shqiptarëve kanë zgjedhur qytetin si formën e vendbanimit për të jetuar dhe se tendenca e urbanizimit është ende në zhvillim. Qytetet tona kanë nevojë urgjente për një vizion të ri.

Vizione kombëtare:

Ndikimi i Politikave Publike - Drejt Planifikimit Hapësinor në Shqipëri
Po në Shqipëri a është menduar ndonjëherë për vizione zhvillimi mbi bazën e modeleve të caktuara? A mundet vërtet njeriu të drejtojë qytetin përmes hartimit të planeve?

Përvojat e shkollës së planifikimit modern në Shqipëri, bazuar mbi principin e arritjes së rezultateve gjatë periudhës 1995-2005, na ndihmuan që të artikulonim një mendim më të pjekur për planifikimin në nivel kombëtar, nisur edhe nga eksperiencat e mëparshme në nivel komunitar, vendor dhe rajonal. Periudha post-EGUG ka shërbyer si një reflektim.


...Balancimi i energjisë me kaosin... - Për Co-PLAN, dilema e deritanishme ka qenë: "Si të sigurohet menaxhimi sa më i mirë i situatave entuziaste të energjisë që sjell kaos (qytetet që rriten)?" dhe "Si të gjenerohet sinergji dhe shpresë në situatat e depresionit ekonomik dhe social (qytetet që tkurren)?" Duke e analizuar situatën më me kujdes, duket se sot sfida e planifikimit urban në Shqipëri bëhet e disafishtë, përfshi menaxhimin e energjive të tepërta; krijimin e sinergjive; ringjalljen dhe revitalizimin e qendrave të banuara të caktuara dhe mbrojtjen e trashëgimisë historike-kulturore.

1 K.Frampton, Storia dell' Architectura Moderna, Zanichelli Editore, 1993


2 W.Fornos, D.Thirunarayanapuran, H.Burdet, Population and the urban future, 1999

1 Manuel Castells, The Rise of the Network Society, 1996

Platformë kombëtare. Planifikimi dhe nevoja për reformën e qeverisjes rajonale...
Një tjetër element i konsolidimit të metodologjisë Co-PLAN të planifikimit të territorit është angazhimi për të sensibilizuar shoqërinë lidhur me nevojën e riorganizimit të konceptit të qeverisjes rajonale. Kjo nevojë është bërë e qartë nga eksperienca gjatë viteve të transicionit si edhe nga nevoja për t'u përputhur me parimet e BE-së ku vendi aspiron anëtarësimin. Një nga arsyet kryesore të dështimit të planifikimit të territorit ka qenë mospasja e një qeverisjeje rajonale si nivel i ndërmjetëm, me kompetencat dhe instrumentet e duhura. Kjo ka krijuar situatën e moskoordinimit të iniciativave lokale dhe mungesën e politikave kombëtare mbi territorin, përfshi mungesën historike të Planit Hapësinor Kombëtar. Kjo situatë kërkon riformësim të politikave publike për planifikimin në tërësi, të bazuar në studimin dhe trajtimin rast pas rasti të problematikës urbane në qytetet e ndryshme të Shqipërisë.




Decentralizim



Dekoncentrim

Transferimi i këtyre politikave hapësinore në nivel kombëtar dhe rajonal do të kërkonte mbulimin e hapësirës shqiptare me vizione/studime mbi zhvillimet policentrike dhe vendosjen e "drejtimin" e balancave kombëtare dhe rajonale, e kuptuar kjo e fundit jo vetëm brenda kufijve shtetërorë, por edhe në raportet "gravitacionale" që krijohen me qendrat e tjera në një shkallë më të gjerë. Në situatën kur shumë "qendra" zhvillimi të nivelit të dytë apo të tretë në Shqipëri janë duke kaluar në fazë "depresive", Co-PLAN e shikon policentrizmin në shkallë rajonale dhe kombëtare si mjetin përmes të cilit mund t'u jepet mundësi edhe këtyre "qendrave" të marrin pjesë në "kampionatin midis qyteteve". Kjo supozon studimin e qartë të "ofertës" që secili nga këta qytete mund të hedhë në tregjet e shkallës rajonale e kombëtare, në mënyrë që në vend të "konkurrencës" që çon në depresion të disa "qendrave" dhe "superlulëzim" të disa të tjerave, të lindin marrëdhëniet e "plotësueshmërisë".



Autoriteti Metropolitan


Ka ardhur koha që planifikimi hapësinor të respektojë hierarkinë e hapësirës: qytet, rajon, territor kombëtar.Në vitin 2005, Co-PLAN i propozoi partive politike parlamentare një Platformë për planifikimin dhe administrimin e territorit në vend. Pjesë të kësaj Platforme tashmë janë adoptuar në debatin politik të ditës dhe në disa iniciativa ligjore të Qeverisë dhe Parlamentit pas vitit 2005, përfshi çështje që kanë të bëjnë me pronësinë dhe formalizimin e ekonomisë, duke i "detyruar" deri diku autoritetet vendimmarrëse që të mos u shmangen më këtyre çështjeve tabu.

Vizioni policentrik rajonal dhe kombëtar... - Rekomandimet e Co-PLAN për të konsideruar seriozisht këtë nivel qeverisjeje lidhen me "rikompozimin" e territorit përmes pellgjeve kryesore ujëmbledhëse në vend, sistemeve natyrale dhe artificiale të komunikimit, lidhjeve historike me territorin, burimeve konkurruese midis zonave të ndryshme në Shqipëri dhe së fundi, përqafimit të parimit të barazisë hapësinore përkundrejt ndarjes së territoreve sipas efiçencës ekonomike. Kjo jep shanse për të shkuar drejt një zgjidhjeje më të ndjeshme për sa i takon territorit, e cila ul tensionet politike dhe përmes të cilës planifikimi urban mund të qetësojë fenomene agresive të kohës si urbanizimi dhe dëmtimi i mjedisit.


Në ditët e sotme, në Bashkimin Evropian , diskutohet shumë për gjenerimin e politikave të cilat e shohin policentrizmin si një mënyrë premtuese që do t'i japë planifikimit hapësinor një racionalitet të ri; si një mundësi që kombinon konkurrencën, inovacionet dhe rritjen, që vijnë si rezultat i influencës së qyteteve dhe zonave urbane, me modele më të balancuara të zhvillimit hapësinor të cilat tentojnë të zbusin efektet negative të superkoncentrimeve dhe diferencat qendër-periferi në çdo shkallë.

...Reforma për konsolidimin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut... – Ndodh shpesh që segmente të politikës dhe të administratës publike të "tremben" nga ndryshimi i status quo-së për shkak të reformave. Kjo ka ndodhur edhe në Shqipëri dhe ka bërë që këto segmente, në mënyrë qoftë edhe të pavullnetshme, të sajojnë barriera që "mbysin" me çdo mjet përpjekjet dhe iniciativat për reforma.

Kjo situatë stimuloi edhe pjesëmarrjen e Co-PLAN dhe të disa instituteve të tjera të specializuara joqeveritare në Programin e "Konsolidimit të Demokracisë dhe Ekonomisë së Tregut në Shqipëri" në mbështetje të Task-Forcës së ngritur pranë Zyrës së Kryeministrit (2005-2007) me asistencën e UNDP-së dhe ILD, Institutit për Liri dhe Demokraci, në Peru, me fokus reformat e pronësisë dhe informalitetit. Kjo përpjekje sa




Rajonizimi sipas parimeve të BE



Rajonizimi sipas parimit të pellgjeve ujëmbledhëse

DEAD CAPITAL IN ALBANIA

THE VAST MAJORITY OF ALBANIANS ARE KEPT OUTSIDE THE LEGAL ECONOMY



OPERATIONAL DEFINITIONS OF EXTRALEGALITY IN ALBANIA

1. **Real estate assets where:**
   a. the land occupied is legally disputed
   b. the dwelling was built without the consent of authorities
   c. the acquisition was not registered according to law
   d. the law forbids the fungibility of the property by restricting sales, leases, mortgages, etc.

2. **Business assets that:**
   a. are not incorporated or legally registered
   b. do not have limited liability, asset partitioning, or perpetual succession
   c. are outside the tax record system
   d. do not have all licenses and permits required by law

MOST ALBANIAN REAL ESTATE IS IN THE EXTRALEGAL ECONOMY

Types of Urban Extralegality in Albania



Map of Central Cadastral Zone in Tirana – Validation of Extralegal Typologies



THE EXTRALEGAL ECONOMY HAS ITS OWN INSTITUTIONS

Business



Partnerships registered as sole proprietorships due to exceedingly restrictive costs

Residence attestation or *vertetim* issued by a *fshat* or *bashkim* community leader, used as extralegal ID

Extralegal accounting books outside the law

Real Estate



Extralegal contract unofficially certified by a customary authority which verifies the identity of the parties with his informal seal

Extralegal and informal transfer contract that carries a notarial seal

Extralegal and unrecorded sales contract for an apartment




THE VALUE OF EXTRALEGAL ASSETS IN ALBANIA EXCEEDS US$ 18.5 BILLION


US$ 18.5 billion of assets *in the extralegal economy is:*

- **2.5 times** greater than the total value of remittances sent by Albanians working abroad between 1993 and 2005
- **5 times** greater than the official development assistance and official aid between 1993 and 2005
- **11 times** greater than the amount of foreign direct investment between 1993 and 2005

THE COST OF ENTERING AND OPERATING IN THE LEGAL ECONOMY



Burimi Draft Raport ILD/UNDP dhe Qeveria Shqipëtare 2007



Skemë konceptuale e poleve kryesore dhe lidhjeve strategjike hapësinore
Platforma për rajonalizimin e territorit (2005)

politike aq edhe profesionale arriti të diagnostikojë mjaft çështje politikisht delikate që bllokojnë sot zhvillimin modern të vendit dhe të krijojë një panoramë realiste të vështirësive që hasen, duke shërbyer si bazë informacioni për ndërmarrjen e mjaft iniciativave ligjore sot.

Pavarësisht ndryshimeve të viteve të fundit, planifikimi dhe administrimi i territorit, sidomos në nivel kombëtar, mbetet ende një sektor i pareformuar. Madje edhe projekti më i fundit LAMP (Land Administration and Management Program) i Qeverisë Shqiptare me mbështetjen e Bankës Botërore që nisi para vitit 2005 duke supozuar se do të reformonte pikërisht këtë sektor, duket se ka dështuar aktualisht në këtë objektiv. Edhe pse koncepti i projektit LAMP u hartua nga ekspertët e Bankës Botërore mbi bazën e përvojës së projektit të mëparshëm ULMP si edhe të projekteve të Co-PLAN, sidomos projektit EGUG, në zbatim ai rezultoi një shans i keqpërdorur që nuk respektoi të njëjtën filozofi si në hartim. Interferencat ekonomike dhe politike në projekt dhe kapacitetet e dobëta të administratës që mori përsipër të zbatonte këtë Program, vonuan dhe dëmtuan seriozisht progresin e mundimshëm të mëparshëm. Duket se qarqe të caktuara ekonomiko-mediatike në vend, në aleancë me segmente të politikës, synojnë ta mbajnë ende nën kontroll këtë sektor. Dëshira e këtyre segmenteve për të zotëruar sa më shumë volume të aseteve, në një shoqëri që ende përpëlitet mes riorganizimit të sistemit të pronësisë dhe pretendimeve historike të pronarëve, ka favorizuar zgjatjen e amullisë, mungesën e transparencës dhe komplikimin e këtij problemi që shkakton kosto të mëdha për shoqërinë dhe sidomos për sistemin e planifikimit të territorit.

Platforma për planifikimin dhe administrimin e territorit që Co-PLAN i sugjeroi Parlamentit në vitin 2005, përmbante edhe dimensionet shumë të rëndësishme të pronës dhe reformës territoriale, kjo e fundit në funksion të administrimit efiçent të tokës dhe shërbimeve. Prioritetet politike të kohës, ndjeshmëria e trajtimit të këtyre temave dhe atmosfera historikisht e hidhur që ato mbartin, i vendosi ato në nivele disi më të largëta të axhendave politike. Megjithatë, situata ende jo e pjekur për trajtimin e reformës territoriale në vitin 2005 nuk rezultonte të ishte më e tillë në vitin 2007, kur Co-PLAN ndikoi në trajtimin e sektorit informal dhe rimarrjen në diskutim të temës së reformës territoriale dhe Të pronave në kuadër të menaxhimit urban. Nga ana tjetër, reforma territoriale nuk mbështetej më vetëm nga nevoja për efiçencë në shërbime, por po rilindte në kuadër të diskutimit për zhvillim rajonal dhe si kërkesë për integrimin në Bashkimin Evropian.

Kjo ishte një fazë kur Co-PLAN po kalonte nga niveli i pilotimit dhe provës së njohurive në bazë (komunitet, qeverisje vendore dhe qendrore), në nivelin e hartimit apo ndikimit të politikave publike. Në fakt, për të hartuar politika publike është e nevojshme të përdoret bagazhi i njohurive "të terrenit" dhe njohja në qelizë e shoqërisë shqiptare. Kjo padyshim shmang paragjykimin që nxit studimi i realitetit vetëm nga tavolina duke nxitur politika më efiçente. Trajtimi i këtyre çështjeve nga Co-PLAN nuk ishte rastësor por ishte i influencuar nga misioni social dhe idealizmi për të arritur impakt më të lartë shoqëror. Pikërisht ky dimensionim i punës kërkimore të Co-PLAN për politika publike shënon një "gur të rëndësishëm kilometrik" në zhvillimin e organizatës dhe është mbështetur gjerësisht nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur (OSI) në Budapest.

Pas krizës së pasurive të paluajtshme në SHBA, situata e depresionit ekonomik-social që u reflektua sidomos në sistemin botëror bankar, impaktoi indirekt edhe vende si Shqipëria. Aktualisht, po bëhet gjithnjë e më e qartë se bumi në sektorin e ndërtimit në Shqipëri nuk mund të vijojë më si më parë dhe, në rastin më të mirë, kjo histori "suksesi" nuk mund të zgjasë më shumë se 5-10 vjet të tjera. Në mënyrë paradoksale, pikërisht informaliteti dhe sistemi modest i kreditimit bankar e mbrojtën deri diku Shqipërinë nga një opsion radikal i krizës ekonomike, përfshi krizën e pasurive të paluajtshme dhe të territorit. Tashmë shitjet në tregun e ndërtimit janë reduktuar ndjeshëm, por çmimet e shitjes së apartamenteve, dyqaneve dhe zyrave nuk janë ulur; ndërsa tregu i qirasë po lulëzon. Duket sikur ka një përqendrim të aktivitetit ndërtimor në një numër më të kufizuar kompanish të mëdha dhe me lidhje politike. Por, për fat të keq, kjo situatë ndikoi që edhe reformat të ngadalësoheshin. Pavarësisht nga kjo, situata e bën edhe më urgjente nevojën për reformimin e sistemit të planifikimit dhe menaxhimit të territorit në nivel kombëtar, përfshi këtu edhe sektorët që lidhen direkt ose indirekt me të. Si një institucion që po konsolidohet në fushën e ndikimit të politikave publike, Co-PLAN nuk e ka lënë pas dore trajtimin e kësaj teme të mbështetur nga krijimi dhe kërkimi shkencor.

Në rrethanat specifike të kontekstit shqiptar dhe në reflektim të përvojës së Programeve të realizuara deri në këtë kohë, Co-PLAN vazhdon të punojë në dy drejtime: i) "horizontalisht" në planifikimin urban në një sërë qendrash të banuara në situata "shpërthimi" apo "depresioni"; ii) "vertikalisht" në ndikimin e sektorit në fjalë në nivel kombëtar duke trajtuar për herë të parë çështje të rajonalizimit dhe principe të planifikimit hapësinor kombëtar. Në një shoqëri krijuese, ku qytetet për të qenë të jetueshme kanë nevojë jo thjesht për qeverisje dhe institucione, por për kreativitetin e anëtarëve të saj, "laboratori i Co-PLAN" duhet të transformohet po në mënyrë krijuese.

...Zhvillimi i Qëndrueshëm... - Mjedisi është baza që mbështet jetën dhe çdo transformim territorial në përgjithësi ndikohet nga mjedisi. Nuk duhet të harrojmë se planifikojmë burime teksa përpiqemi të bëjmë qytetet tona të jetueshme. Ndërsa sistemet ekologjike në tërësi, biodiversiteti dhe edukimi mjedisor kanë gjetur prej disa vitesh përkrahësit e tyre të përkushtuar në Shqipëri, mjedisi urban dhe energjia kërkojnë një trajtim të mirëfilltë nga sistemi i planifikimit. Përderisa shoqëria shqiptare në tërësi nuk është bërë e vetëdijshme për faktin se jeton dhe funksionon duke shfrytëzuar burime, Co-PLAN e ka përfshirë mjedisin si një aspekt ndërdimensional në të gjitha projektet dhe iniciativat e veta. Kjo qasje e kujdesshme dhe e balancuar ka qenë diktuar nga situata politike dhe prioritetet e zhvillimit, sikurse edhe nga niveli i pjekurisë së shoqërisë në lidhje me çështje të mjedisit.

Duke bashkëpunuar me bashkitë (Kamza, Fieri, Fushë-Arrzi, Komuna Guri i Zi) për të forcuar sistemet e tyre të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, po krijohen eksperiencat e para në Shqipëri përmes të cilave standardi mjedisor bëhet parësor në ofrimin e shërbimeve vendore. Puna në njësi vendore me madhësi dhe problematika të ndryshme na kthen sërish tek argumenti i mësipërm në lidhje me planifikimin: nevoja për t'i adaptuar instrumentet sipas kërkesave lokale.

Me mbështetjen fillimisht të CORDAID, BE dhe së fundmi të Ambasadës Holandeze në Tiranë dhe të Qeverisë Shqiptare, Co-PLAN është duke ndërtuar një profil profesional të konsoliduar në lidhje me mjedisin urban dhe energjinë.

...Eksplorimi i mëtejshëm i instrumentit "Plan rregullues"... Disa aspekte në zhvillim e sipër

Plani dhe qytetet në "tkurrje"...

Së pari: replikimi i adaptuar i instrumenteve të planifikimit të territorit jo vetëm në qytete energjike dhe në shpërthim (rasti i Fierit dhe Elbasanit), por edhe në qytete që përjetojnë tkurrje apo që kanë nevojë për ankorim dhe "bashkëjetesë" rajonale. Në pesë vitet e fundit, ka një sensibilizim në rritje për ato pjesë të Shqipërisë të cilat kanë ndierë peshën e depresionit për shkak të humbjes së popullsisë dhe rënies ekonomike. Teksa qytetet "në shpërthim" kanë si problem kryesor "drejtimin" e energjisë dhe përdorimin e saj në favor të zhvillimit të qytetit, kjo mund të duket situatë luksi për ato pjesë të vendit të cilat kanë nevojë për "injeksione" energjie, mungesa e të cilës po çon në tkurrjen e tyre. Qasjet dhe mënyra e planifikimit në secilin nga rastet janë specifike... Zgjidhja e problemeve të tyre në një vizion policentrik rajonal, në përputhje me filozofinë e paraqitur më sipër, është diçka për t'u eksploruar më tej përmes studimeve dhe propozimeve të këtyre planeve. Kjo periudhë vlen të nënvizohet për një përvojë të veçantë në disa nga zonat më të varfra të vendit, ku shoqëria dhe vetë planifikimi përballen me dilema gati ekzistenciale. Për shkak të problematikës historike të akumuluar në lidhje me zhvillimin, njësitë vendore në Veri dhe sidomos Verilindje të Shqipërisë vuajnë edhe sot e kësaj dite pasojat e depresionit dhe të dekadave të izolimit e neglizhimit. Programi 6-vjeçar DLDP Decentralizimi dhe Programi i Zhvillimit Lokal (realizuar në bashkëpunim me IC Inter-Cooperation dhe me mbështetjen e SDC Swiss Development Cooperation) synoi pikërisht të asistojë 8 njësi vendore në këtë rajon të vendit (6 nga të cilat u asistuan nga Co-PLAN: Bashkia Koplik, Bashkia Vau i Dejës, Bashkia Pukë, Bashkia Fushë-Arrëz, Komuna Dajç-Bregu i Bunës, Komuna Gur i Zi). Të ngjashme ishin edhe projektet në Bashkitë Kukës dhe Fushë-Krujë, mbështetur nga USAID përmes LGPA Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri, si edhe në Librazhd mbështetur nga Qarku Elbasan.

Në këto projekte Co-PLAN ka ndërtuar mbi përvojën e mëparshme të EGUG për të njohur në mënyrë të përshpejtuar kontekstet lokale, për të zbërthyer institucionet dhe nevojat e tyre, për të krijuar sisteme informacioni në funksion të planifikimit dhe mbi të gjitha për të marrë kohën e duhur për të njohur "kodin gjenetik" të vendbanimeve në fjalë. Ky "kod" është i rrënjosur në situatën territoriale dhe rajonale që qëndron përtej "mureve" administrative të qytetit. Situatat që paraqiten në këto qytete tregojnë qartësisht se "rigjenerimi" i tyre nuk mund të vijë vetëm duke ricikluar vetveten, por nga një kontekst territorial dhe rajonal shumë më i gjerë i cili historikisht ka qenë "përgjegjës" për lindjen dhe ecurinë jetike të qytetit. Kjo ka shënuar "alfën" e proceseve planifikuese zbatuar nën moton se vlerat e fshehura të territorit qëndrojnë në bazë të vizioneve rigjeneruese të së ardhmes.

...kodra e qendrës, rezultat i bashkëveprimit të përrenjve formues, rezulton të jetë një element shumë domethënës në shpjegimin e ekzistencës së pikës fillestare të "ngjizjes" së qytetit - që përkon me qendrën e sotme - dhe të zhvillimit të tij të mëtejshëm në "gadishullin në formë hunde". Pikërisht nga kontakti me këtë "pengesë gjeografike", Lumi Shkumbin merr një kthesë dhe ngushton disi seksionin e tij. Ekzistenca e këtij seksioni të ngushtë është shfrytëzuar për të bashkuar brigjet me anë të urës. Pra, jo më kot, kryqëzimi "në formë Y-je" ndodhet në prerjen e rrugës që është vazhdim i kësaj ure

me atë që vjen nga Dibra. Kjo përkon edhe me qendrën e sotme të qytetit dhe është gjithashtu edhe pikënisja e vetë Librazhdit, prej nga është përhapur në drejtimet e tjera. Këto procese kryesore natyrore përbëjnë një sistem vlerash që duhen ruajtur dhe bërë "të lexueshme" në qytet. Këtu "kondensohet" domethënia e elementeve paraekzistenciale të mjedisit.
..."Leximi" ynë i mëtejshëm i elementeve të qytetit është koherent me këtë sistem vlerash që ka krijuar bazën ku është ndërtuar ai. Këto elemente si dhe proceset kryesore që përbëjnë këtë sistem vlerash, duhen zbuluar dhe ruajtur dhe duhen bërë "të lexueshëm" në qytet.

Shkëputur nga Plani rregullues Librazhd

Në Fushë-Krujë, përvoja e planifikimit mund të konsiderohet si konsolidim i përvojës së akumuluar më parë në Kamëz. Ky qytet mund të konsiderohet si fuqizimi i një poli të ri (sikurse Kamza) përgjatë korridorit kryesor kombëtar veri-jug, aq më tepër me zhvillimin që po merr industria atje, sidomos ajo e materialeve të ndërtimit.

Pjesëmarrja e Co-PLAN në fazën e analizave të Planit Rregullues të Bashkisë Tiranë mund të konsiderohet një eksperiencë specifike. Për shkak të diferencave në mënyrën e perceptimit të procesit të planifikimit dhe të konceptit të zhvillimit të qytetit, Co-PLAN vendosi të tërhiqet nga bashkëpunimi me kompaninë zvicerane UrbaPlan që hartoi Planin Rregullues (mbështetur nga Bashkia Tiranë, MPPTT, Banka Botërore dhe Qeveria Holandeze). Kjo përvojë rikonfirmoi mendimin se proceset planifikuese të tejpolitizuara dhe personalizuara tentojnë të dështojnë ose, në rastin më të mirë, të krijojnë produkte planifikimi të cilat njëkohësisht "dashurohen" dhe "urrehen" në ekstrem, duke u kthyer në instrumente të kontestueshëm, të paqëndrueshëm në kohë dhe gati të papërdorshëm. Për Co-PLAN balanca e interesave të autoriteteve (klientit) me ato të grupeve të interesit dhe komuniteteve është parësore dhe "e pasakrifikueshme". Kujtojmë që "procesi pambarim" për hartimin e planit rregullues të Tiranës ka filluar që pas viteve '90 dhe ende nuk është mbyllur në një dokument konsensual.

Rasti i Planit të Përgjithshëm Rregullues të Librazhdit tregoi se, pavarësisht diferencave politike midis institucioneve të Qarkut (klienti) dhe Bashkisë përfituese të Librazhdit, produkti i planifikimit është pranuar gjerësisht, duke miratuar vizionin për qytetin e Librazhdit i cili transformohet nga një qendër e banuar tranzitore dhe joproduktive në një pol shërbimesh për një rrjet qendrash të banuara rajonale që kompensojnë dhe plotësojnë më mirë njëra-tjetrën. Garancia për këtë është korrektesa gjatë zhvillimit të procesit dhe transparenca në marrjen e vendimeve. Në këtë projekt që Co-PLAN e zhvilloi në bashkëpunim me Studio Metro_Polis (pjesë e Universitetit POLIS) u ndërtua një analizë dhe një proces rezultativ që u kurorëzua me Detyrën e Projektimit dhe me vetë Planin Rregullues që u mbështet nga Bashkia, Këshilli Bashkiak, Qarku Elbasan dhe Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit.

Sa më poshtë është tentativa për të eksploruar bashkekzistencën e disa mentaliteteve në territore shumë të vogla por me fuqi rrezatuese shumë të madhe. Edhe pse pjesa më poshtë mund të tingëllojë "provokuese", qëllimi kryesor është nxitja e qeverisjes vendore për të menduar pozitivisht dhe për të dalë nga të menduarit mediokër.

S.2

S.S

S.T

S.RR

Sektori i qendres

Sektori i spitalit

Sektori i stacionit trenit

Sektori i Shapunit

S.H

S.I

S.P

Sektori i periferik

1

2

3

4

5

6

7

9

Koncept nga Plani Rregulues Librazhd
Burimi Co-Plan

Fasha e pajisur, roli dhe "oferta" e saj:
Zgjidhja e problemeve të Librazhdit nuk qëndron vetëm brenda qytetit në vetvete, por në atë që mund ta quajmë "qasje rajonale". Kjo do të thotë që duhet të dalim nga koncepti i qytetit si një ishull në vetvete dhe duhet ta shikojmë atë si një "vend" të hapur ndaj "valencave" territoriale ku "ofrohen mundësi zhvillimi".
Që Librazhdi të kapërcejë kufizimet që i vijnë për shkak të "madhësisë" së tij, plani i ri i qytetit duhet të ravijëzojë "fashën e tij të pajisur" e cila do t'u "shfaqë" përdoruesve të ngadoshëm një imazh dhe funksion të ri të qytetit. Kjo fashë do të jetë "elementi ankorues linear" midis qytetit të sotëm dhe atij të vizionit rajonal. Kjo fashë do të jetë "katalizatori" për të përçuar zhvillimin dhe një jetesë të re edhe në brendësi të qytetit ekzistues.

Fasha e pajisur është derivat i nevojës që do të ketë qyteti të "përqaset" me një treg më të madh sesa vetë popullsia e tij. Kjo kërkon që qyteti në "vijën e parë" të tij të "nxjerrë" një imazh të ndryshëm nga ai i sotmi, pra të "përafrojë" me "udhëtarët" funksione shërbimesh të karakterit krejt të veçantë në raport me ato që mund të gjenden në vende të tjera. Ato duhen konsideruar këtej e tutje jo vetëm si "qyteti që njohim", por edhe si "zona e lirë" ku mund të shkojmë e të kryejmë shërbime, ku bashkia na ofron të "realizojmë ëndrrat tona" që diku tjetër nuk mundemi t'i realizojmë.

Në "lojën" aktuale të konkurrencës midis qyteteve, shenjat e para të së cilës janë dukur edhe në Shqipëri, është shumë e rëndësishme që Librazhdi të ketë "ofertën" e vet. Ky është roli më i rëndësishëm që do të luajë fasha e pajisur. Librazhdi duhet të arrijë ta përgatisë dhe ta marketojë këtë zonë në mënyrë që ajo të konsiderohet nga investitorët si vendi ideal për biznes dhe investime në shkallë kombëtare...

Mbi të gjitha, kjo kërkon "shift in mind" që këto qytete nuk janë më vetëm vetvetja (pasi nuk mund të "riprodhohen" më vetëm brenda vetvetes), por janë "copëza" të cilat u përkasin "distancave" shumë më të mëdha sesa vetë ato... Që kjo të ndodhë, ato duhet t'i "qasen" publikut me një "fytyrë të re". "Fashat e qasjes"... këto do të jenë katalizatorë kombëtarë, vendi "ku unë dua të shkoj", vendi ku "tabutë e sotme" nuk ekzistojnë...

Disa konkluzione nga këto procese do të ishin:

Gjendja "tkurrëse" nuk ka të bëjë kaq me anën fizike të zhvillimit sesa me ekzistencën e depresionit social-ekonomik dhe mungesën e energjive pozitive që i bën gati të pamundur stimujt e zhvillimit lokal. Gjithashtu, proceset e planifikimit mbeten ende evazive për shkak të efekteve tepër negative që ka krijuar largimi masiv i popullsisë gjatë 20 viteve urbanizim dhe pamundësisë së autoriteteve për të qenë të pranishëm. Qarku si entitet i qeverisjes vendore-rajonale nuk arrin ta luajë rolin e presupozuar sepse nuk ka ende kompetenca të qarta dhe nuk ka kapacitete për këtë punë. Përballja e vizioneve lokale me vizionin rajonal, si në rastin e Planit Rajonal Shkodër-Lezhë, punë e Programit EPTISA (financuar nga qeveria spanjolle me konsulencë britanike), me gjithë punën e mirë që është bërë, dëshmon për pronësinë e paqartë dhe mungesën e instrumenteve zbatuese-detyruese, sidomos në nivel rajoni. Kjo ngre një pikëpyetje të madhe mbi vetë ekzistencën e konceptit të rajonit dhe Qeverisjes Rajonale në Shqipëri. Edhe pse realiteti shtron në mënyrë urgjente nevojën për planifikime rajonale, do të ishte e pamjaftueshme ndërmarrja e tyre pa ndërmarrë njëherë

rregullime ligjore lidhur me kompetencat e administrimit dhe rregullat për ndërveprimin institucional.


Mungesa "e frikshme" e kapaciteteve teknike dhe politike vendore si pasojë e largimit të profesionistëve e ka bërë të pamundur planifikimin dhe menaxhimin me mënyra bashkëkohore. Kjo është pasojë edhe e moskufizimit të autoriteteve vendore kur ato nuk janë në gjendje të plotësojnë kriteret minimale të decentralizimit (për shembull, një veteriner me arsim të mesëm nuk mund të luajë rolin e urbanistit në një territor tepër të shtrirë dhe kompleks).

Është dilema ekzistenciale e qendrave të banuara, sidomos vendbanime të krijuara gjatë periudhës së socializmit mbi bazën e planifikimit dhe afërsisë me vendet e punës, të cilat janë në varfëri dhe vetëm konsumojnë dhe në të cilat kualiteti i jetës është "në prag të sakrificës". Edhe ato pak të ardhura që konsumojnë këto qendra të banuara vijnë vetëm nga "injeksionet" e sektorit publik. Pyetja radikale që ngrihet është: ç'do të bëhet me këto komunitete? Është më e arsyeshme që ato të inkurajohen të shpërngulen drejt qendrave efiçente dhe prodhuese urbane apo të vazhdojnë të qëndrojnë dhe të ndihmohen? Distancat nga polet kryesore të shërbimeve kualitative, sidomos shërbimet shëndetësore dhe ato të edukimit, janë realisht të mëdha dhe të papërballueshme për t'u arritur në kohën e duhur.

Edhe në këto vendbanime, sado të depresuara të jenë ato, ka gjithmonë një bërthamë njerëzish që ruajnë shpirtin e tyre autokton. Por sa dhe deri kur mund të paguajë shoqëria për gabimet e kaluara dhe të sotme të qeverisjes? Kjo mbetet një e panjohur të cilës është e vështirë t'i jepet një përgjigje për aq kohë sa nuk ka përpjekje reformuese për t'iu kundërvënë kësaj status quo-je!

...Plani dhe përtejplani...
Së dyti: eksplorimi i mundësisë së zbatimit të planeve rregulluese përmes arritjes së rezultateve të prekshme. Kjo shënon një sfidë të re të provës që po kalojnë instrumentet e planifikimit në Shqipëri për të dalë nga stereotipat tradicionalë. Këtu përfshihen fuqizimi i financave lokale përmes eksplorimit të inovacioneve në taksën e ndërtesës, mbështetja e 9 njësive vendore nën projektin LGPA për të hartuar Plane të Investimeve Kapitale, formësimi i rolit aktiv të bashkisë si udhëheqëse e proceseve transformuese urbane... Këto synojnë të tregojnë disa alternativa lidhur me "si mund ta 'prek' në qytetin tim atë çka aq 'përsosmërisht' kemi hedhur në letër?". Pra, si mund të shkojmë nga plani në zbatim...

Konkluzioni ka qenë se, pa angazhimin e sektorit privat dhe pa partneritetin me autoritetet vendore, zhvillimi urban modern është i pamundur. Edhe për objekte me rëndësi publike në një qendër të banuar si shkolla, qendra kulturore ose administrative, terminale transporti publik, tregje etj., autoritetet vendore duhet të bëhen protagonistë në promovimin e idesë dhe hartimin e projektit, në të kundërt do t'u duhet të presin në pafundësi financimet e qeverisjes qendrore; ndërsa sektori privat do të kufizohet në interesat e veta të ngushta. Kjo eksperiencë e aplikuar në Fier me projektin për zhvillimin e terminalit të ri të transportit si pjesë e zbatimit të planit të përgjithshëm rregullues të qytetit, është replikuar me sukses edhe në Kukës në zhvillimin e tregut të bashkisë.



Koncept nga Plani Rregullues Kukës
Burimi Co-Plan





Konsolidimi i Njohurive për Ndryshim

...Masa kritike për reformën e njohurive në planifikim urban... - Le ta nisim nga e dyta. Për këtë, Co-PLAN ka investuar duke mbështetur themelimin dhe konsolidimin e Universitetit "POLIS", një shkollë alternative e arkitekturës, dizajnit urban, planifikimit dhe qeverisjes së territorit. Bazuar në eksperiencën dhe vlerat më të mira të Co-PLAN, që prej vitit 2006, POLIS po investon për përgatitjen e një gjenerate të re "ndryshe" e cila mund të krijojë masën kritike të nevojshme të ekspertëve që nesër mund të reformojnë planifikimin urban në vend dhe të sjellin një frymë të re në arkitekturë. Tashmë Co-PLAN është edhe vetë krahu i institutit kërkimor-shkencor të Universitetit, duke e ngritur në një nivel më lart përvojën në terren përmes proceseve akademike. Lobimi dhe sensibilizimi publik, forumet e hapura profesionale, botimet etj. kanë qenë pjesë e këtij zhvillimi. Kjo taktikë afatgjatë e Co-PLAN është "përgjigje" ndaj "refuzimit" indirekt dhe jo të hapur të segmenteve të caktuara të biznesit dhe politikës, të cilave nuk u intereson që të arrihet reformimi i sistemit të planifikimit të territorit në vend. Do të duhet pak kohë që ekspertët e rinj të menaxhimit, planifikimit, dizajnit urban dhe arkitekturës të dalin në treg për të provuar efiçencën e kësaj strategjie afatgjatë e cila premton një sukses të qëndrueshëm.

Sfidat

Sërish... nevoja për politika kombëtare...

Në një vend si Shqipëria, ku buxhetet dhe asetet publike janë ende të kufizuara, politikat e administrimit të territorit dhe legjislacioni përkatës marrin një rëndësi të dorës së parë. Që pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ka qenë një nga vendet e vetme në Evropë që nuk kanë pasur një politikë të zhvillimit hapësinor të territorit në nivel kombëtar. Ndryshimet nga fillimvitet '90 dhe deri më sot nuk e kanë përmirësuar këtë situatë. Kjo shpjegon deri diku edhe atmosferën aktuale kaotike të zhvillimeve (in)formale në vend.

Eksperienca e deritanishme sugjeron se duhet filluar një reformë së pari nga rikonceptimi i kompetencave në planifikim të organizuara në disa nivele:

Niveli Vendor i planifikimit urban dhe qeverisjes urbane ku futen Bashkitë dhe Komunat, përfaqësuesit e të cilave zgjidhen me votë të drejtpërdrejtë. Kompetencat planifikuese të këtij niveli qeverisjeje mund të thellohen dhe decentralizohen, përfshi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit ekonomik e territorial lokal.

Niveli i Ndërmjetëm i planifikimit të territorit që nënkupton procese që ndërmerren nga nivele të ndërmjetme si Qarqet, të cilat janë edhe niveli i dytë i qeverisjes vendore. Por, kjo do të kërkonte kristalizimin paraprakisht të legjislacionit mbështetës për Qarkun, caktimin e kompetencave dhe burimeve financiare të qarta si edhe forcimin e pozitave të drejtuesve të institucionit. Një diskutim i rëndësishëm ngrihet sot mbi Rajonin dhe qeverisjen rajonale; zhvillimin rajonal dhe mundësinë e njësimit të Qarkut me Rajonin. Megjithatë, cilido qoftë niveli i ndërmjetëm (qark, rajon apo të dyja bashkë), ai siguron koordinim të zhvillimit, institucioneve dhe instrumenteve të planifikimit; efiçencë në ofrimin e shërbimeve dhe, mbi të gjitha, lehtësim të procesit të integrimit në BE.

Niveli Qendror/Kombëtar që është Qeveria Qendrore, e cila drafton legjislacionin, normat dhe standardet e planifikimit dhe zhvillimit ekonomik-territorial; harton, monitoron dhe kontrollon politikat e zhvillimit kombëtar e territorial dhe, mbi të gjitha, harton Dokumentin e Politikave dhe Planin e Zhvillimit Hapësinor në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Co-PLAN ka shprehur në disa dokumente publike se kjo reformë territoriale duhet të koordinohet me reformën institucionale të mbarë sistemit të planifikimit. Sipas Co-PLAN, kjo reformë duhet të bazohet në disa parime thelbësore që udhëheqin ndryshimet: Së pari, Shqipëria ka nevojë për një reformim të administratës publike dhe sidomos të asaj të planifikimit sipas një skeme të re të ndarjes administrative-territoriale të vendit dhe sipas kompetencave të mësipërme të administrimit të territorit. Kjo kërkon ripërcaktimin e strukturës dhe nivelit të qeverisjes dhe riorganizimin e ndarjes territoriale dhe niveleve të qeverisjes. Së dyti, reformimi i legjislacionit në tërësi dhe sidomos ai i planifikimit të territorit - bazuar në direktivat përkatëse të BE-së për territorin dhe mjedisin. Paketa në fjalë duhet të synojë stimulimin e decentralizimit në hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rajonale/lokale të zhvillimit; rritjen e shkallës së monitorimit, koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit në nivel rajonal dhe kombëtar dhe organizimin e një procesi konsensual me aktorët e interesuar. Së treti, përmirësimi i politikëbërjes dhe vendimmarrjes, sidomos në fushën e planifikimit dhe administrimit të territorit, bazuar në argumentimin profesional dhe bazën

shkencore të të dhënave dhe përmes hapjes së debateve të shëndetshme publike. Së katërti, rritja e efiçencës dhe efektivitetit të administratës publike dhe të planifikimit të territorit - përmes zvogëlimit të strukturave të administratës publike, rritjes së buxheteve përkatëse, punësimit të stafit më të kualifikuar dhe stimulimit të rritjes së pagave.

Por, cilat do të ishin hapat konkrete për të realizuar këtë objektiv?
Sipas Co-PLAN, hapi i parë do të ishte rikonceptimi i vetë Ministrisë përgjegjëse për Rregullimin e Territorit, si institucion ku hartohen politikat kombëtare të zhvillimit dhe koordinohet/monitorohet zbatimi i tyre në nivele të tjera të qeverisjes. Ministria duhet të pranojë si pikënisje decentralizimin e kompetencës së hartimit, miratimit dhe zbatimit të politikave rajonale e lokale. Ky institucion duhet të ketë strukturat e veta të analizës dhe prognozës, hartimit të politikave dhe monitorimit/kontrollit e zbatimit të tyre. Në këtë kontekst, decentralizim i niveleve të planifikimit do të thotë që Bashkitë dhe Komunat të kenë lirinë për të hartuar, miratuar e zbatuar plane vendore rregulluese urbane, plane lokale të zhvillimit ekonomik dhe plane të detajuara pjesore. Nga ana tjetër, Qarqet apo Rajonet do të duhet të hartojnë plane strategjike rajonale ose plane hapësinore - në aspektin ekonomik, territorial, infrastrukturor, social dhe mjedisor. Ato bëjnë koordinimin e zhvillimeve lokale, zgjidhin në mënyrë konsensuale konfliktet dhe balancojnë zhvillimin vendor. Qeveria Qendrore duhet të vazhdojë të mbajë kompetencat e hartimit të politikave kombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe fizik si dhe të hartimit të planit hapësinor të territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky i fundit duhet të parashikojë raportet e zhvillimit rajonal dhe marrëdhëniet urban-rural; trungjet kryesore të infrastrukturës kombëtare dhe të komunikacionit si dhe zonat prioritare me rëndësi mjedisore, historike, turistike etj.

Hapi i Dytë është rikonceptimi i katedrave universitare që mbulojnë çështjet e administrimit të territorit. Vetë Co-PLAN tashmë ka dhënë shembullin duke themeluar Universitetin POLIS ku, krahas profilit të Arkitektit dhe Dizajnerit Urban, është krijuar edhe profili i ri i Planifikuesit dhe Administratorit të Territorit si diplomë më vete e integruar 5-vjeçare DIND në bazë të "Kartës së Bolonjës". Shumë shpejt do të vijë edhe shkolla pasuniversitare "master" i nivelit të dytë në profilin menaxhim dhe qeverisje urbane. Sistemi i edukimit do të finalizohet me studimet për doktoraturë (3-5 vjet studime të thelluara e të profilizuara). Kjo kërkon prezencë dhe asistencë të huaj të paktën për një periudhë 3-5 vjeçare. Departamentet duhet të shndërrohen në qendra të vërteta kërkimore-shkencore ku të punojnë një numër i caktuar profesorësh dilësorë. Ky proces ndryshimi ka nevojë të shoqërohet me botime të specializuara dhe përkthime literature si tekste bazë të cilat përdoren edhe në nivel ndërkombëtar.

Hapi i Tretë, sipas Co-PLAN, është themelimi i një instituti të kërkimit shkencor për territorin si një qendër ekselence për çështje të planifikimit dhe menaxhimit territorial. Kjo ide është realizuar pranë Universitetit POLIS. Co-PLAN është pjesë e Institutit Kërkimor Shkencor IKSH_POLIS, duke mundësuar lidhjen e teorisë me praktikën përmes angazhimit të pjesshëm të pedagogëve të universitetit në institut dhe anasjelltas. Një institut i tillë normalisht duhej të ishte edhe në sektorin publik. Funksionet kryesore të tij mund të ishin kërkimi shkencor; hartimi i studimeve, projeksioneve, prognozave etj.; përgatitja e publikimeve dhe konferencave (ndër)kombëtare dhe bërja e oponencës dhe rekomandimeve në favor të politikëbërjes e vendimmarrjes. Institutet kërkimore konkurruese për planifikimin duhet të shoqërohen edhe me ngritjen dhe konsolidimin e urdhrave profesionale, në mënyrë të veçantë për Planifikimin e Territorit. Në këto urdhra duhet të marrin pjesë jo vetëm përfaqësues të qeverisë por edhe përfaqësues të institucioneve akademike, kërkimore e ligjore dhe të shoqatave të specializuara si mbrojtëse të grupeve të interesit.

Në raport me sa më sipër, është e rëndësishme të ndryshojë edhe depozitimi i informacionit – sipas një sistemi kombëtar hierarkik dhe të decentralizuar – pranë bashkive, qarqeve, rajoneve dhe ministrive, në favor të hartimit të politikave lokale, rajonale dhe kombëtare. Kjo mund të shoqërohet me decentralizimin e operimit të përditshëm të sistemit si dhe të emërimit të titullarëve/punonjësve në nivel lokal (bashki dhe qark).

I fundit, por jo për nga rëndësia, është gjenerimi i mbështetjes sa më të gjerë për reformën. Kjo nënkupton ballafaqimin dhe bashkëpunimin me sa më shumë institucione; me strukturat përfaqësuese të shoqërisë dhe grupet e interesit, përfshi grupime të përfaqësive komunitare dhe të OJF-ve; me shoqatat dhe urdhrat profesionale, të cilat shpesh janë vetë problemi brenda fushave përkatëse; me shoqatat përfaqësuese të qeverisë vendore etj. Përvoja e Co-PLAN dhe e EGUG dëshmojnë se transparenca dhe procesi janë dy parakushte për sukses për këtë reformë dhe për të ardhmen e planifikimit të territorit në Shqipëri.

Në fillim të viteve '90, disa ekspertë të rinj shqiptarë, me ndihmën e organizatave të specializuara holandeze, pilotuan me sukses përvojat e para të planifikimit urban realist në Shqipëri në disa zona në nevojë në Tiranë. Edhe pse të refuzuara fillimisht nga qëndrimi zyrtar i kohës, këto përvoja u replikuan në vitet më pas me sukses duke e rritur përmasën e zonave të projekteve nga lagjet deri tek qytetet. Nga qendrat modeste informale, metodologjia e planifikimit urban për arritjen e rezultateve u testua suksesshëm edhe në zona formale e në qytetet kryesore. Suksesi u njoh nga organizmat ndërkombëtare dhe komunitetet. Një debat publik u gjenerua për këtë qëllim... Me kalimin e kohës, gjithnjë e më shumë u ndërtua partneritet me autoritetet vendore dhe qendrore. Momenti kulmor në këtë eksperiencë 15-vjeçare ka qenë Programi EGUG, Mundësimi i Qeverisjes së Mirë Urbane, në Bashkitë Fier dhe Elbasan. Këto modele shërbyen si pika frymëzimi për programe zhvillimi të Qeverisë Shqiptare dhe Donatorëve si UNDP dhe Banka Botërore. Vetë Co-PLAN u konsolidua dhe u rrit si organizatë duke investuar për kapacitetet e saj për të garantuar qëndrueshmërinë në vite. Sot, mjaft ish-ekspertë të Co-PLAN janë angazhuar në institucione publike dhe private, në politikë apo në organizmat ndërkombëtare. Por organizata vijon të jetë e qëndrueshme në kapacitetet njerëzore, financa dhe ide. Co-PLAN i ka propozuar një Platformë partive politike dhe Parlamentit Shqiptar, duke provokuar debat. Disa ide tashmë janë adoptuar në iniciativa zyrtare ligjore. Ide të tjera janë hedhur në tryezat e debatit politik. Përpjekja shumëdimensionale e bashkëpunimit me qeverinë, donatorët (OSI, UNDP, USAID, EU etj.) dhe shoqërinë qëndron në themel të strategjisë së Co-PLAN për t'i transformuar idetë në politika të zbatueshme. Një alternativë universitare e stafit të Co-PLAN po ndihmon në krijimin e masës kritike të ekspertëve që do të sjellin reformimin e plotë të sistemit të planifikimit të territorit në Shqipëri. Sidoqoftë, sa treguam në këtë libër nuk është arritur lehtë dhe pa kosto... Nuk kanë munguar paragjykimet, debatet, madje edhe presionet. Në këtë atmosferë, "kyçi" për Co-PLAN ka qenë pozicionimi në mbështetje të interesit publik dhe komunitetit, arsyeja për të cilën ky institut u themelua pesëmbëdhjetë vjet më parë. Sfida vijon për të zgjeruar dhe konsoliduar horizontalisht dhe vertikalisht metodologjinë dhe instrumentet e planifikimit urban në vend. Tashmë nuk mund të flitet më thjesht për planifikim lagjeje me pjesëmarrje komunitare, as për plane urbanistike për arritjen e rezultateve në nivel qyteti. Tashmë, mbi të gjitha, duhet goditur vetë sistemi i vjetër në nivel kombëtar, për t'i lënë vend një sistemi të ri planifikimi hapësinor kombëtar që shkon në linjë me atë që kombet e BE-së po ndërtojnë prej disa dekadash...





1	2	3	4	5
1995 - 1999	1999 - 2002	2002 - 2003	2003 - 2005	2005 – 2006
Përmirësime urbane të lagjeve	1 +	2 +	3 +	4 +
Planifikim me komunitetin	Planifikim Urban	Trainim dhe ndërtim i kapaciteteve në njësitë vendore	Planifikim Strategjik	**Politikëbërje**
Mbështetje ndaj grupeve në nevojë		Networking & zhvillim institucional	Qeversje e mirë	**Zbatinmi i instrumentave të qeverisjes së mirë** **Zhvillimi i Qëndrueshëm**
				Reforma për planifikimin & territorin Menaxhimi mjedisor urban Administrimi urban; Financa lokale; Strehimi Planifikimi ambjental & menaxhimi

Trainim në punë e sipër – Proces pjesëmarrje – Fushata sensibililzimmi

Vendbanime informale					
	Bashki – Njësi vendore				
	Lagje banimi të konsoliduara				
		Nivel kombetar dhe ndërkombëtar			

2006 – në vazhdim

5 +

Platformë e re edukimi – Universiteti POLIS

Qytetet motorrë të zhvillimit Ekonomik

Ndikimi i Politikëbërjes

Njohuri të reja për ndryshim

Rrugetim Co-Plan

Takime periodike të organizuara nga U_POLIS me studentë, akademikë, profesionistë dhe autoritete

2006-në vazhdim

Forumi i Hapur

Forumi Urban

Debate publike dhe televizive në 15 qytete

1998-2005

1998-2002

Periodiku i Co-PLAN i ndjekur nga revista arkitekturës dhe planifikimit urban e U_POLIS

2009-në vazhdim

Forum A+P

Qyteti i Ndërtuar nga njerëzit

OJQ, produkt direkt i Co-PLAN, jep sherbime trainimi në zhvillim institucional dhe organizativ.

2003-në vazhdim

NET, Rrjeti për Shkembime dhe Trainim

Çmimet e përvitshme nga Co-PLAN mbi përgjegjësinë sociale në 4 kategori: qeversje, media, shoqëri civile, dhe biznes.

2002-në vazhdim

Çmimi i Lidershipit

ntitet privat i pecializuar në hërbime audio-izuale, produkt direkt i Co-PLAN

2003-në vazhdim

NVS, Net Vizion Studio

Co-PLAN

2006-në vazhdim

Co-PLAN BiblioPolis

Produkt direkt i Co-PLAN si qendër studimi për arkitekturën dhe planifikimin urbar

Platforma për planifikimin dhe Menaxhimin e territorit në Shqiperi

2005

ropozim i Co-PLAN daj forcave politike publikuar në 2008

Platforma IDR, Instituti për Demokraci dhe Reforma

2007-ne vazhdim

Ish staf i Co-PLAN themeluan OJQ për edukimin politik

IKSH_ POLIS, Instituti Kërkimor Shkencor

Metr_POLIS

2006-në vazhdim

Ish staf i Co-PLAN themelu studion private Metro_POL ge kooperon me Co-PLAN dhe OLIS në kuadrin e IKSH

U_POLIS

Ish staf i Co-PLAN themeluan universitetin POLIS të specizlizuar në arkitekturë dhe planifikim urban

2006-në vazhdim

Skema e produkteve të Co-Plan

